



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tropojë

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
(Auditim Financiar)

Bashkia Tropojë

Tiranë, shtator 2025

PËRMBAJTJA		Faqe
I.	PËRMLLEDHJE EKZEKUTIVE	3-7
1	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-4
2	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-7
II.	HYRJA	7-8
1	Objektivat dhe qëllimi	7-8
2	Identifikimi i çështjes	8-8
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	8-8
4	Përgjegjësitë e audituesve	8-9
5	Kriteret e Vlerësimit	9-9
6	Standardet e auditimit	10-11
7	Metodat e auditimit	11-11
8	Dokumentimi i auditimit	11-12
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	11-96
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	11-11
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	11-96
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm	12-22
2.2	Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	22-58
2.3	Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	58-94
2.4	Të ndryshme të dala gjatë auditimit	94-95
IV.	Gjetje dhe rekomandime	96-103

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.

Bashkia Tropojë është njësi vendore institucion i pavarur, ku pas ndarjes territoriale është një bashkim mes qytetit dhe shtatë ish-komunave në afërsi të tij, pra në total ka 8 njësi administrative (rreth 68 fshatra) si vijon: njësi administrative Bajram Curri (qyteti), Fierzë, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyç dhe Tropojë, me një popullsi prej 14,189 banorë dhe sipërfaqe totale 1,043-1,057 km².

Buxheti i Bashkisë Tropojë si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave ndërkombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit, është detyrim ligjor në bazë të *Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2* në të cilat përcaktohet: “1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Tropojë, si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024, duke vlerësuar nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Mbi raportimin financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024 janë hartuar dhe paraqesin informacion kontabël në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.
- Mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 17 gjetje dhe janë dhënë 18 rekomandime, nga ku masa organizative me 15 gjetje dhe 16 rekomandime, 1 gjetje dhe 1 rekomandim në vlerën 2,115,941 lekë masa për eliminimin e efekteve negative, për dëmshpërblimin e vendimeve gjyqësore, 1 gjetje dhe 1 rekomandim në vlerën 19,784 mijë lekë në fushën për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve nga kontratat e qirave dhe taksat vendore.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatua se:

Në llogarinë 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” është kontabilizuar vlera

- prej 263,457 lekë, vlerë e cila i përket llogarisë 604 “Tranferime korrente të brendshme”.
- Llogaria nr.215 “*Mjete transporti*”, në pasqyrën F7 “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata“ ka vlerën 70,536,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 67,083,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak se vlera e pasqyruar në kontabilitet.
 - Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*” nuk është pasqyruar saktë, për shkak se nuk janë kontabilizuar vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie në shumën 34,332,096 lekë, duke ndikuar në saktësinë e pasqyrave financiare.
 - Llogaria 211 “*Pyje, Plantacione*” nuk pasqyron vlerën reale të pasurisë, pasi nuk janë përfshirë në regjistrat kontabël vlerat e pyjeve dhe kullotave, që janë kaluar me vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në pronësi të ish-komunave, tashmë pjesë e bashkisë.
 - Llogaria 231 “*Investime në proces*” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) ka mospërputhje të pakësimit të llogarisë 231 “*Investime në proces*” me shtesat e llogarive (212+213+214) për vlerën 8,574,174 lekë.
 - Nuk është kryer kapitalizimi i investimeve për 8 objektet e marra në dorëzim, si shtesa në llogarinë 213 “*Investime në proces*”, me një vlerë totale prej 263,726,682 lekë, duke ndikuar në pasaktësinë e pasqyrimit të aktiveve afatgjata në pasqyrat financiare.
 - Nuk është kryer procedura e vlerësimit dhe asgjësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit.
 - Llogaria 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2024. Konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione të klubit sportiv “Valbona” në vlerën 3,500,000 lekë, të cilat duhet të ishin nxjerrë në shitje nga Bashkia brenda vitit 2021.
 - Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, të cilat në fund të vitit 2024 rezultojnë në vlerën 26,037,782 lekë.
 - Të ardhura të munguara në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 në vlerën 19,784,125 lekë, duke e rritur gjendjen progresive të detyrimeve në vite në vlerën totale prej 61,390,362 lekë.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore: Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tropojë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën 19,784,125 lekë, për vitin 2024, si dhe marrjen e masave të menjëhershme për bllokimin e llogarive apo ndjekjen penale të debitorëve të “vjetër” në vlerën 41,606,237 lekë.
- Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga sektori i burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.
- Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës të marrë masa për të sistemuar llogaritë përkatëse të pasqyrave financiare për vitin 2025, të cituara në mënyrë të detajuar në gjetjet respektive duke sistemuar ato në përputhje me standardet e kontabilitetit si dhe pasqyrimin e saktë dhe real të llogarive, në Ministrinë e Financave.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinion mbi pasqyrat financiare

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Tropojë, për periudhën ushtrimore 01.01.2024-31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë

ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, dhe ato shoqëruese, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

“Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Tropojë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit “**të kualifikuar**”, e shprehur kjo në bazën për opinion.

Baza për opinionin mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit”, pjesë e Raportit të auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbajnë gabime materiale por jo të përhapura, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 7,582 mijë lekë, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur, justifikojnë dhënien e një “Opinionit të Kualifikuar¹” të auditimit.

Nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se:

- Në llogarinë 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” është kontabilizuar vlera prej 263,457 lekë, vlerë e cila i përket llogarisë 604 “Transferime korrente të brendshme”
- Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata” ka vlerën 70,536,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 67,083,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak se vlera e pasqyruar në kontabilitet.
- Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*” nuk është pasqyruar saktë, për shkak se nuk janë kontabilizuar vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie në shumën 34,332,096 lekë, duke ndikuar në saktësinë e pasqyrave financiare.
- Llogaria 211 “*Pyje, Plantacione*” nuk pasqyron vlerën reale të pasurisë, pasi nuk janë përfshirë në regjistrat kontabël vlerat e pyjeve dhe kullotave, që janë kaluar me vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në pronësi të ish-komunave, tashmë pjesë e bashkisë.
- Llogaria 231 “*Investime në proces*” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) ka mospërputhje të pakësimit të llogarisë 231 “*Investime në proces*” me shtesat e llogarive (212+213+214) për vlerën 8,574,174 lekë.
- Nuk është kryer kapitalizimi i investimeve për 8 objektet e marra në dorëzim, si shtesa në llogarinë 213 “*Investime në proces*”, me një vlerë totale prej 263,726,682 lekë, duke ndikuar në pasaktësinë e pasqyrit të aktiveve afatgjata në pasqyrat financiare.
- Nuk është kryer procedura e vlerësimit dhe asgjësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit.
- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2024. Konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione të klubit sportiv “Valbona” në vlerën 3,500,000 lekë, të cilat duhet të ishin nxjerrë në shitje nga Bashkia brenda vitit 2021.

¹ -Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë.*”

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” nuk është pasqyruar saktë, pasi nuk janë përfshirë detyrimet që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, të cilat në fund të vitit 2024 rezultojnë në vlerën 26,037,782 lekë.

-Të ardhura të munguara në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 në vlerën 19,784,125 lekë, duke e rritur gjendjen progresive të detyrimeve në vite në vlerën totale prej 61,390,362 lekë,

- Detyrimet e Bashkisë Tropojë që rrjedhin nga vendimet gjyqësore, në vlerën totale prej 40,612,675 lekë, prej të cilave 14,574,893 lekë janë likuiduar (duke përfshirë 2,115,941 lekë shpenzime përmbartimore), nuk janë njohur në kontabilitet në përputhje me parimin e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke sjellë kosto shtesë për buxhetin e shtetit.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. prot.,**467/1, datë 25.04.2025**, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 29.04.2025 deri më datën 06.06.2025, në subjektin Bashkia Tropojë për periudhën 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024 u krye auditimi “Mbi Auditimin Financiar”, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. Ll., përgjegjës grupi;
2. L. Gj., auditues;
3. K. F, auditues.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

1.Objekti dhe qëllimi i auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Tropojë kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)³;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Tropojë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2024, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Identifikimi i çështjes.

Raporti i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësi të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Tropojë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Fushat të cilat u audituan janë si vijon:

1. Aktiviteti i Njesisë së Auditit të Brendshëm dhe zbatimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
2. Raportimi financiar;
3. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Niveli drejtues i Bashkisë Tropojë (Kryetari i Bashkisë, në rolin e Nëpunësit Autorizues të institucionit) dhe niveli i mesëm drejtues (Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit dhe të Financës, në rolin e Nëpunësit Zbatues), kanë përgjegjësinë për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me bazën ligjore në fuqi për raportimin financiar; Për krijimin e kontrolleve të brendshme të nevojshme, për të mundësuar përgatitjen e drejtë të pasqyrave financiare, pa keq-raportime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; dhe kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Gjithashtu Kryetari i Bashkisë Tropojë, Përgjegjësit e sektorëve pranë Bashkisë Tropojë kanë përgjegjësinë për kryerjen e detyrave funksionale në përputhje me kuadrin ligjor, që përcakton dhe rregullon veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit.

Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia e audituesve është të shprehin konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim, pra nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar dhe rezultatet financiare të njesisë ekonomike janë në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi (ISSAI 1200.3). Audituesit janë përgjegjës për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, duke respektuar kërkesat etike, duke planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së arsyeshme. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozonë që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe raportimit të shifrave në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi profesional i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë gjithë procesit të auditimit, audituesi duhet të ushtrojë gjykim dhe skepticizëm profesional dhe ndër të tjera: Merr evidencat e duhura dhe të mjaftueshme për të vërtetuar ekzistencën e keq raportimeve materiale. Formon një opinion për pasqyrat financiare dhe objektivat shtesë mbi të cilat raportimi është i detyrueshëm bazuar në përfundimet e nxjerra nga evidencat e grumbulluara. (ISSAI 1200.7) Raporton rastet e mospërfutshmërisë me bazën ligjore, përfshirë buxhetin dhe përgjegjshmërinë, dhe/ose Raporton mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

Kriteret e vlerësimit. Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/14, datë 27.11.14 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Në fushën e Menaxhimit financiar dhe kontrollit:

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm publik”;

Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;

VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 30, datë 27.12.2011

“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë Financave nr. 21, datë 25.10.2016, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, Nëpunësi Zbatues”; Urdhri i MF nr. 54, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit të MFK”; Urdhri i ministrit Financave nr. 100, dt. 16.10.2017 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik“.

- Në fushën e administrimit financiar: si dhe aktet normative që ndryshojnë këto ligje;

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”;

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” i ndryshuar; Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” i ndryshuar;

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njërive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”, udhëzimi i MFE nr. 26, datë 27.9.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore” .

- **Standardet e auditimit.** ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i Auditimit Financiar të KLSH-së; Manuali i Auditimit të Brendshëm etj. Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.; Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

Metodat e auditimit. Është përdorur metoda me auditim të njëpasnjëshëm. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me eficiencë dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të Audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit². Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e

² ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të përdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.* Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt.

- *Kontrolli i vlerësimit.* Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmim nga të tretët.* Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepërcave ose të çdo regjistrimi tjetër.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashhtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- *Verifikimi i transaksioneve* - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.

- *Intervistimi* - është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.

- *Raportet dhe informacione* - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm – grupi i auditimit ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.

Dokumentimi i auditimit.

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 "Dokumentimi i auditimit", nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III.PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Bashkia Tropojë është person juridik. Ky autoritet ushtrohet nëpërmjet akteve të këshillit dhe kryetarit të bashkisë si organe të zgjedhura, në përputhje me kompetencat dhe në ushtrimin e funksioneve qeverisëse që ato kanë në bazë të ligjit.

Misioni i Bashkisë Tropojë është të sigurojë qeverisjen në një nivel sa më afër qytetarëve, duke garantuar vetë-qeverisjen në përputhje me kërkesat e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore.

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Auditimi në subjektin “Bashkia Tropojë”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar. Në këtë subjekt, *u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi që në gjykimin profesional të pavarur janë materiale por jo të përhapura, etj.*

Nga audituesit u shqyrtua dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektiv, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e shpenzuara dhe të ardhurat e arkëtuara, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

III.2.1. Përshkrimi i Auditimit, Sipas drejtimeve të auditimit.

-Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.

1. Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një koncept i rëndësishëm, i cili bazohet në krijimin e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm, për të ndihmuar menaxherët në arritjen e objektivave, marrjen e vendimeve të përshtatshme dhe përcaktimin e përgjegjësive për zbatimin e tyre.

Ky auditim u krye për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njesisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga stafi i Bashkisë Kavajë, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e

kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

Ky komponent përfshin integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike, politikën menaxheriale dhe stilin e punës, strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit, politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, aftësitë profesionale të punonjësve.

Parimi 1 - Njësia Publike demonstroi angazhim për integritet dhe vlerat etike

Nëpërmjet këtij parimi është vlerësuar angazhimi i Bashkisë Tropojë në hartimin dhe zbatimin e elementëve dhe mekanizmave të nevojshëm për zhvillimin e integritetit dhe vlerave etike në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se bashkia vepron mbi bazën e rregullores së brendshme miratuar me urdhrin nr.41 datë 06.03.2018 “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Bashkisë Tropojë”. Në këtë dokument, janë përcaktuar parimet, funksionimi, kompetencat dhe detyrat për strukturat e institucionit.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga drejtoria e burimeve njerëzore rezultoi se në rregulloren e brendshme përfshihen vetëm **46** pozicione pune të strukturës aktuale përkatësisht:

5 pozicione pune me statusin funksionar politik;

1 pozicion pune me statusin i zgjedhur;

25 pozicione pune me status të nëpunësit civil;

15 pozicione pune me kontratë.

-Bashkia Tropojë ka Kodin e Etikës të miratuar me urdhrin nr.120/2 datë 13.11.2017, Gjithashtu bashkia mbështetet në *ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjin nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”(i ndryshuar) si dhe ligje apo rregulloret specifike që janë krijuar në bazë të një ligji specifik.*

-Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se janë marrë dy masa disiplinore për shkelje të rregullave mbi etikën.

-Është hartuar rregullorja për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Tropojë në përputhje me ligjin nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit” e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3726 prot., datë 02.12.2021.

-Është hartuar rregullore për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Bashkinë Tropojë e cila është miratuar nga titullari i bashkisë me shkresën nr. 3727 prot., datë 02.12.2021.

Gjatë vitit 2024 janë marrë masa disiplinore: **2** “vërejtje” për shkelje të rregullave të etikës;

-Për rastet e raportimit lidhur me ankesat për korrupsion, funksionon sektori i çështjeve të anti korrupsionit, ngritur pranë bashkisë, në përputhje me kërkesat e ligjit 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”, i ndryshuar.

-Njësia përgjegjëse e menaxhimit të burimeve njerëzore bashkëpunon me zyrtarët raportues dhe zyrtarin autorizues në lidhje me performancën dhe sjelljen profesionale të nëpunësve civil.

Parimi 2 -Titullari / Nëpunësi Autorizues (NA) / Bordi apo Këshilli i drejtuesve demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje.

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet përgjegjshmëria e menaxherëve të nivelit të lartë për të ushtruar përgjegjësinë dhe mbikëqyrjen mbi performancën e njësisë publike dhe implementimin e kërkesave kryesore për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Për vitin 2024, situata paraqitet efektive, raportimeve të rregullta periodike nga drejtoritë e bashkisë, raportim të cilat janë të përqendruar në çështjet financiare dhe buxhetore, por edhe

në objektiva, tregues performance dhe risqet përkatëse mbi këto objektiva gjë e cila evidenton nevojën e miratimit të një procedure të shkruar mbi rregullat e raportimit në institucion. Titullari i Bashkisë mbikëqyr projektimin, zbatimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

-Rezulton të ketë Urdhër për miratimin e Planit të Veprimit për kontrollin e brendshëm dhe për rrjedhojë dhe raporte periodike të monitorimit të këtij Plani;

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, dhe nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese.

-Titullari i bashkisë ka miratuar plan për menaxhimin e risqeve të nivelit të mesëm e të lartë.

Parimi 3 - *Titullari / NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë.*

Ky parim ka në fokus strukturën organizative të njësisë (organi gramën), përcaktimin e qartë të detyrave dhe përgjegjësiave funksionale të çdo niveli autoriteti si dhe nivelit të delegimit të tyre. Parimi përcakton përgjegjësinë e Titullarit / Nëpunësit Autorizues për krijimin e strukturave të përshtatshme organizative, në përputhje me madhësinë dhe kompleksitetin e veprimtarisë së njësisë publike si dhe kanalizimin e linjave të qarta të raportimit brenda dhe jashtë strukturave të njësisë.

-Bashkia Tropojë ka rregullore të ndryshme të miratuara dhe publikuara nga titullari për veprimtarinë e institucionit, por nuk ka ende rregulloren e Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit sipas ristrukturimit të kryer me Urdhrin nr. 59 datë 13.02.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë” për vitin 2024.

-Bashkia ka miratuar planin strategjik me objektiva dhe prioritete në përputhje me kërkesat e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor.

-Me Urdhrin nr. 59 datë 13.02.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë” për vitin 2024, titullari ka miratuar strukturën e përbërë nga 396 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë) punonjës. Kjo strukturë ka ndryshuar me urdhrin nr.59/1 datë 04.09.2024, e përbërë nga i njëjti numër punonjësish por ndryshimet kanë konsistuar në emërtesa dhe ri organizime të sektorëve apo drejtorive.

-Përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar 27 punonjës të rinj dhe janë larguar 39 punonjës.

Tabela nr.1 Struktura e Bashkisë Tropojë për vitin 2024

Numri i të punësuarve në strukturën e miratuar	Nëpunës Civilë	31
	Nëpunës me kontratë	317
	Të zgjedhur	2
	Funksionar Politik	15

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore Tropojë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Nga auditimi konstatohet se është duke u rishikuar rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore .

- Rezulton se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.

- Evidenca të analizës së riskut ka vetëm nga Njësia e Auditit të Brendshëm.

Parimi 4 -*Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave.*

Ky parim vlerëson angazhimin e njësive publike për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur personel kompetent në përputhje me objektivat e njësisë.

-Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale të cilat nuk kanë mangësi në të dhënat për marrëdhëniet e punës, librezat e punës, rekrutimin, trajnimet, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë.

Përshkrimet e punës janë rishikuar periodikisht .

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Sektori i Burimeve Njerëzore mbi rekrutimet dhe largimet, rezultoi se përgjatë vitit 2024 janë rekrutuar 27 punonjës të rinj dhe janë larguar 39 punonjës .

-Përsa i përket rritjes së kapaciteteve në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, bashkia nuk ka hartuar një program trajnimi të mirëfilltë, ku të përfshihen seanca trajnimi në drejtim të informimit të punonjësve me zhvillimet në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, përveç trajnimeve që organizohen nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

Për vitin 2024 janë kryer **77** trajnime ku kanë marrë pjesë **37** nëpunës të institucionit.

-Bashkia Tropojë nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit si dhe nuk parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha të ndryshme.

-Institucioni ka miratuar Vendimin nr. 120, datë 27.12.2022 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetin e Bashkisë Tropojë për vitin 2023”.

- Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Parimi 5 -Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale.

Njësia publike duhet të ketë një mekanizëm të dokumentuar për të mbajtur një personel të përgjegjshëm në realizimin e përgjegjësiave dhe objektivave që lidhen me kontrollin e brendshëm.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi, rezulton se bashkia nuk i ka të përcaktuara përgjegjësitë dhe përgjegjshmërinë menaxheriale për hartimin dhe monitorimin e objektivave strategjike në dokumentin e rregullores së brendshme pasi ajo ende nuk është përditësuar sipas ristrukturimit të kryer në vitin 2024.

-Gjithashtu evidentohet se njësia publike ka hartuar plane vjetore pune për të gjitha drejtoritë. Një faktor tjetër i rëndësishëm, i cili ndikon në efektivitetin e përcaktimit të përgjegjshmërisë menaxheriale, është edhe përfaqësimi i rregullt në Grupin e Menaxhimit Strategjik, me qëllim diskutimin e çështjeve që lidhen me kontrollin e brendshëm dhe adresimin e mangësive kryesore të konstatuara.

Për vitin 2024, është ngritur *Urdhri nr.132/5 datë 05.12.2024* për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) për programin buxhetor afatmesëm 2024-2026.

GMS luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike. Bashkia Tropojë zhvillon takimet e GMS, të dokumentuara me procesverbale.

Për vitin 2024, është përcjellë në MF “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë Bashkia Tropojë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-*Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a,b,c,d,dh,e,ë, Kreu III, neni 20;*

-*VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, Kreu II. “Dosja e Personelit”;*

-*“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.1, Kapitulli IV “Plani i veprimit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit”, Kapitulli V.*

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Parimi 6 – Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikim dhe vlerësim të risqeve në lidhje me këto objektiva

Ky parim paraqet një pamje të elementëve bazë të nevojshëm për zhvillimin e procesit të menaxhimit të riskut. Përcaktimi i objektivave të njësisë publike është formimi i bazës mbi të cilën zbatohet vlerësimi i riskut dhe krijohen aktivitetet pasuese të kontrollit. Titullarët / NA / Menaxherët përcaktojnë objektivat dhe i grupojnë ato në kategori më gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet e njësisë, në lidhje me aktivitete, raportimet dhe pajtueshmërinë.

-Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023-2025 është miratuar me VKB.

-Dokumenti përfundimtar i Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 125 datë 22.12.2022. Grupit të auditimit i është vënë në dispozicion shkresa përcjellëse e PBA në MFE.

Është e rëndësishme që të ketë një lidhje në mes të planeve vjetore të punës me planin strategjik të njësisë publike. Lidhjet e qarta midis planit strategjik, planit vjetor të punës dhe buxhetit vjetor shërbejnë si pikënisje për procesin e menaxhimit të riskut në çdo nivel të njësisë publike. Në planin vjetor të punës çdo njësi publike do të zhvillojë objektivat dhe aktivitetet të cilat duhet të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike për të cilat ata janë përgjegjës.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se bashkia ka plan- veprime vjetore operationale të miratuara për arritjen e qëllimeve dhe politikave afatmesme dhe objektivave vjetore që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Plan veprimi me nr.378/2 date 29.01.2024.Plan vjetor me nr. 378/1 date 29.01.2024. Harta e proceseve të punës nr.378/3 date 29.01.2024

Parimi 7 – Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave

Megjithëse analiza e riskut mund të fillojë nga niveli i lartë menaxherial ose në një funksion operativ, çelësi është ekzistenca e një procesi të përgjithshëm për të përcaktuar se si identifikohen dhe menaxhohen risqet në të gjithë njësinë publike.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se bashkia ka përcaktuar mekanizma të organizuar dhe funksionalë të procesit të menaxhimit të riskut.

-Është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Tropojë si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimit efektiv të tyre. Regjistër risku me nr.378/4 date 29.01.2024.

-Titullari i bashkisë ka ngritur Urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimit mbi risqet. Urdhër nr.132/5 date 05.12.2024

- Ka plan-veprime për menaxhimin e riskut. Plan veprimi me nr.378/2 date 29.01.2024.

Parimi 8 – Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut të mashtrimeve

Mashtrimi ekziston (ose mund të ndodhë) në shumicën e njësive publike. Ekzistenca e një risku të tillë të rëndësishëm ka bërë që formati i përditësuar i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe regjistrit të riskut të përfshijë vlerësimin e riskut të mashtrimit duke theksuar se duhet të merret parasysh për çdo objektiv.

-Nga auditimi evidentohet se Bashkia Tropojë vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime dhe kryen vlerësime periodike të ekspozimit ndaj këtyre risqeve. Ka një sistem raportimi për shkeljet e rregullave në fuqi apo raste të raportimit mashtrues.

Parimi 9- Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet e rëndësishme

Ndryshimi është i vazhdueshëm në të gjitha njësitë publike. Ato duhet të kenë një proces formal për të identifikuar ndryshimet e rëndësishme, të brendshme dhe të jashtme, si dhe të vlerësojnë risqet dhe qasjet për të minimizuar riskun në kohë.

-Nga auditimi mbi zbatimin e këtij parimi rezulton se efektiviteti i sistemit të kontrollit të brendshëm paraqitet në nivel normal.

-Bashkia Tropojë ka marrë në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni për rrjedhojë këto ndryshime strukturore apo menaxheriale janë ndjekur nga ndryshime në rregulloren e brendshme, manualet e proceseve të punës apo në përshkrimet e punës.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-*Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 21, pika 2;*

-Udhëzimi nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 3 “Përgjegjësitë dhe detyrat e KR”, pika 3.2.1 “Titullari i njësisë publike” pika 4 “Hapat për ngritjen e sistemit të MR”

-“Manuali për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.2, Kapitulli V.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Veprimtaritë e Kontrollit përfshijnë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase.

Parimi 10 – Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitetet e kontrollit.

Nuk ka "zgjedhje ideale" në zgjedhjen e aktiviteteve të duhura të kontrollit. Përkundrazi, aktivitetet e kontrollit, ose një kombinim i aktiviteteve të kontrollit (politikat, procedurat dhe përgjegjësitë) duhet të zgjidhen për të zvogëluar në mënyrë të mjaftueshme riskun e mosrealizimit të objektivave në një nivel të pranueshëm. As menaxhimi dhe as auditimi i brendshëm nuk duhet të fillojnë një analizë të aktiviteteve të kontrollit me një listë të kontrolleve dhe të identifikojnë nëse janë të pranishëm apo jo. Përkundrazi, kontrollet duhet të vlerësohen në raport me risqet që duhet të minimizohen.

-Në vijim të auditimit të kryer, mund të themi se ka problematika për t'u adresuar, të cilat lidhen kryesisht me mungesën e hartave apo manualeve të proceseve të punës dhe sjellin si pasojë mbivendosjen e detyrave dhe përgjegjësiave.

Përgatitja e një harte me proceset e punës garanton uniformitetin në kryerjen e proceseve të punës, identifikimin e aktiviteteve të kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

-Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultojnë se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ sipas sistemit të dy firmave, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Nga komunikimi me punonjësit e Drejtorisë së Burimeve rezultojnë se ekzekutimi dhe regjistrimi i transaksioneve financiare nuk bëhen nga i njëjti person. Detyrat janë të ndara. Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga nëpunësi zbatues, regjistrohet nga specialisti i buxhetit dhe miratohet nga nëpunësi zbatues. Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga specialisti për kontabilitetin dhe autorizimi i pagesës kryhet nga nëpunësi autorizues.

-Në zbatim të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020“Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bashkia ndjek procedurat për organizimin e prokurimeve, kanë komisione për prokurim, komisione për hartimin e specifikimeve teknike, komisionin e vlerësimit të ofertave, komisionin për pranimin e mallit etj..

-Në zbatim të Udhëzimit nr. 01 datë 05.01.2018 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të PP, është dërguar Regjistri i Parashikimeve, me Nr. 269 Prot., datë 15.01.2024, regjistri shtesë me nr. 269/1 datë 20.06.2024 si dhe përsëri ndryshim me regjistër shtesë pas 10 mujorit me nr. 269/2 Prot. date 18.11.2024, në sistemin e Prokurimeve Publike”

Regjistri i realizimeve të prokurimeve është dërguar sipas shkresës me nr.269/3 date 17.01.2025.

-Bashkia Tropojë ka krijuar një regjistër aktivesh i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet.

-Për dokumentacionin e financës parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat. Ka procedura të miratuara nga titullari dhe gjurmë auditit për inventarizimin, tjetërsimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktivëve afatgjata materiale. Procedurat për inventarizimin, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit bëhen duke u bazuar në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike” i ndryshuar.

Gjurma e auditimit- Gjurma e auditimit përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Qëllimi i përgjithshëm i gjurmës së auditimit është të ndihmojë menaxhimin të vlerësojë përshtatshmërinë e sistemeve të MFK-së në kuadër të një procesi të caktuar si dhe të identifikojë boshllëqet, mbivendosjet, ose dublimet ndërmjet strukturave të ndryshme të njësisë.

Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit, të detajuara për procedurat kryesore dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë.

-Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se, bashkia ka ndërtuar gjurmë auditimi të miratuara për proceset kryesore të punës.

Gjurma e auditimit duhet të ndërtohet dhe rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Parimi 11 - *Njësia Publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të përgjithshme të kontrollit mbi teknologjinë.*

Teknologjia është bërë një element kyç operacional i pothuajse çdo organizate. Megjithatë, ekzistojnë kërcënime për objektivat organizative nëpërmjet depërtimit të jashtëm të rrjetit, mungesës së kujdesit në testimin e softuerit ose thjesht proceseve të dobëta të sigurisë. Çdo organizatë duhet të identifikojë kontrollet e përgjithshme dhe efektivitetin e tyre për të zbutur këto kërcënime të rëndësishme.

-Bashkia Tropojë ka sisteme funksionale të IT-së të ndryshme nga ato fikse (pra përveç sistemeve qeveritare si APP, SIFQ, PBA, HRMIS).

-Nga auditimi rezulton se bashkia ka një procedurë të rikuperimit dhe të ruajtjes, back-up- it. Bashkia ka vendosur procedura për të siguruar vazhdimësinë e veprimeve kundrejt risqeve kryesore që mund të pengojnë këtë veprimtari. Pra, ka plane të riskut për sigurinë e aktiveve nga zjarri/përmytjet dhe rimëkëmbjet nga fatkeqësitë.

Parimi 12 – *Njësia Publike vendos aktivitete kontrollit përmes politikave dhe procedurave.*

Përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit duhet të identifikohen dhe komunikohen përmes politikave dhe procedurave të ndryshme. Proceset duhet të jenë në vend për të siguruar që të gjitha aspektet zbatohen dhe funksionojnë.

-Bashkia i ka ndarë/përcaktuar qartazi përgjegjësitë për aktivitetet e kontrollit për drejtuesit dhe gjithë personelin e saj në mënyrë të tillë që i njëjti person të mos kryejë detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar ose jo financiar. Ka procedura të shkruara operative për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-*Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a,b,c,d,dh,e,ë, Kreu II, neni 16, pika 2, Kreu III, neni 22, pika 1;*

-*Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”, pika 5.2.7 “Monitorimi dhe Raportimi”;*

-*“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V.*

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Informimi dhe komunikimi përfshin identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të

duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse. Komunikimi me taksapaguesit, furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv. Informacioni është baza e komunikimit që nevojitet për kryerjen efektive të detyrave të ngarkuara.

Rëndësia e kanaleve të informacionit dhe komunikimit me të cilat informacionet transferohen mund të shihet drejtpërdrejt në procesin e vendimmarrjes. Cilësia e një vendimi të marrë është e kushtëzuar nga cilësia e informacionit në drejtim të kohës, përshtatshmërisë, saktësisë dhe disponueshmërinë.

Parimi 13 - *Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacionin përkatës cilësor.*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohet nëse njësia publike merr, gjeneron dhe përdor informacion të rëndësishëm, cilësor për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Në vijim të auditimit, rezulton se bashkia i kushton rëndësinë e duhur përcjelljes së informacionit dhe raportimit. Bashkia ka një sistem komunikimi si brenda dhe jashtë institucionit pra ky sistem jep informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

-Procesi i komunikimit dhe informimit në institucion realizohet nëpërmjet shkresave zyrtare me institucionet e tjera si dhe duke përdorur linjat e brendshme të komunikimit.

-Punonjësit kanë akses në përdorimin e postës elektronike me qëllim transmetimin e informacionit në kohë më të shkurtër.

-Institucioni operon me program të vetin të kontabilitetit, në përputhje me udhëzimet dhe ligjin e kontabilitetit të pasqyrave financiare.

Parimi 14 - *Njësia Publike përdor komunikimin e brendshëm.*

Njësia publike komunikon në mënyrë të brendshme informacionin, duke përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë, të nevojshëm për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Përsa i përket krijimit dhe përdorimit të linjave të brendshme të komunikimit, nëpunësit e bashkisë sqarojnë se të gjitha vendimet, projektet, proces verbalet e mbledhjeve komunikohen punonjësve në rrugë zyrtare.

-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.

-Drejtuesit e institucionit njoftohen nëpërmjet shkresave sa herë që ka alokime fondesh.

Parimi 15 - *Njësia Publike përdor komunikimin e jashtëm*

Nëpërmjet këtij parimi vlerësohen procedurat e komunikimit të njësisë publike me palët e treta lidhur me çështjet që ndikojnë në funksionimin e kontrollit të brendshëm.

-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësisë të informacionit.

-Institucioni realizon konsultime publike me qytetarët dhe grupet e interesit për çështje që lidhen me përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Për vitin 2024 janë zhvilluar 5 dëgjesa publike në Bashkinë Tropojë. Dëgjesat Publike janë zhvilluar në lidhje me Paketën Fiskale dhe Projekt Buxhetin për vitin 2024 sipas kalendarit të mëposhtëm:

- Njësia Administrative Bujan në datë 20.10.2024.
- Njësia Administrative Lekbibaj në datë 23.10.2024.
- Njësia Administrative Bytyc, në datë 24.10.2024.
- Njësia Administrative Fierze në datë 26.10.2024.
- Njësia Administrative Tropojë, në datë 30.10.2024.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-*Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a,b,c,ç,d,dh,e,ë, Kreu III, neni 23, “Informacioni dhe Komunikimi” pika 2;*

-*“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.3, Kapitulli V.*

V. Komponenti: “Monitorimi”

Monitorimi realizohet përmes monitorimit në vijueshmëri, vetëvlerësimit dhe auditimit të brendshëm.

Parimi 16 - *Njësia Publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe / ose të veçanta të sistemit të kontrollit të brendshëm.*

Procesi i monitorimit duhet të përfshijë vlerësimin e vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kohë dhe me kosto efektive. Vlerësime të herëpashershme të këtyre sistemeve duhet të kryhen sipas nevojës.

-Nga auditimi i kryer, konstatohet se institucioni ka përcaktuar në rregulloren e brendshme rregullat bazë për raportimin e ecurisë dhe statusit të implementimit të objektivave, janë hartuar manuallet e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

-Bashkia Tropojë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të kryer nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili nuk është dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MFE.

-Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, realizohet edhe nëpërmjet shërbimit të Auditimit të Brendshëm, performuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm . NJAB ka kryer auditim mbi MFK i cili është formal dhe pa u thelluar analitikisht për çdo subjekt të audituar.

-Bashkia Tropojë ka hartuar një dokument të mirëfilltë për ndjekjen e procesit të monitorimit, gjë e cila mund të shkaktojë uljen e performancës së sistemit të kontrollit të brendshëm në këto njësi.

-Bashkia Tropojë ka hartuar planin strategjik të auditit të brendshëm, raportin vjetor dhe raportet e auditimit për çdo auditim të kryer përgjatë vitit 2024.

Parimi 17 - *Njësia Publike vlerëson dhe komunikon mangësitë.*

Kur identifikohen mangësitë e kontrollit të brendshëm, titullari i njësisë publike duhet të ndërmarrë veprimet korrigjuese dhe t'i komunikojë ato në nivelin e duhur dhe në kohën e duhur. Mangësitë mund të identifikohen në nivelin e komponentit ose në procesin e kontrollit të brendshëm në tërësi.

-Në bazë të auditimit të kryer, titullari i institucionit, për rekomandimet e lëna nga KLSH ka ndërmarrë masa korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në mospërputhje me:

-*Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8, pika a, b, c, ç, d, dh, e, ë, Kreu III, neni 24, “Monitorimi” pika 1;*

-*“Manualin për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr.8980/2010 dhe atij nr. 108/2016, Kapitulli III “Komponentët e MFK” pika 3.5, Kapitulli V.*

Auditi i brendshëm

Në Bashkinë Tropojë, është krijuar Sektori i Auditit të Brendshëm, bazuar në strukturën organike nr.59, datë 13.02.2024 me pozicionet 1 përgjegjës dhe dy specialistë, por ky sektor është i paplotësuar me burime njerëzore, duke bërë të të pa mundur zbatimin e detyrave dhe funksionimin e këtij Sektori me rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e institucionit.

Konkluzione:

-Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK, nisur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm funksionojnë, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Theksojmë disa koncepte si:

Komponenti “Mjedisi i kontrollit”

-Nga auditimi konstatohet se nuk është miratuar ende rregullorja e brendshme në përputhje me ndryshimet strukturore e për rrjedhojë nuk ka çdo drejtori, sektor apo njësi, përgjegjësi detyra të mire përcaktuara;

Rezultoni se delegohen përgjegjësitë brenda bashkisë nga ana e menaxherëve nëpërmjet urdhrave të delegimit por nuk analizohen risqet që lidhen me funksionet dhe kompetencat e deleguara.

Bashkia Tropojë nuk disponon një regjistër të detajuar për regjistrimin e trajnimeve të kryera nga nëpunësit e institucionit si dhe nuk parashikohen fonde në buxhet për trajnime në fusha të ndryshme. Komiteti i Auditimit të Brendshëm nuk është krijuar, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 12, 13 të ligjit 114/2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe VKM nr. 160 datë 02.03.2016 “Për mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe përbërjen e Komitetit të Auditimit”.

Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

-Është hartuar strategjia dhe regjistri i risqeve, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Tropojë si dhe në monitorimin dhe raportimin në mënyrë periodike të risqeve me impakt të lartë me qëllim menaxhimin efektiv të tyre; Regjistër risku me nr.378/4 date 29.01.2024.

-Ka plan-veprime për menaxhimin e riskut. Plan veprimi me nr.378/2 date 29.01.2024.

Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Nga të dhënat e vëna në dispozicion, rezultoni se asnjë prej drejtorive nuk ka hartë dhe manual të proceseve të punës.

Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

-Faqja zyrtare e institucionit përditësohet rregullisht dhe punonjësit kanë e-mail zyrtar.

-Bashkia siguron qasje publike nëpërmjet publikimit rregullisht në faqen e internetit të njësive të informacionit.

Komponenti: “Monitorimi”

-Bashkia Tropojë monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili nuk është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MF.

-Bashkia Tropojë e ka përfshirë në Strukturën Organike Njësive e Auditit të Brendshëm me nr.59, datë 13.02.2024 me pozicionet 1 përgjegjës dhe dy specialistë, por nga verifikimi i dosjeve të personelit dhe struktura organizative, u konstatua se kjo strukturë është jo funksionale dhe nuk ka punonjës që ushtrojnë funksionin e audituesit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga informacioni i marrë nga pyetësorët drejtuar subjektit u konstatua se nuk është lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi.

Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar nën 10 dhe Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nën 49. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pika 1.

Për sa më sipër, mban përgjegjësi Titullari i Bashkisë Tropojë, znj. Z.I si dhe përgjegjësjat e Sektorit të Burimeve Njerëzore, znj. K.A.

2.2.1. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

2.2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre.

2.2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme

2.2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat dhe mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:

- *Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;*
- *Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;*
- *Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2012, datë 7.12.2012 dhe ligjin nr. 57/2016, datë 02.06.2016;*
- *Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;*
- *Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.*
- *Udhëzim nr.13., datë 18.12.2024 “Për Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të buxhetit për vitin 2024”*
- *Udhëzimi nr.9., datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar.*
- *Udhëzimi nr.35., datë 29.12.2023 “Për procedurat për menaxhimin e vështirësive financiare për njësite e vetëqeverisjes vendore”*
- *Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësite të vetëqeverisjes vendore”;*
- *Udhëzim plotësues nr.1., datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit për vitin 2024”.*

2.1. Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiar. Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre & 2.2. Auditimi i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të llogarive të arkëtueshme dhe llogarive të pagueshme.

Për të arritur në opinionin, në se pasqyrat financiare për vitin 2024, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare, aktiveve neto, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësite të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, u analizuan pasqyrat financiare të vitit 2024, konkretisht:

- **Pasqyrat Financiare të vitit 2024.**
- Për auditimin e Pasqyrave Financiare të vitit 2024 është marrë në shqyrtim dokumentacioni i mëposhtëm:
- Pasqyrat financiare të vitit 2024;
- Ditari i Bankës;
- Akt- rakordimet me Degën e Thesarit Tropojë;
- Inventarët etj.

- **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.**
- **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2024 janë:**
- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasqyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasqyrat financiare (F5);
- Pasqyrat statistikore:
- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);

- Gjithashtu është dhënë informacion mbi:
- Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Tropojë me NIPT K49326606C;
- Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2024-31.12.2024;
- Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
- Përgatitur nga znj. F.H;

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Tropojë për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike.

I. Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:

Pasqyrat Financiare janë hartuar për Degën e Thesarit Tropojë me shkresën nr.1576, datë 26.03.2024. Nga auditimi i formatit të raportimit të siglimit në mënyrë digjitale te pasqyrave financiare u konstatua që pasqyrat financiare janë përgatitur dhe sigluar në mënyrë digjitale nga përgjegjësja e sektorit të financës znj. A,M datë 16.04.2025 nga nëpunësja zbatuese Znj. F.H datë 16.04.2025 dhe nga znj. Z.I, nëpunës autorizues Kryetari i komanduar i Bashkisë Tropojë datë 16.04.2025 dhe konfirmuar nga thesari datë 17.04.2025.

Konkluzion : Nga auditimi i formatit të raportimit të siglimit në mënyrë digjitale te pasqyrave financiare u konstatua që pasqyrat financiare janë përgatitur dhe sigluar në mënyrë digjitale jashtë afateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 118. “Njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore të ushtrimit të mbyllur brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet të bëhet duke dërguar një kopje në degën e thesarit të rrethit përkatës të juridiksioni, një kopje në Këshillin e Qarkut të Juridiksionit dhe një kopje në zyrën e statistikave të rrethit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. Z.I, Kryetare e Bashkisë Tropojë/nëpunës autorizues

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. A. M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

Pjesë përbërëse e dokumentacionit mbi pasqyrat financiare dhe raportimit financiar janë Akt rakordimet mbi shpenzimet dhe të ardhurat me Degën e Thesarit Tropojë të konfirmuara dhe nënshkruara nga Nëpunësi Zbatues Znj. F.H dhe Nëpunësi Autorizues Znj. Z.I, kryetar i Bashkisë Tropojë e komanduar, si dhe Përgjegjësi i Degës së Thesarit Tropojë.

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lartë për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

II. Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:

Për vitin 2024 nga verifikimi i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari vitin 2024) për shumat për çdo llogari dhe në total vjetor konstatohet se

nuk ka diferenca thelbësore. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve. Nga verifikimi i ditarit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara llogaria 604 në vlerën prej 7,750,773 lekë ndërsa sipas thesarit rezultojnë në vlerën 8,014,320 lekë me një diferencë prej 263,457 lekë me shumë thesari e cila vjen si rezultat i klasifikimit të gabuar të llogarisë 604 Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë me llogarinë 606 Transferta për buxhet familjarë e individët, e cila rezulton 263,457 lekë më pak.

Tabela 2/1: Rakordimi i llogarisë 604 dhe 606 thesar shpenzime buxhetore/lekë

Nr.	Nr. i llogarisë	Vlera sipas thesarit pas rakordimit	Vlera e ditarit të shpenzimeve buxhetore	Diferenca
1	604	8,014,320	7,750,773	263,457
2	606	351,062,568	351,326,025	(263,457)
Totali		359,076,888	359,076,798	-

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë/përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Nga verifikimi i ditarit të shpenzimeve buxhetore për vitin 2024 rezultojnë shpenzime të realizuara llogaria 604 në vlerën prej 7,750,773 lekë ndërsa sipas thesarit rezultojnë në vlerën 8,014,320 lekë me një diferencë prej 263,457 lekë me shumë thesari e cila vjen si rezultat i klasifikimit të gabuar jo material të llogarisë 604 “Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë” me llogarinë 606 “Transferta për buxhet familjarë e individët”, e cila rezulton 263,457 lekë më pak.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025: “Siç ju kemi sqaruar edhe më parë nga ana jonë kontabilizimi në ditarin e shpenzimeve është bërë në mënyrë të saktë, si për llogarinë 600 ashtu edhe për llogarinë 604, pasi në urdhër shpenzim është e njëjta llogari ashtu siç është i regjistruar edhe në ditarin e shpenzimeve. Ju kemi bashkëngjitur dokumentin (USH nr. 191, dt.12.06.2024). Edhe për vlerën 263,457 lekë ku nga ana e thesarit janë regjistruar gabimisht nga llogaria 606 në llogarinë 604. Kjo vlerë ju përket Urdhër shpenzimeve:

Urdhër-Shpenzimi nr. 41, dt. 22. 02. 2024, për vlerën 200,000 lekë, ndihmë e menjëhershme për znj.N. D, për arsye shëndetësore e cila kontabilizohet në llogarinë 606 (këtë dokument jua kemi bashkëngjitur).

Urdhër Shpenzimi nr. 437, dt. 31. 12. 2024, për vlerën 63,457 lekë, që është ndihmë e menjëhershme në kapitullin 05.

Të dy këto regjistrime në vlerën totale prej 263,457 lekë të bëra gabim nga Thesari i përkasin të njëjtit Kod Programi 04970, por që thesari gabimisht i ka regjistruar tek Llogaria 604 e të njëjtit program ”.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Subjekti në observacion ka paraqitur Urdhër-Shpenzimin nr. 41, dt. 22. 02. 2024, për vlerën 200,000 lekë, e kontabilizuar në llogarinë 606 dhe Urdhër Shpenzimi nr. 437, dt. 31. 12. 2024, për vlerën 63,457 lekë, e kontabilizuar në llogarinë 606 Të dy këto regjistrime në vlerën totale prej 263,457 lekë janë të kontabilizuara në llogarinë 606 nga subjekti , por që thesari i ka paraqitur në llogarinë 604.

Subjekti gjithashtu ka paraqitur VKB nr.10., datë 08,02,2024 i cili parashikon që burimi i financimit për ndihmën financiare për arsye shëndetësore për vlerën 200,000 lekë të përballohet nga fondi rezervë programi buxhetor 04970. Nga ana e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit nuk është paraqitur kërkesë ndaj degës së thesarit për saktësimin e llogarisë 604 “Transferime korrente tek nivele të tjera të Qeverisë” dhe llogarisë 606 “Transferta për buxhet familjarë e individët” për te saktësuar financimin sipas programit buxhetor që është fondi rezerve, rrjedhimisht observacioni nuk merret në konsideratë dhe gjetja do të trajtohet në raportin përfundimtar të auditimit.

Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5/a, me ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar nenet 6 dhe 9.

Veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar ,neni 22, pika 3, germa “dh”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare të konsoliduara, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Tropojë për aktivitetin ekonomiko-financiar për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur nga Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike. Për dhënien e opinionit financiar ne kemi përlllogaritur materialitetin e shpenzimeve në vlerën 9,360,535 lekë dhe materialitetin e te ardhurave për vlerën 8,147,163 lekë. (paraqitur në anekset bashkëngjitur këtij RPA-je).

Procesi i inventarizimit:

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës.

Me urdhrin nr.401., datë 20.12.2024 me nr.5391.prot., datë 23.12.2024 është ngritur komisioni i inventarizimit i bashkisë Tropojë .

1-Për inventarizimin e Zyrave të administratës Njësia Qendër

2-Për inventarizimin e shkollave, çerdheve, kopshteve, Njësia Qendër

3-Inventarizimin e zyrave njësia administrative Lekbibaj

4- Inventarizimin e zyrave njësia administrative Fierzë

5- Inventarizimin e zyrave njësia administrative Llugaj

6- Inventarizimin e zyrave njësia administrative Tropojë

7- Inventarizimin e zyrave njësia administrative Margegaj

8- Inventarizimin e zyrave njësia administrative Bytyç

9- Inventarizimin e zyrave njësia administrative Bujan

10-Inventarizimi për qendrën dhe njësite për ndërtime dhe konstruksione

11- Inventarizimi për qendrën dhe njësite për rrugë, rrjete, vepra ujore

12-Inventarizimi i automjeteve për qendrën

Me urdhrin nr.401/1., datë 23.12.2024 me nr.5391/1.prot., datë 23.12.2024 është ngritur komisioni i inventarizimit i bashkisë Tropojë me personat përgjegjës (vlera e inventarit llogaria 2181,215,312, në vlerën 13,986,398 lekë)

Me urdhrin nr.401/2., datë 23.12.2024 me nr.5391/2.prot., datë 23.12.2024 është ngritur komisioni i vlerësimit të materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Me urdhrin nr.401/3., datë 23.12.2024 me nr.5391/3.prot., datë 23.12.2024 është ngritur komisioni i asgjësimit të aktiveve të vlerësuara për nxjerrje jashtë përdorimit.

Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjësimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-daljet nga magazina etj. Nga auditimi i përmbledhëses së inventarëve të hartuar nga drejtoria e Financës dhe Buxhetit pas rakordimit me inventarët e përpiluar nga komisionet e inventarizimit nuk rezultojnë diferenca të inventarëve sipas koston së tyre historike me përjashtim të llogarisë 215. Për vitin 2024, për llogarinë nr. 215, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit për vlerën 3,452,393 lekë.

Konkluzion : Për vitin 2024 llogaria nr. 215 “Mjete transporti”, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit.

Llogaria nr.215 “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 për vitin 2024 ka vlerën 70,536,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 67,083,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak. Kjo vlerë si diferencë ka ekzistuar edhe në vitin 2023 dhe është trajtuar edhe në raportin e mëparshëm të KLSH-së. Llogaria 215 “Mjete transporti”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2024.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në lidhje me mospërputhjen midis vlerave të pasqyruara në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit ne i qëndrojmë përsëri argumentimit tonë dhe ju sqarojmë përsëri se kjo mospërputhje në vlerën prej 3,452,393 lekë, diferencë kjo që ka ekzistuar që në vitin 2015 dhe vjen nga ish. Komuna Lekbibaj dhe është shënuar në çdo bilanc, ashtu siç jua vura në dispozicion edhe bilancin e vitit 2019 dhe në çdo auditim që është bërë është kërkuar nga ana jonë që të udhëzohemi se si të veprojmë pasi punonjësi ka ndërruar jetë dhe kanë kaluar pothuajse 10 vite dhe nuk është përgjegjësia ime që ekziston kjo diferencë. Në këto rrethana unë nuk mund ta heq nga bilanci, pasi nuk kam asnjë dokument justifikues se ku bazohem për ta hequr. Ky fakt do të duhej të ishte rregulluar me kohë, pasi auditime janë bërë çdo vit dhe vetëm sa janë bërë konstatime dhe nuk është dhënë asnjë sugjerim se si mund të rregullohet ky problem.

Po ju sqaroj se kjo diferencë nuk i përket vitit 2024 dhe as vitit 2023 për të cilin bilanci është mbyllur nga ana ime, por duke qenë se Ju deklaroni se pretendimet nuk mund ti provoni dot dhe qëndrimi I grupit të auditimit do të jetë i njëjtë në projekt raport auditim, po ju dërgoj edhe:

1. *Pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor 2020, nr. 1504.Prot, dt. 10. 05. 2021 (pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2020).*

2. *Pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor 2021, nr. 1657.Prot, dt. 12. 04. 2022 (pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2021).*

3. *Pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor 2022, nr. 1823.Prot, dt. 31. 03. 2023 (pyetësor dhe shënime shpjeguese për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për vitin 2022).*

Në të tre këto pasqyra është e pasqyruara vlera e diferencës prej 3,452,393 lekë, tek llogaria 215 – Mjete transporti.

Për sa sipër kërkojmë përsëri nga ana Juaj të na sugjeroni se si të veprojmë, ku në rastin konkret nuk kemi asnjë bazë dokumentare, është detyrim i mbartur tash 10 vite dhe personi që

e ka pasur në ngarkim ka ndërruar jetë. Ky detyrim është pasqyruar në çdo bilanc dhe po ju dërgojmë edhe bilancet e viteve 2019 – 2022, pra janë katër balance të bëra para se unë të filloj marrëdhëniet e punës pranë Bashkisë Tropojë (filluar punë në Prill 2023).

Këto problematika kanë qenë që më përpara dhe me ndryshimet e bëra me legjislacionin për pushtetin vendor, të gjitha detyrimet e Komunave kanë kaluar në Bashki. Dokumentacioni është me shumë mungesa dhe pothuajse nuk ka fare dhe detyrimet janë të komunave dhe të pasqyruara vetëm në balance dhe nuk është marrë asnjë masë, pasi janë evidentuar si problematika edhe nga auditimet që janë ushtruar pranë komunave, nder vite, me të cilat në atë kohë Bashkia nuk kishte asnjë autoritet ndaj këtyre komunave.

Ju mund të shikoni auditimet ndër vite të kryera në Bashkinë Tropojë apo në Ish. Komunitat dhe ky fakt vërtetohet lehtësisht.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni në lidhje me historikun e diferencës së vlerës prej 3,452,393 lekë që ekziston si diferencë nga inventarizimi i mjeteve të transportit nuk janë paraqitur të dhëna të reja në lidhje me dokumentacionin justifikues të mungesës së kësaj vlere si dhe procedurat e ndjekura në lidhje me saktësimin e kësaj diference. Pretendimet e subjektit në lidhje me punonjësin dhe mungesën e dokumentacionit nuk sjellin të dhëna të reja në lidhje me masat e marra për saktësimin e diferencës midis inventarit fizik dhe atij kontabël për mjetet e transportit. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi i grupit të auditimit do të jetë i njëjtë në raportin përfundimtar të auditimit.

Këto veprime janë në kundërshtim me *Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30 në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues,

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrollat të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Tropojë për vitin 2024 paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2/4 Aktivi i Bilancit Kontabël 2024.....lekë

Llogari	E M E R T I M I	2024	2023
A	A K T I V E T	3,644,955,804	3,510,493,689
	I. Aktivet Afat shkurtra	261,243,713	248,383,967
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	109,739,505	106,217,052
520	Disponibilitete ne Thesar	109,739,505	106,217,052
	2.Gjendje Inventari qarkullues	16,882,283	16,117,654
31	Materiale	2,873,808	2,284,067
32	Inventar i imët	14,008,475	13,833,587
	3.Llogari te Ar këtushme	134,621,925	126,049,261
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	48,934	48,934
468	Debitorë te ndryshëm	61,390,362	46,040,560
4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	73,182,629	79,959,767
	II. Aktivet Afat gjata	3,383,712,091	3,262,109,722
20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	15,036,081	15,188,978
202	Studime dhe kërkime	15,036,081	15,188,978
21	2.Aktive Afatgjata materiale	3,313,236,219	2,857,028,224
210	Toka, Troje, Terrene	22,460,270	22,460,270
211	Pyje, Plantacione	10,017,959	10,017,959

	Ndërtesa e Konstruksione	1,052,827,748	1,079,846,799
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	2,160,127,437	1,674,708,410
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	16,367,413	13,873,236
215	Mjete Transporti	17,623,399	16,851,150
218	Inventar ekonomik	22,040,611	27,499,018
24	Aktive afatgjata te dëmtuara	11,771,382	11,771,382
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	4,960,000	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	4,960,000	
	4.Investime	50,479,791	389,892,520
231	Për Aktive Afatgjata materiale	50,479,791	389,892,520

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropojë

B. Pasivet(Detyrimet) janë në vlerën 179,898,460 lekë

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivneto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 3,465,057,344 lekë.

- Aktivet 3,644,955,804 lekë
- Pasivet 179,898,460 lekë
- Aktivet neto 3,465,057,344 lekë

Aktivi i Bilancit

Aktivt afatshkurtra

Aktivt afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën **261,243,713 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “*Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre*” në shumën 109,739,505 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “*Gjendje inventari qarkullues*” në shumën 16,882,283 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “*Llogari të arkëtueshme*” në shumën 134,621,925 lekë dhe
- “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 0 lekë.

Vlera e llogarisë 520 “*Disponibilitete në thesar*” paraqitet në pasqyrat financiare në shumën 109,739,505 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e fondeve në thesar më 31.12.2024 në shumën 64,462,970 lekë që përbën fitimin e periudhës ushtrimore viti 2024 dhe gjendja e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*” e cila paraqitet në shumën 45,276,535 lekë. Për sa më sipër llogaria disponibilitete në thesar llogaria 520 kuadron me shumën e llogarisë 85 “*Rezultati i veprimtarisë ushtrimore*” + shumën e llogarisë 466 “*Mjete në ruajtje*”

-Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Tropojë në 31.12.2024 paraqiten në vlerën 16,882,283 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “*Materiale*” në vlerën 2,873,808 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “*Objekte inventari*” në vlerën 14,008,475 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (764,629) lekë, përbën efektin në shpenzime e cila kuadron me llogarinë 63 “*Ndryshimi gjendjes së inventarit*” (pasqyra F2 – *performanca financiare*).

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitet e sektorit publik*”, i ndryshuar. Titullari i Bashkisë Tropojë ka nxjerrë urdhrin nr.401/1., datë 23.12.2024 me nr.5391/1.prot., datë 23.12.2024, sipas të cilit është ngritur komisioni i inventarizimit i bashkisë Tropojë.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “*Ndryshimi i gjendjeve të inventarit*”.

Llogaritë e arkëtueshme janë në vlerën 134,621,925 lekë, të përbëra nga:

- Llogaria 423-429 “*Personeli, deficite, gjoba, paradhënie*” në vlerën prej 48,934 lekë, që përbëhet detyrime të punonjësve e pa ndryshuar nga viti i kaluar;
- Llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në vlerën prej 61,390,362 lekë përbën detyrimet për taksa dhe tarifa vendore, si dhe detyrime nga subjekte që kanë për qiratë të ndryshme. Kjo

Ilogari është shtuar gjatë vitit 2024 në vlerën prej 15,349.802 lekë që përbën rritjen e detyrimeve tatimore të pa paguara nga subjektet në administrimin e taksave dhe tarifave vendore.

Kjo Ilogari për vitin 2024 është debituar për vlerën 19,874,125 lekë dhe është kredituar për vlerën 4,524,323 lekë për likuidimet e detyrimeve nga taksat dhe tarifat vendore për bizneset:

Tabela 2/5:Lëvizja e Ilogarisë 468 ‘‘Debitorë të ndryshëm’’ për vitin 2024 /lekë

Lëvizja e Ilogarisë 468 Sintetike			Viti 2024			
Viti	Bashkia Tropojë dhe NJA	Përshkrimi	Gjendja 31.12.2023	Debi	Kredi	Mbetja
2024		Debitorë te ndryshëm	46,040,560	19,874,125	4,524,323	61,390,362

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropoje

Në mënyrë të detajuar të dhënat për Ilogarinë 468 shtesat dhe pakësimin janë si më poshtë vijon:

Tabela 2/6 :Ndryshimet e Ilogarisë 468 ‘‘Debitorë të ndryshëm’’ gjatë vitit 2024 /lekë

Nr.	Përshkrimi	Vlera/lekë
1	Gjendje e debitorëve me 1.01.2024	46,040,560
2	Shtesa e debitorëve për taksa dhe tarifa e vitit 2024	6,490,214
3	Shtese debitorëve nga kontratat e qirave te ndryshme.	13,383,911
4	Arkëtimet e debitorëve të bizneseve te viteve te mëparshme.	4,524,323
6=1+2+3-4	Gjendja e debitorëve me 31.12.2024	61,390,362

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropojë

Referuar raportit të mëparshëm të auditimit, lista analitike e debitorëve në fund të vitit 2023 - fillim të vitit 2024, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën 13,002,090 lekë, si më poshtë vijon:

- vlera prej 11,021,770 lekë nga kontratat e qirave për 12 subjekte.
- vlera prej 1,600,000 lekë për 7 subjekte nga gjobat e vendosura nga IMTV.
- vlera prej 360,320 lekë nga taksa e fjetjes në hotele për 13 subjekte.
- vlera prej 20,000 lekë për 2 subjekte nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.

Rezultoni që gjatë vitit 2024, nga sektori i tatim taksave nuk është dërguar për kontabilizim:

- vlera prej 1,600,000 lekë për 7 subjekte nga gjobat e vendosura nga IMTV.
- vlera prej 191,430 lekë nga taksa e fjetjes në hotele për 13 subjekte dhe
- vlera prej 20,000 lekë për 2 subjekte nga gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake.

Nga të dhënat e sektorit të tatim taksave bazuar në shkresën nr. 683.prot., datë 03.02.2025, shtesa e debitorëve për vitin 2024 në vlerën prej 6,490,214 lekë përfaqëson detyrimet e bizneseve në fund të vitit 2024 dhe përbëhet nga kamatëvonesat për bizneset në vlerën prej 2,727,520 lekë për 120 biznese, debitorë të bizneseve të krijuar gjatë vitit 2024 për 84 biznese në vlerën prej 3,011,463 lekë, detyrimet nga operatorët ekonomik 1 operator në vlerën 136,000 lekë, detyrime nga 2 institucione shtetërore në vlerën prej 256,480 lekë dhe detyrimet nga subjektet e hotelierisë 17 subjekte në vlerën prej 358,751 lekë.

Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Tropojë me gjithë rekomandimet e dhëna në vazhdimësi nga KLSH, nuk ka marrë masa për:

- përditësimin e regjistrit me numrin e saktë të familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë.

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë vazhdon të mos e disponojë këtë regjistër edhe për vitin 2024. Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.

Gjendja e debitorëve progresiv të të gjithë llojeve të taksave dhe tarifave vendore deri më datë 31.12.2023, rezultoni në vlerën 46,040,560 lekë, dhe në fund të vitit 2024 është 61,390,362

lekë, ku gjatë vitit 2024 janë paguar detyrime në total në vlerën 4,524,323 lekë dhe janë shtuar debitorë në vlerën 19,784,125 lekë, të pa arkëtuara të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë për vitin 2024. (të detajuar në tabelën 2.6, Lëvizja e llogarisë 468 debitorë të ndryshëm për vitin 2024).

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Konstatohet një tendencë në rritje e detyrimeve të prapambetura dhe mos marrje masash për arkëtimin e detyrimeve duke rritur “moshën” e borxhit të vjetër dhe duke e vendosur Bashkinë Tropojë, para një risku në rritje në mos arkëtimin e të ardhurave të planifikuara vit pas viti, në kundërshtim me Kreun XI-“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, Ligjin 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar.

Nga sektori i Taksave dhe tarifave vendore, nuk janë marrë masa për dërgimin e urdhër bllokimeve dhe monitorimin 30 ditor nga dërgesa e njoftim vlerësimit fillestar mbi detyrimet e lindura për çdo subjekt BM apo BV.

Më poshtë paraqitet situata në lidhje me detyrimet për kontabilizim për debitorët që kanë rezultuar në fillim të vitit 2024.

Tabela 2/7 Kontabilizimi i detyrimeve të prapambetura /lekë

Lloji i detyrimit	Nr. i subjekteve sipas KLSH (1)	Gjendje detyrim sipas KLSH 01.01.2024(2)	Gjendje detyrim sipas sektorit të taksave 01.01.2024 (3)	Gjendje detyrim 31.12.2024 sipas sektorit të taksave (4)	Vlera e pa kontabilizuar (5)
Detyrime për hoteleri	13	360,320	168,890	358,751	191,430
Kontratat e qirave	12	11,021,770	0	13,383,911	0
Gjobat e IMTV	7	1,600,000	0	0	1,600,000
Gjobat bashkia	2	20,000	0	0	20,000
Totali		13,002,090	168,890	13,742,662	1,811,430

Burimi: Sektori i tatim taksave / Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropojë

Konstatohet se nga sektori i tatim taksave i është dërguar Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për kontabilizim me shkresën nr.1738/1.prot., datë 08.04.2025, vlera prej 13,383,911 lekë për kontratat e qirave për subjektet si më poshtë vijon:

Tabela 2/8 Debitorët e kontratave të qirave në fund të vitit 2024 /lekë

Nr.	Emri i subjektit	Vlera e qirasë (ne leke)
1	T	95,000
2	SH	606,920
3	V	255,000
4	A	2,367,475
5	M, ShPK	575,000
6	L, ShPK	1,266,000
7	V	591,000
8	S, ShPK	343,200
9	P.GJ	209,604
10	H, ShPK	6,305,112
11	B, ShPK	413,600
12	V	356,000
Totali		13,383,911

Burimi: Sektori i tatim taksave / Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropojë

Referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së si dhe nga të dhënat analitike të veprimeve të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” u konstatua që gjendja në fund të vitit për vlerën 61,390,362 lekë nuk pasqyron drejt vlerën e debitorëve pasi nuk janë të përfshirë si dhe nuk janë përfshirë detyrimet që kanë familjaret për taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2023 dhe 2024.

Konkluzion: Nga auditimi konstatohet që nga Sektori i tatim taksave që nuk janë dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Financës dhe buxhetit vlera prej 1,811,430 lekë e përbëre nga 191,430 lekë për detyrimet e hoteleve, vlerat për gjobat e IMTV për 7 subjekte në vlerë

1,600,000 lekë, dhe vlera e gjobave të policisë bashkiake për vlerën prej 20,000 lekë për dy subjekte.

Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ruajtur gjurmën e auditimit për regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 për familjarët si dhe nuk ka dërguar për kontabilizim detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore për familjarët. Mungesa e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për familjarët të ruajtur si gjurme auditimi në protokoll dhe mos dërgimi i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore për familjarët për kontabilizim pranë financës nuk jep siguri në auditimin e faturimeve të taksave dhe tarifave vendore dhe ngjarjeve ekonomike që kanë ndodhur gjatë vitit 2024 në lidhje me faturimet e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 dhe vlerat e tyre debitorë në fund të vitit 2024.

Spektori Taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masat e nevojshme për përpunimin në kohë reale të regjistrit të taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2024, në mënyre që të ketë të dhënat për situatën e faturimit të taksave dhe tarifave vendore si dhe gjoba-kamatëvonesa për vitin 2024.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Llogaritë e arkëtueshme (468).

Në lidhje me llogarinë 468-Debitorë të ndryshëm në vlerën prej 61,390,362 lekë që përbën detyrimet për taksat dhe tarifa vendore si dhe detyrime nga subjekte që kanë për qira të ndryshme, ju sqarojmë se vlera prej 11,021, 770 për 12 subjekte, që pretendohet nga ana Juaj si debitor në fund të vitit 2023 dhe fillim të vitit 2024, ju sqarojmë se është bërë kontabilizimi për detyrimet e qirave dhe i përket shumës 13,383,911 lekë, ku këtu janë të pasqyruara vetëm detyrimet e kontratave të qirasë gjendje me dt. 31. 12. 2024, ku kuptohet se është bërë kontabilizimi edhe i viteve të mëparshme.

Edhe përsa I përket vlerës 360,320 lekë nga taksat e fjetjes në hotele për 13 subjekte është bërë kontabilizimi dhe këto lista analitike jua kemi dërguar, pasi kjo shumë I përket një auditimi të mëparshëm dhe në bilanc është kontabilizuar gjendja me 31. 12. 2024.

Ju sqarojmë se nuk kemi bërë vetëm kontabilizimin e gjobave të vendosura nga IMT dhe dy gjoba të Policisë Bashkiake, ku siç ju kemi sqaruar nuk janë kontabilizuar dhe do vijojmë punën për kontabilizimin e tyre, nëse këto gjoba rezultojnë që nuk janë shfuqizuar sipas Ligjit 127/2024 dhe përcaktuar procedurat që do ndiqen për shfuqizim me VKM nr. 274, i cili është miratuar me dt. 09. 05. 2025.

Nga ana jonë ju kemi vënë në dispozicion dokumentacionin për kontabilizimin e detyrimeve, duke përfshirë detyrimet e gjobave të IMT dhe Polici Bashkiake, për të cilat ju sqaruar me sipër. Për kontabilizimet tjera ju kemi vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës: Shkresë nr. 765.Prot, dt. 07. 02. 2025 "Listat analitike të debitorëve për taksat/tarifatat lokale, të llogaritura në vitin 2024, gjendje me dt. 31. 12. 2024, për efekt të ngarkimit kontabël të vitit 2024", Shkresë nr. 766.Prot, dt. 07. 02. 2025 "Listat analitike të arkëtimit gjatë vitit 2024, të debitorëve për taksat/tarifatat vendore të periudhës 2012 – 2023, për pakësim në Bilancin Kontabël për vitin 2024", shkresë nr. 1738.Prot, dt. 07. 04. 2025 "Kërkesë për informacion" dhe shkresë nr. 1738/1.Prot, dt. 08. 04. 2025 "Dërgim të dhënash mbi detyrimet e kontratave", detyrime të cilat janë kontabilizuar dhe këto akte po jua ridërgojmë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa përshtroni në lidhje me kontabilizimin e kontratave të qirave në vlerën prej 13,383,911 lekë me datë 31.12.2024 grupi i auditimit në konkluzionin e arritur nuk ka cituar që nuk janë kontabilizuar këto vlera në fund të vitit 2024. Nga auditimi konstatohet që nga Spektori i Tatimit Taksave nuk janë dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit vlera prej 1,811,430 lekë e përbërë nga 191,430 lekë për detyrimet e hoteleve, vlerat për gjobat e IMTV për 7 subjekte në vlerë 1,600,000 lekë, dhe vlera e gjobave

të policisë bashkiake për vlerën prej 20,000 lekë për dy subjekte. Observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Pretendimi i subjektit (Sektori i Tatim Taksave), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Vlera debitore për faturat e fjetjes në hotel dhe bujtinë në shumën 360,320 lekë për 13 subjekte gjendje me 31.12.2023, rezulton se vlera 180,455 leke për 9 subjekte është likuiduar deri më datën 30.08.2024, subjekti E.S, me vlerën 6,720 lekë është likuiduar me datën 25.09.2024, subjekti S Shpk me vlerën 3,255 lekë është likuiduar me datën 09.10.2024 dhe vlera 103,950 lekë për subjektin S.M, është arkëtuar gjatë vitit 2025.

Nga shuma 360,320 lekë kanë ngelur pa arkëtuar vlera 65,940 lekë për një subjekt, vlere e cila është kontabilizuar dhe janë marrë masa shtrënguese në zbatim të ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 (i ndryshuar), për procedurat tatimore.

Bashkëlidhur ju dërgojmë urdhër-ekzekutimin për subjektin S.M për vlerën 103,950 lekë dhe dy mandat arkëtimet për subjektet S Shpk në vlerën 3255 lekë dhe E.S në vlerën 6720 lekë që janë likuiduar gjatë vitit 2025 dhe disa Akt-Inventarizime për dhoma dhe shtretër.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni në lidhje me likuidimin e taksës së hoteleve nga subjektet grupi i auditimit ka konstatuar që vlera prej 191,430 lekë ka qenë e pa kontabilizuar në fund të vitit 2024 sipas listës analitike të debitorëve të konstatuar nga raporti i mëparshëm i KLSH-së. Në observacionit tuaj citoni që “Vlera 180,455 leke për 9 subjekte është likuiduar deri me datën 30.08.2024” por nuk keni bashkëngjitur mandatet e pagesës për këto 9 subjekte rrjedhimisht nuk ka një dokument provues nëse këto pagesa janë kryer nga këto 9 subjekte. Për sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7, “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë”.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë e pika 1. “Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi”: Pika 1.3. “Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve”, germa ç).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:

Z. K.B, Përgjegjës i Sektorit të tatim taksave.

Nga auditimi konstatohet që llogaria 468 “Debitorë të Ndryshëm” në vlerën 61,390,362 lekë nuk ka në kundër parti të saj llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” por e ka kundër parti në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin, detyrime”. Llogaria 470, “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” nuk figuron as në llogaritë e pasqyrës se pozicionit financiar dhe as në llogarite e rakordimit me thesarin.

Konkluzion: Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar konstatohet që llogaria 468 në vlerën 61,390,362 lekë e ka kundër parti në llogarinë 4341 “Operacione me shtetin” dhe nuk ka në kundër parti te sajë llogarinë 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë” e cila nuk figuron as në llogaritë e pasqyrës se pozicionit financiar dhe as në llogarite e rakordimit me thesarin, Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese pika 7 germa c “Për konstatimin paraprak të të drejtave për tu arkëtuar debitohe llogaritë e klasës e klasës 4 (411-468) “Debitorë të ndryshëm ” dhe kreditohet llogaria 470 “Llogari në pritje- të ardhura për tu marrë”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues
Znj. Arjela Madani Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit.*

Auditimi i likuidimit të vendimeve të gjykatave dhe kosto e tyre në buxhetin e shtetit.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2024 deri me 31.12.2024) shpenzimet për likuidimin që kanë rrjedhur nga vendimet gjyqësore të formës së prerë për gjyqe fituesit e larguar nga puna si dhe pensione të pa llogaritura saktë, përfshirë dhe tarifën përmbartimore në rastet kur është aplikuar një e tillë, paraqitet në Tabelën nr. **2.9**.

Tabela 2.9 Shpenzimet sipas vendimeve të gjykatave

Nr .	Emër Mbiemër	Vendim i Gjykatës, nr. Datë	Vlera për tu ekzekutuar	Shuma e ekzekutuar deri ne 31.12.2023	Vlera e ekzekutuar për vitin 2024	Vlera e mbetur e pa ekzekutuar ne 31.12.2024	Nga totali Shpenzime përmbartimore	Sqarime
1	D.Z	190 dt. 28.12.2004	1,646,383	1,646,383	0	0		Dëmtim banese
2	M.J	587 dt. 06.07.2015	752,878	424,600	328,278	0	37,858	Shpërblim për largim nga puna dhe kthim në vendin e punës
3	A.Z	141 dt. 27.10.2020	1,406,021	803,011	603,010	0	156,895	Shpërblim page për largim nga puna
4	A.D	469 dt. 13.12.2021	1,000,994	575,497	425,497	0	56,846	Shpërblim page për largim nga puna
5	H	192 dt. 14.04.2022	42,381,538	12,600,000	9,319,234	20,462,304	1,648,414	pagesa për investime
6	XH.C	01 dt. 24.05.2022	720,384	460,192	260,192	0	77,184	Shpërblim page për largim nga puna
7	S.S	282 dt. 13.09.2021	951,600	762,400	189,200	0	0	Shpërblim page për largim nga puna
8	F.H	35 dt. 05.02.2020	1,026,462	513,231	513,231	0	63,552	Shpërblim page për largim nga puna
9	J.P	07 dt. 27.01.2022	599,092	299,546	299,546	0	37,092	Shpërblim page për largim nga puna
10	D.M	01 dt. 23.07.2020	469,100	234,550	234,550	0	38,100	Shpërblim page për largim nga puna
11	H.D	186 dt. 23.07.2020	286,214		286,214	0		pagesa për investime
12	R.I	23.05.2024	4,430,041			4,430,041		Shpërblim page për largim nga puna
13	A.GJ	24.06.2024	1,145,437			1,145,437		Shpërblim page për largim nga puna
	Totali		56,816,144	18,319,410	12,458,952	26,037,782	2,115,941	0

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropojë, punuar nga grupi i auditimit.

Pra konstatohet se efekti financiar për 1 vit i pagesës së gjyqe fituesve është 12,458,952 lekë, për vitin 2024 dhe shpenzime përmbartimore janë në vlerën e 2,115,941 lekë duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe shpenzime pa economicitet, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile, neni 510, germa “a” dhe 511, germa “a” shprehet në mënyrë eksplicite se: “Ekzekutimi i detyrueshëm mund të bëhet vetëm në bazë të një titulli ekzekutiv. Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm”...

“Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nëpërmjet lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, i cili:

a) për rastet e parashikuara nga shkronjat “a” dhe “b” të nenit 510 të këtij Kodi, lëshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin”.

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se: Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbartimore dhe detyrimet ndaj gjyq fituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë riskun e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyq fituesit dhe ato që janë për shpenzime përmbartimore.

Përveç Sektorit të Financës dhe Buxhetit, Sektori Juridik i bashkisë Tropojë pas evidentimit dhe monitorimit të proceseve gjyqësore, duhet të njoftojë në rrugë shkresore në kohë reale DBF për të shmangur shpenzimet përmbartimore të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Pra në total efekti financiar i zbatimit të vendimeve të gjykatës është 51,240,666 lekë, i detajuar:

-18,319,410 lekë, të paguara për vitin 2023,

- 12,458,952 lekë, të paguara për vitin 2024,

- 2,115,941, lekë shpenzime përmbartimore

- 26,037,782 lekë, të pa likuiduara ende, të cilat përbëjnë risk për shtimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit për kosto të shpenzimeve përmbartimore.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën prej 3,440,153 lekë është llogari e cila në fillim të vitit 2024 ka qenë në vlerën zero lekë dhe është krijuar gjatë vitit 2024 për detyrime të bashkisë ndaj OSHEE për faturat e energjisë elektrike të pa paguara për Muajt Mars, Gusht, Shtator 2024.

Nga auditimi i kësaj llogarie në ditarin e shpenzimeve rezulton që sipas të dhënave të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit në këtë llogari janë kontabilizuar detyrimet dhe likuidimet për vendime gjyqësore të punonjësve si dhe detyrime për energji elektrike

Për vitin 2024 llogaria 467 është kredituar në vlerën 9,901,876 lekë është debituar për vlerën 6,461,723 lekë dhe është me tepriçë kreditore në fund të vitit 2024 për vlerën 3,440,153 lekë.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga drejtoria e financës dhe buxhetit konstatohet që janë shtuar dy vendime gjyqësore si detyrime për vitin 2024 si më poshtë vijon:

Tabela 2/10: Vendimeve gjyqësore të shtuara gjatë vitit 2024

Nr.	Emër Mbiemër	Viti i krijimit të detyrimit	Shtuar vendime gjyqësore 2024	Likuiduar 2024	Gjendje me 31.12.2024
1	R.I	23.05.2024	4,430,041		4,430,041
2	A.GJ	24.06.2024	1,145,437		1,145,437
	TOTALI		5,575,478		5,575,478

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Nga auditimi i lëvizjes së llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vitin 2024 konstatohet që nuk janë kontabilizuar detyrimet për vendimet gjyqësore për vlerën prej 5,557,478 lekë që janë vlera 4,430,041 lekë për R.I, dhe vlera 1,145,437 lekë për A.GJ. Për sa më sipër llogaria 467 në fund të vitit 2024 është nënvlerësuar për vlerën prej 5,575,478 lekë si pasojë e mos pasqyrit të detyrimeve të vendimeve gjyqësore që kanë arritur pranë financës në vitin 2024. Referuar të dhënave në tabelën 2.7 më sipër rezultojnë të pa likuiduara vendime gjyqësore në fund të vitit 2024 vlera prej 26,037,782 lekë dhe nga analiza e lëvizjes së llogarisë 467 për vitin 2024 rezultojnë detyrime për vendime gjyqësore për dy punonjës në vlerën prej 5,575,478 lekë rrjedhimisht totali i vendimeve gjyqësore të pa likuiduara në fund të vitit 2024 është në vlerën 26,037,782 lekë. Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në fund të vitit 2024 është nënvlerësuar për vlerën prej 26,037,782 lekë.

Nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, në Bashkinë Tropojë, këto detyrime nuk kanë qenë të njohura në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos i njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë nga Vendimet e Gjykatave, por janë njohur në momentin e likuidimit.

Për sa më sipër, situata e paraqitur për detyrimet e prapambetura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të Institucionit, nuk paraqet gjendjen reale të tyre dhe të detajuar, duke mos regjistruar dhe njohur në kontabilitet detyrime të cilat kanë lindur nga periudhat e mëparshme në vlerën prej 26,037,782 lekë përbëjnë detyrime të prapambetura të pa regjistruara në kontabilitet në fund të periudhës ushtrimore 2024.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 pika 3.2. Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarisë së të tretëve (Klasa 4) nënpika ‘Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbehet nga “Detyrimet: Kreditohe llogaritë (401/404/ e 467 e të tjera), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 ‘Shpenzime korrente’”.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në lidhje me likuidimin e vendimeve gjyqësore dhe kosto e tyre në buxhetin e shtetit, dhe konkretisht për subjektin “H” në lidhje me vlerën 20,462,304 lekë të cilën Ju e pasqyroni në projekt raport ju sqarojmë se detyrimi në vlerën 5,554,391 lekë, detyrim i cili është kontabilizuar dhe i përket principalit të ngelur pa likuiduar nga dy faturat të cilat janë njohur me vendim gjyqësor, diferenca tjetër është kamatë vonesë dhe shpenzime përmbartimore që pretendohet nga Përmbartuesi, për të cilën ne e kemi kundërshtuar në Gjykatë që në muajin Korrik 2024 dhe akoma nuk ka përfunduar. Pasi të dalë vendimi gjyqësor do të bëjmë likuidimin total të detyrimit që do të rezultojë sipas vendimit të gjykatës, pasi i kemi planifikuar fondet.

Për sa përket vendimeve gjyqësore për ish. Punonjësit R.I, dhe A.GJ, këto dy vendime gjyqësore janë të vitit 2024, periudhë të cilën nuk kemi pasur detyrim të planifikojmë, pasi planifikimi është bërë që në dhjetor 2023 për buxhetin e vitit 2024. Këto dy vendime gjyqësore janë planifikuar për likuidim në buxhetin e vitit 2025 dhe diferenca e ngelur pa u likuiduar në fund të vitit 2025 do e pasqyrojmë si detyrim për vitin 2026.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni në lidhje me kontabilizimin e vendimeve të proceseve gjyqësore të cilat rezultojnë të pa kontabilizuara në vlerën prej 26,037,782 lekë që janë detyrime të bashkisë Tropojë ndaj të tretëve këto detyrime nuk kanë qenë të njohura në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, duke mos i njohur si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë nga Vendimet e Gjykatave. Detyrimet ndaj të tretëve njihen në momentin e konstatimit të detyrimit, kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë dhe është për ekzekutim nga Bashkia dhe jo në momentin e likuidimit. Mos pasqyrimi i detyrimeve ndaj të tretëve në fund të vitit 2024, konkretisht subjekti “H” ShPK në vlerën 20,462,304 lekë, R.I vlera 4,430,041 lekë dhe A.GJ vlera 1,145,437 lekë ka ndikuar në nënvlerësimin e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” për vlerën 26,037,782 lekë. Për sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

-Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” (fonde që priten të alokohen në vitin në vijim nga buxheti i shtetit), debituar në vlerën prej 73,182,629 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e klasës së 4 të pasivit (si furnitorët, pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, tatim në burim) të pasqyrës financiare të pozicionit financiar.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Llogari 4342 “Operacione me shtetin të drejta” në vlerën 73,182,629 lekë kuadron me llogarinë e detyrimeve dhe këtu janë të përfshira:

- | | | | |
|----|--|---|------------------------|
| 1. | Furnitor (401-408) | - | vlera 41,042,022 lekë; |
| 2. | Detyrime ndaj personelit për pagat e Dhjetorit 2024 (421), | - | vlera 19,863,134 lekë; |
| 3. | Detyrime ndaj shtetit për tatim taksat (431), | - | vlera 1,754,363 lekë; |
| 4. | Detyrime ndaj Sig.Shoq. për muajin Dhjetor (435), | - | vlera 6,053,949 lekë; |
| 5. | Detyrime për sigurime shëndetësore (436), | - | vlera 835,538 lekë |
| 6. | Llogaria 467, | - | vlera 3,440,153 lekë; |
| 7. | Llogaria 419, | - | vlera 193,470 lekë |

Vlera totale është: 73,182,629 lekë

Përsëri nga ana Juaj mbledhja e shumave në llogaritë e mësipërme, edhe pasi keni shtuar dy llogaritë 467 dhe 419 është bërë gabim, pasi vlera totale e këtyre llogarive është 73,182,629 lekë dhe jo 71,182,629 lekë. (shih faqen. 9 të akt-konstatimit dhe fq.35 të Projekt Raportit).

Përfundimisht rezulton se shuma totale e Llogarive 401-408, 421, 431, 435, 436, 467 dhe 419, përbëjnë shumën totale prej 73,182,629 lekë, aq sa është e pasqyruar edhe në bilanc dhe nuk ka asnjë gabim dhe kuadron me llogaritë e detyrimeve të mësipërme.

Ju lutemi që bëni edhe një herë mbledhjen e këtyre vlerave në llogaritë e mësipërme dhe pretendimi jonë duhet të merret tërësisht në konsideratë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni në lidhje me kuadrin e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” observacioni juaj qëndron dhe vlera e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin të drejta” është 73,182,629 lekë dhe do të reflektohet në material.

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në pasqyrat financiare të njësisë së qeverisjes së përgjithshme paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime/shërbime të kryera gjatë periudhës ushtrimore, të rimbursueshme nga shteti në bazë të kuadrit ligjor ose marrëveshjet e financimit për projekte të ndryshme.

Tabela 2./11: Llogaria 4342-Operacione me shtetin të drejta/lekë

Përshkrimi	Mbetja në fund të vitit 2024
Furnitorë dhe llogari të lidhura me to (401-408)	41,042,022
Detyrime ndaj personelit për pagat dhjetor (42)	19,863,134
Detyrime ndaj shteti për tatim page (431)	1,754,363
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore për dhjetor (435)	6,053,949
Detyrime për sigurime shëndetësore (436)	835,538
Kreditorë të ndryshëm (467)	3,440,153
Kreditorë parapagime(419)	193,470
Totali	73,182,629

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Llogaria 4342 “Operacione me shtetin të drejta” në vlerën 73,182,629 lekë kuadron me llogaritë e detyrimeve të furnitorëve dhe llogarive të lidhura me to dhe detyrimet e pagave dhe sigurimeve dhe tatimit mbi të ardhurat personale detyrime të dhjetorit që paguhet në janar të vitit 2025 dhe kreditorë të ndryshëm që është në vlerën 73,182,629 lekë.

Aktivet afatgjata janë në vlerën neto prej **3,383,712,091** lekë, nga të cilat :

Aktivet afatgjata jo materiale në vlerën neto prej **15.036,081** lekë ;

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projektme” në çelje të vitit 2024 gjendet në vlerën 15,188,978 lekë (Kosto historike – amortizim i akumuluar), ndërsa në fund të vitit 2023 rezulton në vlerën 15,036,081 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2023 + shtesa gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Sipas pasqyrës së anekseve statistikore formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), për aktivet jo materiale llogaria 202 paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2/12: Pasqyra e amortizimit për llogarinë 202 “Studime e projekte” / lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimi viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
15,983,675	794,697	15,188,978	0	152,898	0		15,983,675	947,595	15,036,081

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxheti Bashkia Tropojë

Për sa më sipër llogaria 202 “Studime e projekte” nuk ka pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 përveç amortizimit të llogaritur.

Aktivet afatgjata materiale në vlerën neto prej **3,313,236,219** lekë;

-Gjendja e llogarisë 210 “Toka, troje dhe terrene”, në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 22,460,270 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2024. Kontabilizimi i llogarisë nr.210 “Toka, troje, terrene”.

Gjendja e llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në fund të vitit 2024, paraqitet në vlerën 22,460,270 lekë, e pa ndryshuar nga vlera në fund të vitit 2023.

Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme sipas aneksit në vijim:

Tabela 2/13: Analiza e llogaria 210-Toka, troje e terrene

Nr.	Emërtimi i aktivitetit	Vlera
1	Truall i Shkolla e re 9-vjecare "A. Podrimja"	17,855,270
2	Varrezat e qytetit muri rrethues	4,605,000
	Total	22,460,270

Burimi: Raporti i mëparshëm i KLSH-së

Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se:**

Në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk janë kontabilizuar:

a) vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj., sipas inventarit të aktiveve afatgjata materiale, të pasqyruar në llogarinë nr.212 “Ndërtime e konstruksione”;

b) vlerat e trojeve të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të ish Komunës Fierzë, aktualisht NJA Fierzë Bashkia Tropojë, përkatësisht me VKM nr.565, datë 22.08.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Fierzë të Qarkut të Kukësit”;

c) vlerat e trojeve që janë pajisur me certifikatë pronësie, si më poshtë vijon:

Tabela 2/14: Trojet e pajisura me certifikatë

Pasuri me certifikatë pronësie				Vlera e truallit sipas VKM Nr. 89, datë 3.2.2016 ³	
Nr. Rend.	Emërtimi	Sip. në m ²	NJA	Lekë/m ²	Vlera e truallit
1	Truall	1169	Margegaj	160	187,040
2	Truall	1886	Margegaj	160	301,760
3	Truall	1125	Margegaj	160	180,000
4	Truall	935	Bajram Curri	1873	1,751,255
5	Truall	55	Bajram Curri	1873	103,015
6	Truall	464	Bajram Curri	1873	869,072
7	Truall	250	Bajram Curri	1873	468,250
8	Truall	5300	Fierzë	160	848,000
9	Truall	451	Fierzë	160	72,160
10	Truall	629	Fierzë	160	100,640
11	Terren Sportiv	8899	Bajram Curri	1873	16,667,827
12	Terren Sportiv	2828	Bajram Curri	1873	5,296,844
13	Truall	2169	Bajram Curri	1873	4,062,537
14	Truall	1365	Bajram Curri	1873	2,556,645
15	Truall	2000	Fierzë	160	320,000
16	Shesh	1230	Fierzë	160	196,800
17	Truall	93	Bajram Curri	1873	174,189
18	Truall	36	Bajram Curri	1873	67,428
19	Truall	58	Bajram Curri	1873	108,634
TOTAL					34,332,096

Burimi: Raporti i mëparshëm i KLSH-së

³ Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”, në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 10,017,959 lekë, e pandryshuar dhe në fund të vitit 2024.

Në këtë llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera për pyllëzime në zona të ndryshme, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela 2/15:Pyjet e pajisura me certifikatë

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Vlera
1	Pyllëzime me gështenja Dushaj	6,736,526
2	Pyllëzime me lajthia Breg Lumi	1,981,336
3	Përmirësime pyjore	128,870
4	Përmirësime pyjore	211,646
5	Fidanë Blini dhe Bredhi	256,480
6	Mbjellje pemësh në lulishte	703,100
	Total	10,017,958

Burimi: Raporti i mëparshëm i KLSH-së

Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se:

Në llogarinë nr. 211 “Pyje, kullota, plantacione”, nuk janë kontabilizuar:

a) vlerat e pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM të veçanta kanë kaluar në pronësi të ish Komunave, konkretisht:

VKM nr. 610, datë 14.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Llugaj të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 649, datë 21.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Bujan të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 521, datë 23.4.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Bytyç, të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 199, datë 21.2.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Fierzë të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 555, datë 7.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Lekbibaj të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, pika 43, shtojca me nr. 41, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Tropojë, me numër rendor nga 1 (një) deri 2792 (dy mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy).

Konkluzion: Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene”, nuk paraqet vlerën e saj të drejtë në fund të vitit 2024 pasi nuk janë kontabilizuar vlerat e trojeve të pajisura me certifikatë pronësie konstatuar edhe nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së për vlerën 34,332,096 lekë. Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” nuk paraqet vlerën e saj të drejtë në fund të vitit 2024 pasi nuk janë paraqitur vlerat e pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM të veçanta kanë kaluar në pronësi të ish Komunave të Bashkisë Tropojë:

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në lidhje me llogarinë 210, për kontabilizimin e vlerës së trojeve të pajisura me certifikatë pronësie, ashtu siç është bilanci i vitit 2023 është bërë edhe bilanci i vitit 2024, pasi gjatë kësaj periudhe pranë Sektorit të Financës nuk ka ardhur asnjë dokument, në mënyrë që ne të bëjmë kontabilizimin e pronave që janë me akt pronësie dhe kjo nuk është përgjegjësi e imja.

Bilanci i vitit aktual, si pikënisje merr bilancin e vitit të mëparshëm, konkretisht unë në vitin 2023 kam filluar punë pranë Bashkisë Tropojë dhe për hartimin e bilancit të vitit 2023 jam mbështetur në bilancin e vitit 2022 dhe për hartimin e bilancit të vitit 2024 jam mbështetur në

bilancin e vitit 2023. Për vitet 2023 dhe 2024 pranë Drejtorisë Ekonomike nuk ka ardhur asnjë certifikatë pronësie për tokë, troje apo terrene, në mënyrë që ne të bëjmë kontabilizimin e tyre. Në momentin që do na vihet në dispozicion dokumentacioni përkatës do bëjmë menjëherë kontabilizimin e tyre, kjo pasi të verifikojmë nëse janë të kontabilizuara apo jo.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni konkluzioni është i njëjtë me gjetjet e mëparshme të Klsh-së dhe nga ana juaj nuk është marrë asnjë mase për regjistrimin e aseteve. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30; Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Llogaritë nr. 210 “Toka, troje, terrene” dhe nr. 211 “Pyje Plantacione”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

-Gjendja e llogarisë nr.212 “Ndërtim e konstruksione” në çelje të vitit 2024 ka qenë në shumën 1,079,846,799 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 1,052,827,748 lekë.

Tabela 2/16: Llogaria nr.212 “Ndërtim e konstruksione” shtesa pakësim formati 7/b /lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Kosto historike 2024	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
1,468,075,497	388,228,698	1,079,846,799	26,943,245	53,962,296	1,495,018,742	442,190,994	1,052,827,748

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Kosto historike e Llogarisë 212 “Ndërtim e konstruksione” është në vlerën 1,468,075,497 lekë. Amortizimi i akumuluar deri në fund të vitit 2023 është në vlerën prej 388,228,698 lekë. Amortizimi i vitit 2024 është në vlerën 53,962,296 lekë. Gjendja e llogarisë 212 pas përlllogaritjes së amortizimit është 1,025,884,503 lekë (1,468,075,497 lekë- 388,228,698 lekë - 53,962,296 lekë). Shtesat e llogarisë 212 për vitin 2024 janë në vlerën prej 26,943,245 lekë. Gjendja në fund të vitit 2024 për llogarinë 212, sipas raportimit në pasqyrën e pozicionit financiar është 1,052,827,748 lekë (1,025,884,503 lekë +26,943,245 lekë).

Llogaria 231 “Investime në proces” (ndërtesa konstruksione + rruge rrjete dhe vepra ujore + instalime teknike) paraqitet në fillim te vitit 2024 në vlerën debitorë prej 389,892,520 lekë. Për vitin 2024 është debituar për vlerën prej 185,035,548 lekë dhe është kredituar për vlerën prej 524,448,277 lekë dhe rezulton me teprice debitorë në fund të vitit 2024 për vlerën prej 50,479,791 lekë.

Nga krahasimi i të dhënave të thesarit sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit rezulton që llogaria 231 sipas të dhënave të thesarit për vitin 2024 është në vlerën 185,035,548 lekë që rezulton e përputhur me vlerën debitorë të llogarisë 231 sipas kontabilitetit për vitin 2024.

Nga auditimi i pakësimit të llogarisë 231 “Investime në proces” rezulton që për vitin 2024 llogaria 231 “Investime në proces” është pakësuar në vlerën 524,448,277 lekë. Shtesat e llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” janë në vlerën 26,943,245 lekë, shtesat e llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” në vlerën 502,135,740 lekë dhe shtesa e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri dhe pajisje” për vitin 2024 janë në vlerën 3,763,416 lekë. Shtesat e llogarisë 214 Instalime teknike, makineri dhe pajisje për vitin 2024 janë në vlerën 3,763,416 lekë që përben instalimin e semaforit në qytetin e Bajram Currit. Shtesat e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” të kaluara nëpërmjet llogarisë 231 janë në vlerën 180,000 lekë. Shtesa

në total e llogarive (212+213+214+218) është në vlerën 533,022,401 lekë. Pakësimi i llogarisë 231 për vitin 2024 është 524,448,227 lekë.

Për sa më sipër ka mospërputhje te pakësimit të llogarisë 231 “Investime në proces” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) për vlerën 8,574,174 lekë..(533,022,401 lekë-524,448,227 lekë).

Konkluzion. Nga auditimi i pakësimit të llogarisë 231 “Investime në proces” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) blerje me pagesë sipas Formatit nr.7/a të pasqyrave financiare ka mospërputhje te pakësimit të llogarisë 231 “Investime në proces” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) për vlerën 8,574,174 lekë. Shtesa në total e llogarive (212+213+214+218) është në vlerën 533,022,401 lekë. Pakësimi i llogarisë 231 për vitin 2024 është 524,448,227 lekë.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Konkluzioni për Llogarinë 212 (fq. 38 – 40 e PRA-së).

I qëndrojmë pretendimit tonë pasi kemi përputhje mes pakësimit të llogarisë 231 “punime në proces” me shtesat e llogarive 212, 213, 214 dhe 218 dhe konkretisht:

- *Llogaria 231 është mbyllur për vlerën 524,448,412 lekë dhe është bërë shtesa në llogaritë përkatëse si më poshtë:*

- *Llogaria 212 është shtuar për vlerën 18,253,096 lekë;*
- *Llogaria 213 është në vlerën 502,135,740 lekë;*
- *Llogaria 214 është në vlerën 3,763,416 lekë;*
- *Llogaria 218 është në vlerën 180,000 lekë;*

Shuma e këtyre llogarive të pasqyruara më sipër është 524,332,252 lekë. Diferenca prej 116,160 lekë nga mbyllja e llogarisë 231 dhe shtesat në llogaritë përkatëse (212, 213, 214 dhe 218) është TVSH-ja e paguar me fonde nga Thesari (pjesa e TVSH për blerje pajisjesh e cila është kontabilizuar që në vitin 2023 me bërjen hyrje të pajisjeve të blera me fonde nga Banka e Nivelit te dytë, por që pjesa e TVSH-së është likuiduar në vitin 2024).

Me fondet e BE-së Llogaria 212 është shtuar për vlerën 8,690,149 lekë, këto fonde kanë kaluar nëpërmes Bankës së Nivelit të dytë.

Dua të theksoj se shtesa e aktiveve të qëndrueshme është e barabartë:

- | | | | |
|----|--|---|-----------------------|
| 1. | Me mbylljen e Llogarisë 231, në vlerën | - | 524,332,252 lekë; |
| 2. | Fondet e kaluara nga Raifeissen Bank në vlerën | - | 8,690,149 lekë |
| 3. | Dhurime në vlerën | - | <u>5,075,347 lekë</u> |

Totali i shtesave: - 538,097,748 lekë

Nr.	Shtesa e aktiveve	212	213	214	215	218	Totali
1	Me mbyllje 231	18,253,096	502,135,740	3,763,416	-	180,000	524,332,252
2	Me fonde nga Banka	8,690,149	-	-	-	-	8,690,149
3	Nga dhurimet	-	-	-	3,452,000	1,623,347	5,075,347
	Totali:	26,943,245	502,135,740	3,763,416	3,452,000	1,803,347	538,097,748

Shuma prej 538,097,748 lekë është e barabartë me shtesat e aktiveve në tabelën 7/a të Pasqyrave Financiare.

Shtesa prej 8,690,149 lekë që pasqyrohet tek llogaria 212 është xhiruar nëpërmes bankës dhe nuk janë veprime që kryhen nëpërmes thesarit, por kryhen nga numër llogarie që hap Ministria e Financave sipas emërtimit të projektit, pasi janë me fonde te BE-së. Vetëm TVSH-ja paguhet nëpërmes thesarit. Dua të theksoj se shtesat në pasqyrat 7/a dhe 7/b rakordojnë me shtesat në

llogaritë përkatëse 212, 213, 214, 215 dhe 218 sipas mbylljes llogarisë 231, likuidime me fonde nga banka të nivelit të dytë – kjo sipas projekteve dhe nga dhurimet në natyrë.

Llogaria 231 e mbyllur me degën e Thesarit në vlerën 524,448,412 lekë është mbyllur me llogaritë 212, 213, 214 dhe llogarinë 218 dhe gjithsej shuma e këtyre llogarive kap vlerën 524,332,252 lekë. Diferenca është 116,160 lekë, e cila është pjesa e TVSH-së për blerje pajisjeve që janë realizuar në vitin 2023, por që TVSH-ja është likuiduar në vitin 2024. Kjo diferenca nuk është pasqyruar tek llogaria 218, me qenë se pajisjet e blera në vitin 2023 janë bërë hyrje me çmimin e plotë me TVSH dhe shtesa e tyre është bërë sipas çmimit të bërë hyrje. Ndërsa shtesa që është e pasqyruar në tabelë në vlerën 180,000 lekë është blerje pajisjesh.

Me fondet nga Bankat e nivelit të dytë është bërë shtesa në llogarinë 212 për vlerën 8,690,149 lekë ku këto fonde nuk kanë të bëjnë me fonde të llogarisë 231 që kemi rakorduar me thesarin. Prandaj do t'ju lutesha që ta rishikoni edhe një herë tabelën pasi është shumë e qartë çdo shtesë që është bërë në tabelat 7/a dhe 7/b se nga kanë ardhur këto shtesa. Bilanci I ka edhe tabelat e kontrollit ku në rast se ka gabime apo mospërputhje dalin automatikisht diferencat dhe mos kuadrimet, ku tek ne nuk ka ndodhur një gjë e tillë, pasi çdo gjë është e kuadruar

Qëndrimi i grupit të auditimit: Shtesat e llogarive 212,213,214 dhe 218 janë përkatësisht llogaria 212 në vlerën 26,943,245 lekë, llogaria 213 në vlerën 502,135,740 lekë, llogaria 214 në vlerën 3,763,416 lekë dhe llogaria dhe llogaria 218 në vlerën 180,000 lekë. Kjo saktësohet në Formatin 7/a të pasqyrave financiare në të cilën blerjet me pagesë për vitin 2024 janë në vlerën prej 533,022,401 lekë (26,943,245 lekë+ 502,135,740 lekë +3,763,416 lekë +180,000 lekë). Pakësimi i llogarisë 231 në funksion të kapitalizimit 212,213,214 dhe 218 është 524,448,227 lekë. Konkluzioni i arritur nga grupi i auditimit që ka mospërputhje të shtesave të aktiveve nga blerjet me pagesë me pakësimin e llogarisë 231 ‘*Investime në proces*’ për vlerën prej 8,574,174 lekë qëndron. Krahasimi është kryer për shtesën e aktiveve nga blerjet me pagesë sipas formatit 7/a të pasqyrave financiare për llogaritë 212,213,214 dhe 218 dhe pakësimin e llogarisë 231 ‘*Investime në proces*’. Për sa më sipër shtesat e kryera për blerje me pagesë duhet të korrespondojnë me pakësimin e llogarisë 231 pasi janë të kaluara nëpërmjet llogarisë 231 ‘*Investime në proces*’. Pretendimi juaj në lidhje me veprimet e kryera nëpërmjet bankës së nivelit të dytë nga fondet e BE nuk qëndron pasi shtesat e aktiveve do të pasqyroheshin si blerje jashtë sistemit në formatin 7/a të pasqyrave financiare që nuk kryhen nëpërmjet llogarisë 231 të thesarit. Nga tërësia e të dhënave të trajtuara diferenca prej 8,574,174 lekë ekziston midis llogarisë 231 dhe kapitalizimit. (Shtesat e llogarive 212,213,214 dhe 218). Observacioni nuk merret parasysh dhe qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 pika 3.2.Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarisë së të tretëve (Klasa 4) nën-pika “Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbehet nga:

Detyrimet: Kreditohen llogaritë (401/404/ e 467 e të tjera), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 ‘Shpenzime korrente’ dhe 23 Investime (në rastin e konstatime) si dhe pika Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” për kapitalizimin e aktivitetit (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje Debitohet llogaria 21 “Aktive afatgjata materiale” kreditohet llogaria 231 “Investime për aktivitet afatgjata materiale”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

Shtesat e llogarisë 212 për vlerën 26,943,245 lekë janë kryer për objekte të marra në dorëzim me Proces Verbal, Akt Marrje në dorëzim të përkohshëm (Certifikatë për marrjen dorëzim të përkohshëm). Sipas të dhënave të vë na në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit

për vlerat e situacioneve përfundimtare në Aktet e marrjes në dorëzim të përkohshëm (Proces verbale të marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve) rezultojnë vlera të situacioneve përfundimtare të objekteve të detajuara sipas objekteve nga të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit janë si më poshtë vijon:

Tabela 2/17: Të dhënat për shtesat e llogarisë 212 për vitin 2024/lekë

Emërtimi i objektit	Data e certifikatës së përkohshme	Situacioni përfundimtar lekë me TVSh	Vlera e kaluar AQT sipas financës gjatë vitit 2024
“Rikonstruksion i shkollës së mesme Oso Dauti”	05.12.2023	45,274,714	635,637
“Rikonstruksion i thetores Shudenicë + Ndërtimi i Tregut të bagëtimeve”	04.12.2023	14,846,888	15,047,543
“Sistemimi i tregut industrial Lagjia Dardania B. Curri”	17.04.2023	2,392,849	19,336
“Rrethimi dekorativ i stadiumit të lojërave me dorë”	18.10.2023	3,985,395	816,213
“Rikonstruksion punime ndërtimore në sallën nr.1 e rinisë tek muzeu ”	29.09.2023	1,481,098	1,499,417
“Meremetim muzeu Historik Bajram Curri”	30.12.2024	8,925,099	7,437,582
“Meremetim muzeu Historik Bajram Curri”	30.12.2024		1,487,517
TOTALI		76,906,043	26,943,245

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropoje

Për tre objekte për të cilat vlera e kaluar në AQT gjatë vitit 2024 është me e vogël se situacioni përfundimtar i punimeve situata paraqitet si më poshtë vijon:

Tabela 2/18: Vlerat e situacioneve përfundimtare dhe vlera e shtuar në AQT e 212 për vitin 2023 dhe 2024/lekë

Nr.	Emërtimi i objektit	Data e certifikatës së përkohshme	Situacioni përfundimtar lekë me TVSh	Vlera e kaluar AQT sipas financës viti 2024	Vlera e kaluar në AQT gjatë vitit 2023	Totali i kalimit në AQT
1	“Rikonstruksion i shkollës së mesme Oso Dauti”	05.12.2023	45,274,713	635,637	45,274,713	45,928,350
2	“Sistemimi i tregut industrial Lagjia Dardania B. Curri”	17.04.2023	2,392,849	19,336	2,392,849	2,412,185
3	“Rrethimi dekorativ i stadiumit të lojërave me dorë”	18.10.2023	3,985,394	816,213	3,274,658	4,090,871
	TOTALI		51,652,956	1,471,186	50,942,220	52,413,406

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropoje përpunoi grupi i auditimit

Për tre objektet e cituara në tabelën 2/18, janë kaluar në total në AQT (2024) në llogarinë 212 vlera prej 52,413,406 lekë nga të cilat për vitin 2023 vlera ka qenë 50,942,220 lekë dhe gjatë vitit 2024 ka një shtesë prej 1,471,186 lekë. Vlera e kaluar në AQT është më e madhe se situacionet përfundimtare pasi në të përfshihen edhe vlerat e super vizionit dhe kolaudimit.

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2024, ka qenë në shumën 1,674,708,410 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 2,160,127,437 lekë [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Tabela 2/19: Shtesat dhe pakësimet e llogarisë 213 për vitin 2024 sipas formatit 7/b /lekë

Kosto historike	Amortizimi i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizimi 2024	Kosto historike 2024	Amortizimi i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
1,937,632,870	262,924,460	1,674,708,410	502,135,740	16,716,713	2,439,768,610	279,641,173	2,160,127,437

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropoje përpunoi grupi i auditimit

Kosto historike e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” sipas formatit nr.7/b është në vlerën 1,937,632,870 lekë. Amortizimi i akumuluar deri në fund të vitit 2023 është në vlerën prej 262,924,460 lekë. Amortizimi i vitit 2024 është në vlerën 16,716,713 lekë. Gjendja e llogarisë 213 pas përlllogaritjes së amortizimit është 1,657,991,697 lekë (1,937,632,870 lekë - 262,924,460 lekë - 16,716,713 lekë) Shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024 janë në vlerën prej 502,135,740 lekë. Gjendja në fund të vitit 2024 për llogarinë 213 sipas raportimit në pasqyrën e pozicionit financiar është 2,160,127,437 lekë (1,657,991,697 lekë + 502,135,740 lekë.

Shtesat e llogarisë 213 për vlerën 502,135,740 lekë janë kryer për objekte të marra në dorëzim me Proces Verbal, Akt Marrje në dorëzim të përkohshëm (Certifikatë për marrjen dorëzim të

përkohshëm). Sipas të dhënave nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vlerat e situacioneve përfundimtare në Aktet e marrjes në dorëzim të përkohshëm (Proces verbale të marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve) rezultojnë vlera të situacioneve përfundimtare të objekteve sipas Drejtorisë së Financës dhe buxhetit si më poshtë vijon:

Tabela 2/20 :Shtesa e llogarisë 213 Rrugë, rrjete dhe vepra ujore viti 2024

Nr.	Emërtimi i objektit	Data e certifikatës së përkohshme	Situacioni përfundimtar lekë me TVSh sipas financës	Vlera e kaluar AQT sipas financës	Llogaria
1	Objekti Sistemim - asfaltim i rrugës ‘Bukovë- Nigegaj-Qender Luzhë’	12.08.2024	27,919,402	12,463,046	213
2	“Projekti i rrugës se fshatit Kasaj” Bashkia Tropojë	30.09.2024	69,023,526	29,152,293	213
3	“Sistemim asfaltim i lagjes Dardania”	15.04.2024	32,423,422	17,064,346	213
4	“Ndërtim dhe rikonstruksion urash, Bashkia Tropojë”	09.10.2024	18,442,617	18,966,179	213
5	“Rikonstruksion i rrugës Bylbyl Breçani”	05.04.2024	50,907,336	24,912,133	213
6	“Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë viti 2023”	31.08.2024	2,280,336	61,819	213
7	“Asfaltim i rrugëve, mbushje gropash viti 2023, për rrugët e bashkisë Tropojë”	25.08.2023	6,696,918	6,829,217	213
8	“Rikualifikim urban lagjia Partizani blloku 1&2 Bajram curri”	21.12.2022	64,460,799	30,754,827	213
9	Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan. Cernicë, Tropojë”	06.03.2023	408,503,653	283,147,515	213
10	“Rikonstruksion i rrugës Blini i Grisë-Lekurtaj”	28.03.2023	12,092,652	6,328,329	213
				136	213
11	“Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë viti 2024”	04.11.2024	2,747,947	2,804,796	213
12	“Ujësjetllësi i fshatit Dragobi”	17.07.2023	64,773,307	69,651,104	213
	TOTALI		760,271,915	502,135,740	213

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropoje /përpunoi grupi i auditimit

Për sa më sipër vlerat e kaluara në llogarinë 213 për kapitalizimin e tyre nuk përputhen me vlerat e situacioneve përfundimtare sipas certifikatave të përkohshme për vlerën 258,136,175 lekë (760,271,915-502,135,740).

Nga të dhënat analitike të shtesave të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore”, viti 2024 rezulton që vlera e situacioneve përfundimtarë sipas certifikatave të marrjes në dorëzim të përkohshëm për ndërtesat, është 760,271,915 lekë vlerë e cila duhet të përkojë me shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024. Shtesa e llogarisë 213 për vitin 2024 është sipas formatit n.7/b është 502,135,740 lekë, vlerë e e cila nuk përputhet me vlerën e situacioneve përfundimtare sipas certifikatave të marrjes në dorëzim e cila është në vlerën 760,271,915 lekë. Për sa më sipër rezulton që nuk janë kontabilizuar saktë veprimet për shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024.

Pakësimi i llogarisë 231(në të cilën përfshihen dhe vlerat e supervizionit dhe mbikëqyrjes) dhe shtesa në llogarinë 213 Rrugë, rrjete dhe vepra ujore viti 2024 nuk plotësojnë kushtet kontabël sipas vlerave kontabël 8 objekte të regjistruara për kapitalizimin e investimeve objektet për vlerën kontabël prej 263,726,682 lekë (667,611,126-403,884,444) si më poshtë vijon:

Tabela 2/21: Vlerat e situacioneve përfundimtare dhe vlera e shtuar në AQT llogaria 213 për vitin 2024/lekë

Nr.	Emërtimi i objektit	Data e certifikatës së përkohshme	Situacioni përfundimtar lekë me TVSh	Vlera e kaluar AQT sipas financës viti 2024	Llogaria
1	Objekti Sistemim - asfaltim i rrugës ‘Bukove- Nigegaj-Qender Luzhë’	12.08.2024	27,919,402	12,463,046	213
2	“Projekti i rrugës se fshatit Kasaj” Bashkia Tropojë	30.09.2024	69,023,526	29,152,293	213

3	“Sistemim asfaltim i lagjes Dardania”	15.04.2024	32,423,422	17,064,346	213
4	“Rikonstruksion i rrugës Bylbyl Breçani”	05.04.2024	50,907,336	24,912,133	213
5	“Rikonstruksion i kanaleve vaditëse bashkia Tropojë viti 2023”	31.08.2024	2,280,336	61,819	213
6	“Rikualifikim urban lagja Partizani blloku 1&2 Bajram curri”	21.12.2022	64,460,799	30,754,827	213
7	Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore fshati Gri, Bujan, Cernicë, Tropojë”	06.03.2023	408,503,653	283,147,515	213
8	“Rikonstruksion i rrugës Blini i Grisë-Lekurtaj”	28.03.2023	12,092,652	6,328,329	213
				136	213
	TOTALI		667,611,126	403,884,444	213

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit bashkia Tropojë / përpunoi grupi i auditimit

Nga auditimi konstatohet që nuk janë kontabilizuar saktë veprimet për shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024 që ka mospërputhje me gjendjen e llogarisë 231 dhe transferimin e sajë në llogarinë 213 nga mos pasqyrimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve të bashkisë Tropojë ndër vite llogaria (401/404/ e 467 e të tjera) dhe llogaria 4864 shpenzime të periudhave të ardhshme për vlerën 263,726,682 lekë.

Konkluzion: Në bazë të të dhënave vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit për pakësimin e llogarisë 231(në të cilën përfshihen dhe vlerat e super vizionit dhe mbikëqyrjes) dhe shtesën e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” nuk plotësojnë kushtet kontabël sipas vlerave kontabël të regjistruara për kapitalizimin e investimeve për 8 objektet e marra në dorëzim për vlerën 263,726,682 lekë (667,611,126-403,884,444).

Nga auditimi konstatohet që nuk janë kontabilizuar saktë veprimet për shtesat e llogarisë 213 (viti 2024) nga mos pasqyrimi i saktë i detyrimeve ndaj të tretëve të bashkisë Tropojë ndër vite për llogarinë (401/404/ e 467 e të tjera) dhe llogarinë 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme “në vlerën 263,726,682 lekë.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

I qëndrojmë argumentimit tonë ku kontratat janë shumëvjeçare dhe mbyllja e llogarisë 231 për pjesën e rrugëve dhe veprave ujore i shtohet AJQ-ve në vlerën e pagesës aq sa është planifikuar në urdhër kërkesë-blerje, që regjistrohet kontrata në Degën e Thesarit. N.q.s. kjo vlerë që është planifikuar për tu likuiduar nuk realizohet për vitin përkatës atëherë regjistrohet si detyrim I prapambetur në fund të vitit.

Diferenca shtohet pasi të kryhet pagesa sipas planifikimit. Ne kemi pasqyruar pagesën e bërë të cilën e kemi pasur të planifikuar. Me kryerjen e pagesës përfundimtare bëjmë pasqyrimin edhe të vlerave të tjera në bilancin e radhës.

Në lidhje me këtë konkluzion sqarojmë se është e njëjta situatë ashtu siç janë bërë edhe regjistrimet në llogarinë 212 ku kemi pranuar pretendimet tona.

Me qenë se kontratat janë me afat, ku janë përcaktuar periudhat e kryerjes së pagesave, pavarësisht pse investimi ka një afat të përfundimit të punimeve, detyrimi paguhet sipas planifikimit që kemi bërë në buxhet dhe nuk kemi pse ta regjistrojmë si detyrim të prapambetur, pasi jemi brenda afateve të pagesës dhe nuk mund të quhet detyrim i mbartur.

Ashtu siç edhe ju kemi sqaruar edhe prezent, po ju sqarojmë përsëri dhe konkretisht: Që në fillim pasi nxirret Urdhër-Prokurimi, vijojmë me Urdhër-Kërkesë-Blerja, ku shuma e investimit është e ndarë në vite, ku bëhet edhe regjistrimi në thesar. Pastaj me daljen e fituesit, regjistrohet në Thesar Urdhër-Blerja, ku përsëri shuma e operatorit fitues është e ndarë në vite.

Ju kemi dërguar Urdhër-Kërkesë Blerje nr. 4, dt. 24. 02. 2023 dhe Urdhër – Blerje nr.6, dt. 10. 05. 2023. Të gjitha këto jua kemi sqaruar edhe prezent.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Subjekti gjatë periudhës së auditimit si dhe në observacionin e tij nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë që të saktësojë mospërputhjen midis vlerave të situacioneve përfundimtare të punimeve për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” dhe pakësimin e llogarisë 231 për vitin 2024 .Mospërputhja është në vlerën prej 263,726,682 lekë. Situacioni përfundimtar i punimeve dhe akti i marrjes në dorëzim të objektit provon që objekti është mbaruar dhe faturat kanë arritur pranë financës për kontabilizim të debitorëve. Për sa citohet në observacion subjekti vetë e pranon që likuidimet bëhen sipas planifikimeve

të kontratave shumëvjeçare dhe ka pasqyruar në shtesën e AQT pjesën e likuiduar nga 231. Duke qenë që objekti ka përfunduar duhet të kontabilizohet vlera e detyrimit sipas faturave që përbejnë situacionin përfundimtar pavarësisht se kur kryhet likuidimi i tyre sipas planifikimit në vite. Nga ana juaj në lidhje kalimin në AQT për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” nuk është sjellë informacion dhe te dhëna në lidhje me kalimin në këtë llogari shtesa të AQT para vitit 2024. Urdhër-Kërkesë Blerje nr. 4, dt. 24. 02. 2023 dhe Urdhër – Blerje nr.6, dt. 10. 05. 2023 për objektin “Sistemim asfaltim rruga Nigegaj- Qender Luzhë” provon faktin që nuk është kaluar në AQT gjatë vitit 2024 vlera e situacionit përfundimtar të punimeve por vetëm vlera e planifikuar për likuidim për vitin 2024. Konkretisht planifikuar për likuidim për vitin 2024 është vlera prej 12,835,052 lekë dhe vlera e kaluar në AQT sipas tabelës se mësipërme me nr.2/20 është në vlerën 12,463,046 lekë. Urdhër – Blerje nr.6, dt. 10. 05. 2023 në lidhje me objektin “Sistemim asfaltim rruga Nigegaj- Qender Luzhë” ka në planifikim për likuidim për vitin 2025 vlerën prej 14,673,503 lekë. Objekti “Sistemim asfaltim rruga Nigegaj- Qender Luzhë” ka përfunduar me datë 12.08.2024 sipas datës së certifikatës së marrjes në dorëzim të përkohshëm të objektit. Përfundimi i objektit do të thotë që pranë drejtorisë së financës dhe buxhetit kanë arritur faturat për likuidim rrjedhimisht vlera e planifikuar për likuidim për vitin 2025 për vlerën prej 14,673,503 lekë duhet te regjistrohet si detyrim i prapambetur në fund të vitit 2024. Nga të dhënat e llogarisë 401-408 “Furnitorë” në fund të vitit 2024 vlera prej 14,673,503 lekë nuk është e regjistruar si detyrim i prapambetur.

Për sa citoni në lidhje me llogarinë 212 pretendimet për këtë llogari janë pranuar nga grupi i auditimit pasi kalimet në aktive sipas të dhënave tuaja për këtë llogari janë kryer gjatë vitit 2023 dhe ne kemi audituar vitin 2024.

Nga ana juaj nuk janë vënë në dispozicion të dhëna të reja dhe dokumentacion që provon mospërputhjen për vlerën kontabël prej 263,726,682 lekë midis pakësimit të llogarisë 231 “Investime në proces” me shtesat e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” për vitin 2024.

Përfundimisht observacioni i subjektit në lidhje me mos rakordimin e shtesave të llogarisë 213 dhe pakësimin e llogarisë 231 nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 15 paragrafi 42, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese kreu Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. E.D, ish nëpunës zbatues

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri e pajisje” në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 13,873,236 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 16,367,413[(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)]. Rezulton që kjo llogari është shtuar gjatë vitit në vlerën neto prej 2,494,177 lekë.

Tabela 2/22: Pasqyra e amortizimit për llogarinë 214“Instalime teknike, makineri e pajisje” / lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimi viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
26,086,742	12,213,506	13,873,236	3,763,416	1,269,239	0		29,850,158	13,482,745	16,367,413

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Nga auditimi i pasqyrës F(7) gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) për vitin 2024 është shtuar vlera prej 3,763,416 lekë që përbën kontabilizimin e objektit të semaforit të vendosur në qytetin e Bajram Currit.

Llogaria 215 ‘‘Mjete Transporti’’ në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 16,851,150 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 17,623,399 [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)]. Rezulton që kjo llogari është shtuar gjatë vitit në vlerën neto prej 772,249 lekë (17,623,399-16,851,150). Nga auditimi i pasqyrës F(7) gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) për vitin 2024 është shtuar vlera prej 3,452,000 lekë blerje jashtë sistemit që përbën kontabilizimin e dhurimit të një zjarrfikëseje për Bashkinë Tropojë.

Tabela 2/23:Shtesat dhe pikësimet e llogarisë 215 për vitin 2024 sipas formatit 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Shtesat gjatë vitit 2024	Amortizim 2024	Pakësimi viti 2024	Amortizim	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
67,084,391	50,233,241	16,851,150	3,452,000	2,679,751	0		70,536,391	52,912,992	17,623,399

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Referuar raportit të mëparshëm të KLSH-së ‘‘Për vitin 2023, për llogarinë nr. 215, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit vlera prej 3,452,393 lekë.

Llogaria 215 ‘‘Mjete transporti’’, në pasqyrën F7 për vitin 2023 ka vlerën 67,084,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 63,631,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak. Për sa më sipër konstatohet se gjatë vitit 2024 nuk është kontabilizuar vlera prej 3,452,393 lekë sipas konstatimit të KLSH-së për diferencat në shtesat e llogarisë 215 sipas tabelës se mësipërme. Kjo vlerë si diferencë konstatohet edhe në procesin e inventarizimit të vitit 2024 të kryer nga Bashkia Tropojë.

Llogaria 218 ‘‘Inventar ekonomik’’ në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën prej 27,499,018 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 17,623,399 [(Teprica neto në fillim të vitit 2024 + shtesat gjatë vitit – shtesat gjatë vitit) – (amortizimin e akumuluar deri në fund të vitit 2023 + amortizimin e vitit 2024)].

Nga auditimi i pasqyrës F(7/a) gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) për vitin 2024 është shtuar vlera prej 1,803,347 lekë (blerje me pagese 180,000 lekë dhe blerje jashtë sistemit 1,623,347 lekë. Kjo llogari është pakësuar 5,071,929 lekë nga të cilat nxjerrje jashtë përdorimit 4,941,909 lekë dhe pakësime te tjera 130,020 lekë.

Konkluzion: Gjatë auditimit u konstatua se janë kryer procedurat e inventarizimit për vitin 2024, por për vlerën 4,941,909 lekë të llogarisë 218 ‘‘Inventar ekonomik’’ që lidhet me procedurën e vlerësimit dhe asgjësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të mallrave, mungonte dokumentacioni mbështetës dhe nuk është njoftuar Këshilli Bashkiak në kundërshtim me Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, ‘‘Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik’’ i ndryshuar, kreu IV përcakton rregullat për ‘‘Sistemin e kontrollit periodik të aktiveve’’, Inventarizimi i aktiveve pika 73. ‘‘Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar, si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike’’. Pika 74. ‘‘Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës’’. Pika 120 ‘‘Për efektet ekonomike dhe financiare të nxjerrjeve nga përdorimi, njësitë e qeverisjes vendore duhet të informojnë këshillat e njësisë vendore’’.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Për sa konkludohet nga ana Juaj ju sqarojmë se nga jonë janë kryer të gjitha procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre si dhe disponojmë dokumentacionin përkatës, të cilin jua kemi vënë në dispozicion si dhe ju kemi sqaruar edhe prezent.

Konkretisht kemi Urdhër për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit, Urdhër për ngritjen e Komisionit të Asgjësimit dhe proces-verbal vlerësimi dhe proces-verbal asgjësimi, të cilat jua kemi bashkëngjitur.

Disponojmë të gjitha fletë-hyrjet dhe fletë-daljet për mallrat që janë bërë dalje për asgjësim dhe proces-verbalin e asgjësimit.

Ndërsa në lidhje me pakësimet e tjera që janë në shumën 130,020 lekë janë dalje e materialeve të ndryshme ndihmash për personat në nevojë.

Gjithashtu disponojmë fletë-daljet për materialet që ju janë dhënë familjeve në nevojë, që justifikojnë shumën 130,020 lekë (krevate hekuri).

Në lidhje me mos njoftimin e Këshillit Bashkiak, do e kemi parasysh në të ardhmen, pasi deri më tani unë kam ndjekur praktikën e mëparshme ku në vitet e mëparshme Këshilli është njoftuar vetëm për makineritë dhe jo edhe për inventarin ekonomik.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni më sipër dhe nga të dhënat e vena në dispozicion dokumente shkresore të procedurës së vlerësimit dhe asgjësimit në kundërshtimin e bere në lidhje me akt konstatimin dhe projekt raportin e auditimit nuk është kryer procedurë vlerësimi dhe asgjësimi si dhe procedure shitje te mbetjeve të pajisjeve elektronike (printer fotokopje, kompjuterë) dhe të materialeve të hekurit (kasaforta, krevate hekuri etj.) kjo do të thotë që procedura e vlerësimit dhe asgjësimit nuk ka përfunduar. Në dokumentacionin e venë në dispozicion gjatë auditimit si dhe në kundërshtimin tuaj të Raportit Përfundimtar të Auditimit nuk është venë në dispozicion asnjë dokument qe provon që është njoftuar Këshilli Bashkiak në lidhje me procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit.

Observacioni i subjektit nuk merret në konsideratë dhe grupi i auditimit do mbajë të njëjtin qëndrim në raportin përfundimtar të auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. Z.I, Kryetare e Bashkisë Tropojë/nëpunës autorizues

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Llogaria 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara” janë në vlerën 11,711,382 lekë e pa ndryshuar nga viti i kaluar.

Tabela 2/24:Gjendja e llogarisë 24 për vitin 2024 sipas formatit 7/b lekë

Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fillim 2024	Kosto historike	Amortizim i akumuluar	Teprica neto fund vitit 2024
25,023,057	13,251,655	11,771,382	25,023,057	13,251,655	11,771,382

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Në Formatin 7/b gjendja në fillim të vitit 2024 me kosto historike është në vlerën 25,023,037 lekë, amortizim i akumuluar 11,771,382 lekë dhe teprica neto në fund të vitit 2024 vlera prej 11,771,382 lekë.

Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” për vitin 2024 është shtuar në vlerën 4,960,000 lekë që përbën vlerën e aksioneve qe ka bashkia në Klubin sportiv Valbona me NIPT M28322201I në vlerën prej 3,500,000 lekë dhe pjesëmarrjen në shoqërinë “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh.A” me NIPT M.I me vlere 1,460,000 lekë.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës Sh.A” me NIPT M. I, u konstatua se Bashkia Tropojë zotëron 14.6% të aksioneve të kësaj shoqërie. Kjo shoqëri është krijuar sipas akt marrëveshjes se Bashkive Tropojë, Has dhe Kukës dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë e përfaqësuar nga AKUM me nr.3206.prot., datë 19.07.2022 protokolluar nga AKUM me nr.1574.prot., datë 26.07.2022.Vlera e kapitalit të kësaj shoqërie është 10,000,000 lekë ku bashkia Tropoje zotëron ose 14,6% të tyre total 1,460,000 lekë.

Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Valbona” me NIPT M09230601A, u konstatua se Bashkia Tropojë zotëron 100% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 350 aksione me vlerë nominale 10,000 lekë secili, në total 3,500,000 lekë.

-Pra sa më sipër llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është vlerësuar me 4,960,000 lekë gjatë vitit 2024.

-Konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione në klubin sportiv “V”, megjithëse sipas nenit 8 në Ligjin nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”, përcaktohet shprehimisht: Neni 8, Neni 22, “Kapitali shtetëror”, ndryshohet si më poshtë:

1. Institucionet publike qendrore dhe vendore, që kanë në zotërim aksione të shoqërive tregtare sportive, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji⁴ i nxjerrin ato në shitje në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

2. Pas kalimit të këtij afati, institucionet publike qendrore dhe vendore nuk mund të zotërojnë aksione të shoqërive tregtare sportive.

3. Nëse në përfundim të periudhës njëvjeçare, aksionet e zotëruara nga institucionet publike në shoqëritë tregtare sportive nuk shiten, këto të fundit marrin formën sipas përcaktimeve të nenit 21 të këtij ligji.

-Pra sa më sipër Bashkia Tropojë duhet të kishte nxjerrë në shitje aksionet e saj.

Konkluzion: Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, nuk paraqet situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2024. Konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione në klubin sportiv “V” në vlerën 3,500,000 lekë ndërkohe këto aksione duhej ti nxirrte në shitje prej vitit 2021. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar. Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. Z.I, Kryetare e Bashkisë Tropojë/nëpunës autorizues

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në auditimin e vitit të kaluar është lënë rekomandim që të bëhet kontabilizimi i aksioneve të Klubit Sportiv “V”, gjë të cilën e kam bërë. Në lidhje me aksionet që kemi në zotërim, meaq sa kam pyetur di që është dërguar disa herë praktika në Këshillin Bashkiak dhe nuk është miratuar.

Në lidhje me këtë konkluzion sqarojmë se është e njëjta situatë siç edhe ju kemi sqaruar në konkluzionet nr. 10 dhe 11 (fq. 5-7) që ju kemi dërguar tek observacioni për Akt-Konstatimin nr. 1.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni ju keni kryer kontabilizimin e llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vetë”, për klubin sportiv Valbona për vlerën 3,500,000 lekë mirëpo vazhdoni që ti keni në zotërim këto aksione. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i njëjtë edhe në RPA.

Pasivi i Bilancit

Tabela 2/25 .Të dhëna për pasivin e bilancit/lekë

Llogaria	E M E R T I M I	2024	2023
	PASIVET(DETYRIMET)	179,768,910	161,995,947
	I. Pasivet Afat shkurtra	179,768,910	161,995,947
	I. Llogari te Pagueshme	179,768,910	161,802,477
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	41,042,022	57,002,144
42	Detyrime ndaj personelit	19,863,134	16,481,893
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	1,754,363	815,771
435	Sigurime Shoqërore	6,053,949	4,807,122
436	Sigurime Shëndetësorë	835,538	659,367

⁴ Hyrë në fuqi në muajin Shtator 2021

466	Kreditore për mjete ne ruajtje	45,276,535	35,946,686
467	Kreditore te ndryshëm	3,440,153	
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	61,439,296	46,089,494
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	193,470	193,470
419	Kreditore, Parapagime	192,470	193,470

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

Pasivet (Detyrimet) janë në vlerën prej 179,768,910 lekë të ndara përkatësisht, si më poshtë vijon :

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Tropojë më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2024, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave të investimeve si kreditorë të ndryshëm dhe operacione me shtetin (detyrime).

-Llogaria 401-408 “*Furnitorë dhe llogari të lidhura me to*”, është në vlerën prej 41,042,022 lekë të cilat janë detyrime ndaj të tretëve për faturat e mbërritura pranë financës, por të pa likuiduara brenda vitit për mungesë të fondeve. Në fillim të vitit 2024 kjo llogari ka qenë në vlerën 57,002,144 lekë dhe është pakësuar gjatë vitit për vlerën 15,960,122 lekë dhe ngelet gjendje në fund të vitit 2024 për vlerën 41,042,022 lekë. Në fund të vitit rezultojnë detyrime të prapambetura në vlerën totale 41,042,022 lekë të pasqyruara hollësisht në ***Tabelën 1/ Detyrimet e prapambetura të bashkisë ndaj të tretëve në fund të vitit 2024, në anekset bashkëlidhur këtij RPA.***

Për sa më sipër konstatohet që detyrimet prej 41,042,022 lekësh në fund të vitit 2024 përbëhen nga detyrime për vendime gjyqësore në vlerën prej 6,846,849 lekë, detyrime për shërbime në vlerën 5,775,495 lekë dhe detyrime për investime në vlerën 28,419,658 lekë. Detyrimet e mësipërme janë të viteve të mëparshme dhe nuk janë marrë masa për respektimin e radhës së pagesave për likuidim gjatë vitit 2024 duke qenë që janë likuiduar gjatë vitit 2024 fatura të mbërritura në 2024 dhe nuk janë likuiduar faturat e viteve të mëparshme.

Situata në lidhje me paraqitjen e detyrimeve ndaj furnitorëve është e pasaktë dhe e pa qartë . Nga auditimi u konstatua që llogaria 401-408 e detyrimeve ndaj furnitorëve për investime paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën prej 28,419,658 lekë Sipas të dhënave në lidhje me kapitalizimin e investimeve të llogarisë 213 të dhëna këto të përfuara nga certifikatat e marrjes në dorëzim të përkohshme, vlerat e situacioneve përfundimtare të punimeve paraqitet me diferencë në raportim llogaria 213 në vlerën 258,136,175 lekë (760,271,915-502,135,740)

Në bazë të dhënave nga certifikatat e marrjes në dorëzim të situacioneve përfundimtare për pakësimin e llogarisë 231(në të cilën përfshihen dhe vlerat e super vizionit dhe mbikëqyrjes) dhe shtesën në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” viti 2024 nuk plotësojnë kushtet kontabël sipas vlerave kontabël të regjistruara për kapitalizimin e investimeve objektet llogaria 213 për vlerën kontabël prej 263,726,682 lekë (667,611,126-403,884,444).Në total për llogarinë 213 vlerat kontabël që nuk plotësojnë kushtet kontabël për kapitalizimin e investimeve janë 263,726,682 lekë.

Konkluzion: Nga auditimi u konstatua që llogaria 401-408 e detyrimeve ndaj furnitorëve për paraqitet në fund të vitit 2024 në vlerën 41,042,022 lekë nga të cilat vlera prej 28,419,658 lekë është për detyrimet për investime. Nga auditimi i vlerave të situacioneve përfundimtare në certifikatat e marrjes në dorëzim të përkohshëm konstatohet mospërputhje të vlerave kontabël midis vlerave në certifikatat e marrjes në dorëzim kapitalizuar në llogarinë 213 dhe vlerave të pakësimit të llogarisë 231(në të cilën përfshihen dhe vlerat e super vizionit dhe mbikëqyrjes) për shumën totale 263,726,682 lekë. Gjendja e furnitorëve në total llogaria 401-408 në fund të vitit 2024 nuk jep siguri për saktësinë e vlerës së saj që është 41,042,022 lekë.

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në lidhje me këtë konkluzion sqarojmë se është e njëjta situatë siç edhe ju kemi sqaruar në konkluzionet nr. 10 dhe 11.

Me qenë se kontratat janë me afat, ku janë përcaktuar periudhat e kryerjes së pagesave, pavarësisht pse investimi ka një afat të përfundimit të punimeve, detyrimi paguhet sipas planifikimit që kemi bërë në buxhet dhe nuk kemi pse ta regjistrojmë si detyrim të prapambetur, pasi jemi brenda afateve të pagesës dhe nuk mund të quhet detyrim i mbartur.

Ashtu siç edhe ju sqaruam prezent, po ju sqarojmë përsëri dhe konkretisht: Që në fillim pasi nxirret Urdhër-Prokurimi, vijojejmë me Urdhër-Kërkesë-Blerja, ku shuma e investimit është e ndarë në vite, ku bëhet edhe regjistrimi në thesar. Pastaj me daljen e fituesit, regjistrohet në Thesar Urdhër-Blerja, ku përsëri shuma e operatorit fitues është e ndarë në vite.

Bashkëngjitur ju dërgojmë një Urdhër-Kërkesë Blerje nr. 4, dt. 24. 02. 2023 dhe Urdhër – Blerje nr.6, dt. 10. 05. 2023.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Subjekti gjatë periudhës së auditimit si dhe në observacionin e tij nuk ka paraqitur dokumentacion shtesë që të saktësojë mospërputhjen midis vlerave të situacioneve përfundimtare të punimeve për llogarinë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” dhe pakësimin e llogarisë 231 për vitin 2024 dhe pasqyrimin e detyrimeve në llogarinë 401-408 .Mospërputhja është në vlerën prej 263,726,682 lekë. Situacioni përfundimtar i punimeve dhe akti i marrjes në dorëzim të objektit provon që objekti është mbaruar dhe faturat kanë arritur pranë financës për kontabilizim të debitorëve. Për sa citohet në observacion subjekti vetë e pranon që likuidimet bëhen sipas planifikimeve të kontratave shumëvjeçare dhe ka pasqyruar në shtesën e AQT pjesën e likuiduar nga 231.Duke qenë që objekti ka përfunduar duhet të kontabilizohet vlera e detyrimit sipas faturave që përbejnë situacionin përfundimtar pavarësisht se kur kryhet likuidimi i tyre sipas planifikimit në vite. Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit nuk na ka paraqitur fatura të mbërritura në financë të pa kontabilizuara në lidhje me investimet gjatë periudhës së auditimit. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i njëjtë edhe në RPA.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 5, datë 21.02.2022, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 pika 3.2.Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarisë së të tretëve (Klasa 4) nënpika “Kontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve” përbehet nga: “Detyrimet: Kreditohen llogaritë (401/404/ e 467 e të tjera), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 ‘Shpenzime korrente’” dhe 23 Investime (në rastin e konstatimeve) si dhe pika Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarisë 21 “Aktive afatgjata materiale” për kapitalizimin e aktivitet (kur vihet në funksionim) bëhet hyrje Debitohet llogaria 21 “Aktive afatgjata materiale” kreditohet llogaria 231 “Investime për aktivet afatgjata materiale”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Znj. A.M, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Buxhetit

Drejtoria e Financës së Bashkisë Tropojë nuk ka respektuar radhën e kryerjes së pagesave duke qenë që ka kryer pagesa për detyrimet e lindura gjatë vitit 2024 ndërkohe që ka pasur detyrime të prapambetura që kanë qenë në fillim të vitit 2024.

Konkluzion :Drejtoria e Financës së Bashkisë Tropojë nuk ka respektuar radhën e kryerjes së pagesave për detyrimet ndaj të tretëve pasi konstatohet që janë likuiduar detyrime të vitit 2024 ndërkohe që ka pasur detyrime të vjetra të krijuara përpara vitit 2024.Veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-12, Rubrika “Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve”. Në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 27-30 ku citohet “Pagesat e detyrimeve të prapambetura do të bëhen

duke respektuar radhën sipas klasifikimit të detyrimeve të prapambetura në paragrafin 8 të këtij udhëzimi” qe janë sipas radhës “1-Detyrime për projekte investimesh 2-Detyrime për mallra dhe shërbime 3-Rimbursim i TVSH-së, 4-Rimbursim i tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin 5-Detyrime për vendime gjyqësore ndërkombëtare 6-Te tjera (vendime gjyqësore, shpronësime publike, përfitimet për persona me aftësi të kufizuar, etj.)”

Pretendimi i subjektit (Drejtoria Ekonomike), sipas observacionit me nr.3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr.467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në lidhje me këtë konkluzion ju kemi sqaruar prezent, po ashtu edhe në observacionet e mëparshme se detyrimet para vitit 2024 kanë qenë të trashëguara që në vitin 2019, ku nga ana jonë është bërë edhe grafiku i shlyerjes së këtyre detyrimeve ku dhe I jemi përmbajtur grafikut, sipas radhës.

Siç ju kemi sqaruar për detyrimet e krijuara rishtazi, në mënyrë që të mos paralizohemi si gjoba, kamat vonesa, apo penaltete tjera, ne kemi bërë planifikimin e tyre për shlyerje bashke me detyrimet e prapambetura sipas grafikut të hartuar dhe në çdo rast ju kemi përmbajtur grafikut. Këto detyrime jemi të detyruar ti paguajmë sipas planifikimit në buxhet dhe duhet ti përmbahemi këtij planifikimi. Ndërsa detyrimet e prapambetura siç ju them edhe më sipër I përmbahemi grafikut, duke vijuar nga detyrimi më I vjetër, , e përjashtim të ndonjë rasti që nuk ka dokumentacion bazë për kryerjen e këtyre pagesave.

Ne çdo vit buxhetor duhet të synohet që të paguhen në vazhdimësi gjitha detyrimet ndaj të tretëve dhe pavarësisht nëse fatura kalon afatin 60 ditor, nuk do të thotë që të lëmë papaguar këtë detyrim të vitit 2024, i cili siç e them edhe më sipër është i planifikuar edhe në buxhet. Synimi jonë ka qenë dhe është që të mos krijojmë detyrime të prapambetura, pra të mos i shtojmë këto detyrime vit pas viti. Nëse do ti përmbaheshim vetëm shlyerjes së detyrimeve të prapambetura, do të krijonim çdo vit detyrime të reja të prapambetura.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Për sa parashtroni në observacionin tuaj pranoni faktin që keni hartuar grafik për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura grafik i cili duhet të zbatohet dhe te respektohet radha e kryerjes së pagesave sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore. Observacioni nuk merret në konsideratë dhe qëndrimi ynë mbetet i njëjtë edhe në RPA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Znj. Z.I, Kryetare e Bashkisë Tropojë/nëpunës autorizues

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

-Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundër parti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Detyrimet ndaj të tretëve janë klasifikuar në llogarinë 401-408 ‘Furnitorë e llogari te lidhura me to’ për vlerën prej 41,042,022 lekë dhe ‘Kreditore te ndryshëm’ llogaria 467 për vlerën prej 3,440,153 lekë që përbëjnë vlerat e detyrimeve që bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve .

-Llogaria 42 ‘Detyrime ndaj personelit’, është në vlerën prej 19,863,134 lekë ku përfshihen pagat e punonjësve për muajin Dhjetor 2024, të cilat paguhen në muajin Janar të vitit 2025.

-Llogaria 431 ‘Detyrime ndaj shtetit’ për tatim mbi të ardhurat nga paga sipas klasifikimit të pagave, është në vlerën prej 1,754,363 lekë, që përfshin tatimin e pagave të muajit Dhjetor 2024, që paguhet në vitin pasardhës buxhetor brenda datës 20 Janar 2025 sipas legjislacionit në fuqi.

-Llogaria 435 ‘Sigurimet shoqërore’ në vlerën 6,053,949 lekë përben ndalesat e sigurimeve shoqërore te pagave sipas borderosë së muajit Dhjetor 2024 , si dhe sigurimet suplementare, të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe paguhen brenda datës 20 Janar 2025 sipas legjislacionit në fuqi.

-Llogaria 436 ‘Sigurimet shëndetësore’ në vlerën 835,538 lekë përben ndalesat e sigurimeve shëndetësore te pagave sipas borderosë së muajit Dhjetor 2024 , të cilat aplikohen mbi pagën bruto dhe paguhen brenda datës 20 Janar 2025 sipas legjislacionit në fuqi.

-Llogaria 466 “Kreditor për mjete në ruajtje”, është në vlerën prej 45,276,535 lekë në të cilën përfshihen 5% garanci defektsh për objektet e investimeve të cilave nuk u ka mbaruar afati garancisë së punimeve të parashikuar në kontratën e sipërmarrjes, por edhe garanci për të cilat nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme për likuidimin e tyre. Llogaria 466 është kredituar gjatë vitit 2024 në vlerën 9,329,849 lekë, që përfaqëson vlerën e garancive të mbajtura ndaj palëve të treta në debi të bankës.

Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % te garancisë së punimeve. Gjendja e llogarisë 466 në fillim të vitit 2024 ka qenë 35,946,686 lekë dhe është shtuar gjatë vitit 2024 në vlerën prej 9,329,849 lekë dhe rezulton në fund të vitit 2024 në vlerën prej 45,276,535 lekë. (**Referoju tabelës 2/ Shtesat e llogarisë 466 për vitin 2024, në anekse, bashkëngjitur këtij RPA**).

-Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është në vlerën prej 61,439,296 lekë. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin detyrime” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të pa arkëtuara nga vitet e mëparshme. Sipas informacionit analitik në këtë llogari janë kontabilizuar të drejta të Bashkisë Tropojë për arkëtim të detyrime të pa paguara të taksave dhe tarifave vendore nga bizneset, si dhe për detyrime të tjera individë, punonjës. Kjo llogari në fillim të vitit 2024 ka qenë në vlerë prej 46,089,686 lekë është debituar për vlerën prej 4,508,771 lekë që përben likuidimin e taksave për vitin 2024 dhe kredituar për vlerën prej 19,874,125 për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore të krijuara gjatë vitit 2024. Vlera prej 19,874,125 lekë përbehet nga debitorë biznes prej 6,490,214 lekë dhe debitorë për kontrata qiraje biznesi në vlerën prej 13,383,911 lekë.

-Llogaria 419 “Kreditorë, parapagime” në vlerën 193,470 lekë e pa ndryshuar në krahasim me vitin e mëparshëm dhe përbëhet nga detyrimi që njëzia vendore ka ndaj tre subjekteve person fizik të NJA Margegaj, për të cilat drejtoria ekonomike nuk administron dokumentacion për kohën e lindjes së këtij detyrimi dhe arsyen e detyrimit trajtuar edhe në raportin e mëparshëm të KLSH-së.

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën **3,465,057,344 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet (3,644,955,804 - 179,898,460).

Tabela 2/26: Fondi i konsoliduar viti 2024 /lekë

Llogaria	E M E R T I M I	2024	2023
	FONDI I KONSOLIDUAR:	3,465,057,344	3,348,497,742
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	3,345,154,583	2,888,334,856
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	64,462,970	70,270,366
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	55,439,791	389,892,520

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë

-Llogaria 101 “Teprica (Fondi Akumuluar)” është në vlerën prej 3,345,154,583 lekë, e përbërë nga aktivet materiale dhe jo materiale, si dhe gjendja e aktiveve qarkulluese (materiale dhe objekte inventari).

-Llogaria 85 “Rezultati veprimtarisë ushtrimore”, është në vlerën prej 64,462,970 lekë (Të ardhurat – Shpenzimet), e përbërë nga fondet buxhetore të papërdorura (në debi të llogarisë 520), që trashëgohen në vitin pasardhës buxhetor.

-Llogaria 105 “Grante kapitale të brendshme”, është në vlerën prej 55,439,791 lekë, e cila në fillim të vitit është çelur në kredi për vlerën 389,892,520 lekë, kredituar gjatë vitit në vlerën 189,995,548 lekë (185,035,548 lekë llogaria 231 dhe 4,960,000 llogaria 25-26 aktive financiare) për fonde të përdorura për shpenzime kapitale dhe financiare dhe debituar për vlerën 524,448,277 lekë, vlera e aktiveve të marra në dorëzim gjatë vitit 2024. Teprica debitorë në fund të vitit në vlerën prej 55,439,791 përfaqëson vlerën e investimeve në proces, llogaria 231 në vlerën 50,479,791 lekë dhe vlerën e llogarisë 25-26 në shumën 4,960,000 lekë.

2.3. Auditimi i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat dhe mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve. (referoju, tabelës 3/ Pasqyrës së Performancës Financiare, në anekse, bashkëngjitur këtij RPA).

Auditimi në lidhje me te ardhurat tatimore u fokusua në drejtim të rakordimit të të ardhurave sipas llojeve të tyre midis thesarit sektorit të taksave dhe tarifave vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. U kryen rakordimet e te ardhurave me thesarin sipas llojeve të tyre dhe pasqyrimin e tyre në pasqyrën e performancës financiare të bashkisë Tropojë.

Nga auditimi i ushtruar për të dhënat e te ardhurave sipas kodit të të ardhurave për taksat dhe tarifave vendore dhe te ardhurave jo tatimore sipas thesarit me të ardhurat e raportuara në pasqyrën e performancës financiare u konstatua që të ardhurat në total përputhen në vlerën prej 65,557,803. Nga auditimi rezulton që Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masa për saktësimin e taksave dhe tarifave vendore sipas kodit të të ardhurave sipas thesarit rrjedhimisht ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre, paraqitur në **Tabelën 4/Rakordimi i të ardhurave thesar Sektori i Taksave dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit**, në anekse, bashkëngjitur këtij RPA paraqiten të dhënat në lidhje me pasaktësitë e raportimit të taksave dhe tarifave vendore nga sektori i taksave dhe tarifave vendore pranë Drejtorisë dhe Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Tropojë.

Drejtoria e financës dhe Buxhetit nga ana e saj ka pasqyruar të dhënat në lidhje me taksat dhe tarifave vendore dhe te ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me te dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse si më poshtë vijon:

Tabela 2/27:Pasqyrimi i taksave dhe tarifave vendore dhe jo tatimore në Pasqyrat e performancës financiare

Nr.	Kodi i thesarit	Vlera sipas thesarit	Akt rakordim financë me sektorin e tatim taksave	Pasqyrimi në bilanc	Diferenca Thesar me sektorin e taksave
Totali 1	700	251,871	236,399	236,399	15,472
Totali 2	702	3,802,925	4,005,580	4,005,560	(202,655)
Totali 3	703	8,372,982	8,652,052	8,652,052	(279,070)
Totali 4	710	7,981,860	8,440,938	8,440,939	(459,078)
Totali 5	711	21,779,989	24,964,533	24,964,533	(3,184,544)
Totali 6	720	26,368,175	22,258,320	22,258,320	4,109,855
Totali		68,557,803	68,557,803	68,557,803	-

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë/përpunoi grupi i auditimit

Konkluzion: Nga auditimi rezulton që Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masa për saktësimin e taksave dhe tarifave vendore sipas kodit të të ardhurave sipas thesarit rrjedhimisht ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të llojeve të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre. Konstatohen pasaktësi në raportimin e taksave dhe tarifave vendore nga sektori i taksave dhe tarifave vendore pranë Drejtorisë dhe Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Tropojë

Drejtoria e financës dhe Buxhetit nga ana e saj ka pasqyruar të dhënat në lidhje me taksat dhe tarifave vendore dhe te ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me te dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse të të ardhurave.

Këto veprime apo mosveprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7 . “Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve vendorë. Forma dhe kodifikimi i këtij regjistri përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, te ndryshuar”.

Në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë e pika 1. ‘Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi’: Pika 1.3. ‘Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve’, sipas së cilës; germa ç).

Veprime në kundërshtim me Udhëzim nr. 8, datë 9.3.2018 ‘Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 pika 12 seksioni 3.1 ‘Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësinë e qeverisjes së përgjithshme paragrafi 37.

Për sa më sipër, mbajnë përgjegjësi:

Z. K.B, Përgjegjës i Sektorit të tatim taksave

Znj. F.H, Drejtore e Financës dhe Buxhetit / nëpunës zbatues

Llogaria 70 në vlerën prej 12,894,011 lekë, nga të cilat:

Llogaria 700-Tatimi mbi të ardhurat, në vlerën prej 236,399 lekë.

Llogaria 702-Të ardhura nga pasuria e paluajtshme, në vlerën prej 4,005,560 lekë ku përfshihen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore, ndërtesës, truallit.

Llogaria 703-Tatim mbi mallra dhe shërbime brenda vendit, në vlerën prej 8,652,052 lekë.

Të ardhurat jo tatimore

Llogaria 71 në vlerën prej **55,663,792** lekë e përbërë nga:

Llogaria 710-Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia (qiratë), në vlerën prej **8,440,939** lekë.

Llogaria 711-Shërbime administrative dhe të ardhura sekondare (tarifa administrative për lëshim dokumentesh, gjoba, shërbimi i zjarrfikëses), në vlerën prej **24,964,533** lekë.

Grante

Llogaria 72-Grant Korrent i brendshëm, në vlerën prej **746,158,531** lekë në të cilin përfshihen grante nga qeveria për shpenzime, financim i pritshëm, taksat e ndara, si dhe sponsorizime nga të tretë.

Shpenzimet

Shpenzimet në total për vitin 2024 janë në vlerën 750,253,364 lekë sipas Pasqyrës së Performancës Financiare për sa i përket shpenzimeve të detajuara si më poshtë vijon:

Tabela 2/28:Shpenzimet sipas pasqyrës së performancës financiare viti 2024 /lekë

Nr.	P e r s h k r i m i i o p e r a c i o n e v e	VITI	
		2024	2023
llogaria	Shpenzimet ne total	750,253,364	721,754,023
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	259,953,195	235,118,339
601	Kontribute te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore	42,900,095	38,623,164
602	Blerje mallra e shërbime	89,391,443	83,794,653
604	Transferime korrenti te brendshme	7,710,692	7,028,368
606	Transferime për buxhetet familjare e individë	351,062,568	357,171,809
63	Ndryshimi i gjendjes se inventarit	-764,629	17,690

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë/përpunoi grupi i auditimit

Auditimi në lidhje me shpenzimet u fokusua në lidhje me paraqitjen e tyre në ditarin e shpenzimeve sipas klasifikimit të riskut për çështje të shqyrtuara gjatë auditimit.

Llogaria 600_pagat dhe përfitimet e punonjësve për vitin 2024 janë në vlerën prej 259,953,195 lekë sipas të kontabilitetit te drejta dhe detyrime te konstatuara dhe përben pagat bruto të punonjësve detyrime të konstatuara gjatë vitit 2024 përfshirë dhe pagat e muajit Dhjetor 2024 që paguhen në muajin Janar 2025.

Pagat për vitin 2024 janë ndryshuar me vendim të Këshillit Bashkiak nr.84 datë 31.10.2024 me shkresën nr.4346/2.prot., datë 04.11.2024.

Llogaria 601 kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në vlerën prej 42,900,095 lekë që përbehen detyrimet e konstatuara për pagat dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore gjatë vitit 2024 përfshirë dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2024 që paguhen në muajin Janar 2025.Llogaria 601 përbehet nga nën llogaria 6010 kontributet e sigurimeve shoqërore në vlerën prej 38,498,882 lekë dhe 6011 kontributet e sigurimeve shëndetësore në vlerën prej 4,401,213 lekë.

Llogaria 602 Blerje mallra dhe shërbime në vlerën 89,391,443 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për mallra dhe shërbime të konstatuara për faturat e mbërritura në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit gjatë vitit 2024.

Të detajuara shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime sipas llojit të tyre janë si më poshtë vijon:

Tabela 2/29:Nën llogaritë e llogarisë 602 “Blerje mallra dhe shërbime” 2024/lekë

6020	Materiale zyre e te përgjithshme	5,008,488
6021	Materiale dhe shërbime speciale	5,818,930
6022	Shërbime nga te trete	25,378,153
6023	Shpenzime transporti	12,679,038
6024	Shpenzime udhëtimi	5,096,100
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	6,821,791
6026	Shpenzime për qiramarrje	22,000
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	12,576,523
6029	Shpenzime te tjera operative	15,990,420

Burimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë/përpunoi grupi i auditimit

Nën llogaria 6020 “*Materiale zyre e te përgjithshme*” në vlerën 5,008,488 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje dru zjarri, materiale pastrimi, bojëra printerësh dhe kancelari.

Nën llogaria 6021 “*Materiale dhe shërbime speciale*” në vlerën 5,818,930 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje ushqime për kopshtet dhe çerdhet, bojëra lyerje, veshje popullore etj.

Nën llogaria 6022 “*Shërbime nga te trete*” në vlerën 25,378,153 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje materiale ndërtimi, energji elektrike, ujësjellës kanalizime, prenotim etj.

Nën llogaria 6023 “*Shpenzime transporti*” në vlerën 12,679,038 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për blerje karburanti dhe pjese këmbimi për automjetet.

Nën llogaria 6024 “*Shpenzime udhëtimi*” në vlerën 5,096,100 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për dieta të punonjësve për udhëtime pune.

Nën llogaria 6025 “*Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme*” në vlerën 6,821,791 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për mirëmbajtje te shkollave dhe çerdheve dhe objekteve te bashkisë.

Nën llogaria 6026 “*Shpenzime për qiramarrje*” në vlerën 22,000 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për qiramarrje objekti.

Nën llogaria 6027 “*Shpenzime për detyrime për kompensime legale*” në vlerën 12,576,523 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për vendime gjyqësore, përmbarimi.

Nën llogaria 6029 “*Shpenzime për detyrime për kompensime legale*” në vlerën 15,990,420 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për paga kryepleq dhe këshilltare, vendime gjyqësore etj.

Llogaria 604 “*Transferime korrente të brendshme*” në vlerën 7,710,692 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për ndihma për financimin e dëmtimit dhe djegës së banesave të qytetareve.

Llogaria 606 “*Transferime për Buxhetet familjare e Individë*” në vlerën 351,062,568 lekë përben shpenzimet e kryera gjatë vitit 2024 për ndihmën ekonomike dhe të pa aftësisë. Nga verifikimi i situacionit të thesarit për vitin 2024 rezultojnë shpenzime te realizuara në vlerën prej 351,062,568 lekë rrjedhimisht nuk ka mospërputhje të vlerave.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi se:

Konkluzion:

-Në llogaritë 604 dhe 606 u konstatua një diferencë prej 263,457 lekë, si rezultat i klasifikimit të pasaktë të një shpenzimi jo material që duhej të ishte regjistruar në llogarinë 604.

- Llogaria nr.215 “*Mjete transporti*”, në pasqyrën F7, ka vlerën 70,536,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 67,083,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak.

- Nga auditimi i pasqyrës së pozicionit financiar u konstatuar se llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” me vlerë 61,390,362 lekë ka kundër parti llogarinë 4341, nuk ka kundër partinë përkatëse në llogarinë 470 “*Llogari në pritje – të ardhura për tu marrë*”. Gjithashtu konstatohet se në aktiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria 470 “*Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë*” (me kundër parti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar. Llogaria 470 nuk është as në pasqyrën e pozicionit financiar dhe as në llogaritë e rakordimit me Thesarin

-Llogaria 210 “*Toka, Troje, Terrene*” nuk pasqyron vlerën e saj të drejtë, pasi nuk janë kontabilizuar vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie, të konstatuara edhe në auditimin e mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Vlera e pasqyruar në mënyrë të përfshirë në regjistrat kontabël është në shumën 34,332,096 lekë, duke ndikuar nën-vlerësimin e pasurisë së njësisë dhe në pasaktësinë e pasqyrave financiare.

-Llogaria 211 “*Pyje, Plantacione*” nuk pasqyron vlerën reale të pasurisë, pasi nuk janë përfshirë në regjistrat kontabël vlerat e pyjeve dhe kullotave që janë kaluar me vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) në pronësi të ish-komunave, tashmë pjesë e bashkisë.

- Llogaria 231 “*Punime në proces*” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) ka mospërputhje të pakësimit të llogarisë 231 “*Punime në proces*” me shtesat e llogarive (212+213+214+218) për vlerën 8,574,174 lekë.

- Në Llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, rezulton se vlera e situacioneve përfundimtarë sipas certifikatave të marrjes në dorëzim të përkohshëm për 12 objekte është 760,271,915 lekë, vlerë e cila duhet të përputhet me shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024. Shtesa e llogarisë 213 për vitin 2024 rezulton të jetë 502,135,740 lekë, vlerë e cila nuk përputhet me shumën totale të situacioneve përfundimtare sipas certifikatave të marrjes në dorëzim, në vlerën 760,271,915 lekë. Për sa më sipër rezulton që nuk janë kontabilizuar saktë veprimet për shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024. Pra të dhënat e pasqyruara për pakësimin e llogarisë 231(në të cilën përfshihen dhe vlerat e super vizionit dhe mbikëqyrjes) dhe shtesën në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, nuk plotësojnë kushtet kontabël sipas vlerave regjistruara për kapitalizimin e investimeve për 8 objektet e marra në dorëzim për shumën prej 263,726,682 lekë (667,611,126-403,884,444).

- Llogaria 218 “*Inventar ekonomik*” është pakësuar gjatë vitit 2024 për vlerën 4,941,909 lekë. Nuk është kryer procedura e vlerësimit dhe asgjësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit, për vlerën 4,941,909 lekë, mungon dokumentacioni mbështetës dhe nuk është njoftuar Këshilli Bashkiak,

- Llogaria nr. 26 “*Pjesëmarrje në kapitalin e vet*”, nuk paraqitet situatën e drejtë në fund të vitit 2024. Konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione në klubin sportiv “Valbona” në vlerën 3,500,000 lekë.

- Llogaria 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” është nënvlerësuar për vlerën prej 26,037,782 lekë si pasojë e mos pasqyrimin të detyrimeve të vendimeve gjyqësore që kanë arritur pranë financës në vitin 2024.

Të ardhura të munguara në arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024 në vlerën 19,784,125 lekë duke e rritur gjendjen progresive të detyrimeve në vite në vlerën totale prej 61,390,362 lekë.

- Konstatohet se vlera e detyrimeve mbi vendimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2024 nuk është pasqyruar e saktë në Raportin e vetëvlerësimit financiar dërguar në MF. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2024, që duhej të raportohet në MF duhet të ishte në vlerën 26,037,782 lekë.

Bashkia Tropojë ka kryer likuidime për vendimet gjyqësore, në vitin 2024, në vlerën 14,574,893 lekë, e detajuar:

- 12,458,952 lekë, të paguara gjatë vitit 2024,

- 2,115,941, lekë shpenzime përmbartimore, duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit, por të cilat nuk kanë qenë të njohura në kontabilitet sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të

konstatuara, si shpenzime periudhe në momentin e marrjes së formës së prerë nga Vendimet e Gjykatave, por janë njohur në momentin e likuidimit.

2.3. Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Tropojë, në bazë të programit të auditimit nr. 467/1, datë 25.04.2025, mbajtur sot më datë 05.06.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr. 1087/9 Prot, datë 27.03.2025.
- Korrespondenca shkresore e ndjekur ndërmjet bashkisë Tropojë dhe KLSH-së.
- Dokumentacioni shoqërues dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.
- Dokumentacioni i mbajtur nga institucioni për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

- Bashkia Tropojë ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Tropojë, për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, “Mbi auditimin financiar për vitin 2023” trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 52, datë 05.03.2025, të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1087/9 Prot, datë 05.03.2025, u konstatua se:

-Bashkia Tropojë, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ka nxjerrë plan veprimin për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe me shkresën nr. 3621/24 datë 27.03.2025 “Plan veprimi, për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH” sipas Urdhrit nr. 47, datë 13.03.2025, të Kryetarit të Bashkisë Tropojë e ka dërguar kthimin e përgjigjes mbi zbatimin e rekomandimeve, në përputhje me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Grupi i auditimit ka audituar ecurinë e ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve në këtë fazë, pra pa u mbushur ende afati 6-mujor i zbatimit të tyre në lidhje me Vendimin nr. 52, datë 05.03.2025, të Kryetarit të KLSH-së, duke i dhënë përparësi zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të cilat nuk kanë pasur zhvillime të zbatimit. Në mënyrë të detajuar situata paraqitet si më poshtë:

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, me shkresën përcjellëse janë lënë **17 masa organizative, 2 masa për Eliminimin e Efekteve negative në përdorimin me eficiencë, efektivitet dhe efikasitet të të ardhurave si dhe uljen e borxhit tatimor, 7 masa** për të ardhura të munguara si dhe 4 masa disiplinore.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

- Nga **17 masa organizative të rekomanduara**, rezulton se **5 janë zbatuar plotësisht, 9 janë në proces zbatimi, 2 pjesërisht të zbatuara dhe 1 nuk është zbatuar.**
- Nga **1 masë për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike**, rezulton se **1 masë është në proces.**
- Nga **1 masë për Arkëtimin e taksave vendore si dhe uljen e borxhit tatimor**, rezulton se **1 masë është në proces zbatimi.**
- Nga **7 masa** për të ardhura të munguara përfshirë detyrimet nga qiradhënia, rezulton se: **1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 6 masa janë të pazbatuara.**
- **-Nga 4 masa disiplinore, rezulton se janë 4 masa në proces.**

Nga verifikimi i dokumentacionit, në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve në **auditimet e mëparshme (2021-2023)**, konstatohet se niveli i zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

Nga 16 masa organizative të rekomanduara, rezultojnë se 1 është zbatuar plotësisht, 13 janë në proces zbatimi, 1 masë pjesërisht e zbatuar dhe 1 nuk është zbatuar.

- **Nga 3 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara** në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, (D1) rezultojnë se 2 masa janë në proces dhe 1 masë e pazbatuar.
- **Nga 6 masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara** në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike, (B1) rezultojnë se 4 masa janë në proces, 1 masë pjesërisht e zbatuar dhe 1 masë e zbatuar.
- **Nga 5 Masa për Shpërblim dëmi**, rezultojnë 5 të pazbatuara.
- **Nga 18 masa disiplinore**, rezultojnë se janë zbatuar.

V.O: Nga rekomandimet e ri lëna për zbatim rezultojnë se rreth 50% e tyre janë të njëjta dhe të ripërsëritura. Janë trajtuar nga grupi i auditimit duke lënë edhe shënimin shpjegues.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe realizimin e buxhetit të vitit 2023, rezultojnë se është realizuar në masën 94.5%, ku nga vlera e parashikuar me gjithë shtesa prej 912,151 mijë lekë është realizuar vlera 862,316 mijë lekë. Ky mos realizim vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një vitit më parë, por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Investimet është zëri që ka përqindjen më të ulët, ku nga vlera e parashikuar prej 183,468 mijë lekë është realizuar në masën 148,075 mijë lekë ose 80.7 %. Kjo tregon se nga Bashkia Tropojë në fillim të vitit buxhetor planifikohen procedurat të prokurimit publik, pa u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Faturat e pa likuiduara në fund të vitit 2023, konstatohet se janë në vlerën 48,703 mijë lekë, vlerë e cila në raport me totalin e shpenzimeve të vitit prej 862,315 mijë lekë, zë 5.6 %, gjë që tregon se kjo njësi vendore nuk është në vështirësi financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me germën (a) të nenin 5, të ligjit nr. 68/2017, i ndryshuar, pikën 24 dhe 25 të nenit 3, nenin 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, si dhe pikat 8 dhe pika 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrë masa për likuidimin në kohë të të gjitha detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe të bëjë grafikun e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, respektimin e tij gjatë zbatimit të buxhetit, duke pasur në konsideratë burimin e fondeve për likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Sektori i Financës dhe Buxhetit është i predispozuar që të bëjë likuidimin e faturave ndaj të tretëve brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës, me përjashtim të rasteve kur ka mungesë dokumentacioni. Është bërë grafiku për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të vendimeve gjyqësore, ku është bërë likuidimi i të gjitha vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar. Po ashtu për Subjektin “H” është i planifikuar dhe do bëhet shlyerja sipas grafikut, deri tani kemi bërë shlyerje pjesërisht për këtë subjekt në vlerën 9,319,234 lekë. Brenda vitit 2025 do të bëhet likuidimin i gjithë vlerës për këtë subjekt.

1.2. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime realiste. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime

financimi të sigurta për t'u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigojohet plani i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Planifikimi nga Tatim Taksat është mbështetur mbi parashikime reale dhe është realizuar çdo vit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër *rekomandimet 1.1. dhe 1.2 konsiderohen të pranuar nga subjekti dhe janë pjesërisht të zbatuara.*

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për përgatitjen e PBA 2023-2025, u konstatua se:

- Nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Tropojë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar;

- Nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 35 të Ligjit nr. 68/2017, i ndryshuar, pasi nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit;

- Nuk janë zbatuar të gjitha fazat e hartimit të PBA, nuk është i dokumentuar i plotë i gjithë procesi i hapave të punës që duhet të ndiqen nga Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP) dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS-ja);

- Nuk janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”, për drejtuesit e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore, lidhur me hartimin e kërkesave buxhetore për programin përkatës, për realizimin e qëllimeve, objektivave dhe produkteve të programit gjatë procesit të zbatimit të buxhetit. Konkretisht në dosjet përkatëse të PBA dhe buxheteve vjetore, nuk administrohet dokumentacion mbi kërkesat për fondet të bëra nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Tropojë, në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, (si dhe mungon një analizë e detajuar);

Tavanet përgatitore dhe tavanet përfundimtare të PBA-së 2023-2025, janë miratuar jashtë afateve.

- Në buxhetin e të vitit 2023, nuk janë planifikuar investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.

- Gjithashtu konstatohet se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore për hartimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2023. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore”, pika 19 dhe pikat 22-23; pikën 1 të nenit 33, pikën 1 të nenit 35, pikën 1 të nenit 37 në Ligjin nr. 68/2017, i ndryshuar; pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisive të vetëqeverisjes vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të kryhen konsultimet me komunitetin dhe grupet e interesit.

-Dokumentimin e procesit të ndjekur për hartimin e PBA-së, nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

-Respektimin e afateve gjatë procesit të miratimit të Tavanëve Përgatitore dhe Përfundimtare të PBA-së;

-Pasqyrimin dhe trajtimin e risqeve financiare dhe fiskale të bashkisë të cilat cenojnë drejtpërdrejtë arritjen e objektivave të bashkisë;

-Planifikimin e fondeve për investime në ekonominë pyjore në pronësi të Bashkisë Tropojë.

Përgjigjja e institucionit/ Drejtoria Ekonomike: Gjithë Sektorët e Bashkisë në bashkëpunimin me Këshillin Bashkiak kanë bërë dëgjesa publike në çdo Njësi Administrative, sipas afateve të përcaktuara në lidhje me hartimin e PBA-së.

Komenti i grupit të auditimit: Janë dokumentuar mbledhjet nga Ekipet e Menaxhimit të Programeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik;

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi 2.1, konsiderohet i pranuar nga subjekti **dhe i zbatuar**.

2.2. Rekomandimi: Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen raportet 4 - mujore të monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, me të cilat të njihet këshilli bashkiak dhe njëkohësisht të dërgohen edhe në Ministrinë e Financave.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Janë hartuar raportet 4-mujore të monitorimit në lidhje me zbatimin e buxhetit për performancën financiare, si dhe i kemi dërguar edhe në Ministrinë e Financave.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi 2.2, konsiderohet i pranuar nga subjekti **dhe i zbatuar**.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se vlera e detyrimeve mbi vendimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2023 nuk është pasqyruar e saktë në Raportin e vetëvlerësimit financiar dërguar në MF. Nga auditimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion rezulton se detyrimet mbi vendimet gjyqësore të raportuara në MF janë në vlerën 1,384,443 lekë. Nga përlllogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, mbi bazën e dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura në 31.12.2023, që duhej të raportohet në MF duhet të ishte në vlerën 33,090,778 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin e MFE nr.37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

3.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme për raportimin e saktë të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Kemi punuar në vazhdimësi për regjistrimin evidentimin e detyrimeve të prapambetura dhe shlyerjen e tyre.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **në proces**.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 215 “Mjete transporti”, u konstatua se kjo llogari, është në vlerën 3,452,393 lekë, si rrjedhojë e mospërputhjes midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së inventarizimit. Konkretisht, “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 për vitin 2023 është në vlerën 67,084,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 63,631,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në kreu-n 3, pika 3.1, paragrafi 30 të Udhëzimit nr. 8, datë 9.03.2018, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë 215 “Mjete transporti”, duke sistemuar diferencat e evidentuara në vitin 2023.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Vlera e diferencës mes inventarit fizik dhe gjendjes në kontabilitet prej 3,452.393 lekë është një diferencë që është trashëguar që në vitin 2015 nga ish. Komuna Lekbibaj, përgjegjësi material për këtë diferencë nuk jeton. Që nga viti 2015 në çdo bilanc është pasqyruar kjo diferencë. Për sistemimin e saj duhet të ndiqet në rrugë, fillimisht për të vërtetuar me dokumente këtë diferencë dhe më pas për të vijuar me procedura ligjore.

Përsa i përket kamionit ku është shënuar që është blerë në vitin 2023 dhe nuk është kontabilizuar, ju sqarojmë se:

Kamioni është blerë në vitin 2022, në vlerën prej 7,632,000 lekë dhe konkretisht është bërë hyrje me Fletë-Hyrje nr. 8, dt. 03. 03. 2022 dhe pagesa e tij është kryer me Urdhër-Shpenzim nr. 108, dt. 28. 04. 2022.

Kontabilizimi i tij është bërë në bilancin e vitit 2022, formati 7a, blerje e krijuar me pagesë. Siç edhe jua kemi shpjeguar më sipër tek mbyllja e llogarisë 231, në disa artikuj, një ndër ta pra kamioni ka mbetur si llogari në investime në proces dhe pasi u bë sistemimi nga ana jonë në 2023, janë dërguar pasqyrat në Degën e Thesarit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **në proces**.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar me 4,960,000 lekë. Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Klubi i Futbollit Valbona” me NIPT M09230601A, rezulton se Bashkia Tropojë zotëron 100% të aksioneve me vlerë në total 3,500,000 lekë.

Veç sa më sipër, Bashkia Tropojë zotëron 16.6% të aksioneve të Shoqërisë Aksionare “Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a” me NIPT M. I vlerë në total 1,460,000 lekë.

Gjithashtu, Bashkia Tropojë vazhdon të zotërojë aksione në sh.a “Klubi i Futbollit Valbona”, në kundërshtim me nenin 8 të ligjit nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”. Urdhrin e Ministrit të MFE nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivitet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57, si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”; kreun 3.1, pika 31, shkronja “b” në Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3, faqe 45-57, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të llogarisë nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

Përgjigjja e institucionit, Drejtorja Ekonomike: Është kryer kontabilizimi në llogarinë 26 (pjesëmarrje në kapitalin e vet) për Klubin “Valbona” dhe për aksionet që kemi në Ujësjellës Kanalizime sha Kukës. Ky kontabilizim është bërë në bilancin e vitit 2024.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është **i zbatuar**.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, u konstatua se kjo llogari, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, është pasqyruar më shumë për vlerën 22,449,624 lekë, për garanci të cilave i ka kaluar afati dhe duhet t’u kthehen subjekteve përkatëse. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4” në udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018.

6.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave iu ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Përgjigjja e institucionit, Drejtorja Ekonomike: Për sa i përket kësaj llogarie, këto janë garanci që fillojnë që nga vitet 2010 e në vazhdim. Shumë nga këta operatorë ekonomikë, për të cilët është mbajtur garancia e punimeve, ose kanë mbyllur firmat, ose janë larguar jashtë vendit dhe nuk është paraqitur asnjë herë asnjë kërkesë për kthimin e këtyre garancive. Kthimi

i këtyre garancive bëhet pas plotësimit të afatit 2 vjeçar dhe daljes së certifikatës së përhershme të marrjes në dorëzim.

Kontabilizimi i kësaj llogarie është i saktë dhe i rakorduar me Degën e Thesarit.

Vijon puna për kthimin e këtyre garancive, duke respektuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak për vlerën 1,522,723 lekë, vlera e objektit “Rikonstruksion i sallës së muzeut”. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “b”, pikën 2, Klasën 2 “Aktivet afatgjata”5 (përbërja dhe trajtim kontabël) në udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018.

7.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme, për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 212, duke kryer veprimet e nevojshme në debi/kredi të llogarisë nr. 231 dhe llogarisë 101 “Fondet bazë”.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Është bërë kontabilizimi i saktë i llogarisë 212, duke i pasqyruar edhe shtesat që kanë ardhur me fondet e BE-së.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar*.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarive 210 “Toka, Troje, Terrene” 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të pasqyrave financiare, u konstatua se në këto llogari pasqyrohen vlerat e investimeve të kryera në vitet e mëparshme, pa ndryshuar në vijimësi, duke mos pasqyruar:
-Vlerat e truallit nën objekt dhe të truallit funksional, të objekteve si ndërtesat e shkollave, të kopshteve, të pallatit të kulturës, ndërtesat që ndodhen në Njësitë Administrative, etj.;
-Vlerat e trojeve, pyjeve dhe kullotave të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Tropojë dhe ish Komunave, aktualisht Njësi Administrative.
-Vlera prej 34,332,096 lekë të trojeve që janë pajisur me certifikatë pronësie.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 26, 27, 30 në udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Kapitullin III, pika 30 në udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar.

8.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masat e nevojshme për ngritjen e një grupi pune me qëllim kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve, si dhe në vijim Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene”, llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Është ngritur grupi i punës dhe po vijohet me plotësimin e dokumentacionit për certifikimin e pronave. Për vitin e ardhshëm do të parashikohet në buxhet fondi për tarifën e regjistrimit për disa pasuri, pasi janë shumë prona të paregjistruara dhe nuk ka buxhet të mjaftueshëm për të bërë certifikimin e të gjitha pronave. Për çdo pronë që do të regjistrohet dhe të merret certifikata do të bëhet kontabilizimi i tyre në llogarinë 210, 211.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *zbatuar*.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i llogarisë 401-408 “Furnitorë dhe llogari të lidhura me to”, u konstatua se kjo llogari, është pasqyruar më pak, për vlerën 5,021,709 lekë, për fatura të

5 Hyrjet e AAGJM dokumentohen: Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit, dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme). Për rrjedhim, Aktivët afatgjata, para se të vihen në shfrytëzim, pra të jenë funksionale, ato detyrimisht duhet të gjenden në proces, në formën e shpenzimeve që grupohen me analiza në llogarinë 23 “Investime”.

mbërritura, të pa likuiduara në fund të vitit 2023 dhe të pa regjistruara në pasqyrat financiare. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 - “funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4”.

9.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit Bashkia Tropojë, të marrë masat e nevojshme, që të kryejë vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të detyrimeve të bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Sektori i Financës dhe Buxhetit ka kryer në vijimësi kontabilizimin e detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve në llogarinë 401 – 408, në bazë të dokumentacionit të plotë.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*.

10. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tropojë rezultoi se për periudhën objekt auditimi në vitet 2022 - 2023 nuk janë certifikuar prona dhe objekte, nga 4726 prona me VKM vetëm 43 asete janë certifikuar para vitit 2021, nuk disponohen të dhëna dhe regjistra me gjithë të dhënat me modalitetet e duhura mbi pronat dhe nuk janë vlerësuar dhe kontabilizuar asetet dhe pronat që ka në juridiksionin e saj. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kreu (III), pika 35 dhe kreu (II), pika (16).

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorin e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Sektorin e Pronave dhe Hartografisë të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për vlerësimin dhe inventarizimin e pronave dhe të ndjekë procedurat për të certifikuar në ASHK Kukës pronat dhe asetet e saj.

Përgjigja e institucionit: Drejtoria e PZHT- se dhe Sektori i Pronave dhe i Hartografisë, me shkresën nr. 5245 Prot, të datës 17.12. 2024, është kërkuar nga Sektori i Pronave dhe i Hartografisë, zbatimi i këtyre rekomandimeve.

Me Urdhër nr. 16. prot./580, datë 28.01.2025, është ngritur grupi i punës për vlerësimin inventarizimin dhe certifikimin e pronave dhe aseteve të Bashkisë. Bashkëngjitur shkresës është Urdhri, kërkesa me nr. 580/1 prot. datë 29. 01.2025, kërkesa 619, datë 30. 01. 2025, informacion nr. 1572 datë, 26. 03. 2025 drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe lista me 26 prona.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*.

11. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tropojë rezultoi se sipas inventarizimit të pronave publike të konstatuara në vitin 2015 nga punonjësit e urbanistikës, rezultojnë troje të zëna në kundërshtim me ligjin dhe nuk është marrë as një masë, nuk ka as një veprim për të administruar dhe manaxhuar këto asete të bashkisë, si dhe nuk ka dokument argumentues ligjor të paraqitura pranë institucioneve përkatëse për ndjekjen procedurave ligjore me institucionet përkatëse për asetet e pronave të zaptuara nga qytetarët.

Konkretisht: Këndi i lojërave për fëmijë zona kadastrale 1347, emërtimi-truall, me sipërfaqe 5,883 m2; Çerdhe e fëmijëve Dardania emërtimi – truall + objekt, sipërfaqja 464 m2 dhe ndërtesë 400 m2; dhomë zhveshje e sportit zona kadastrale 1347, sipërfaqja 116 m2; fusha futbollit zona kadastrale 1347, sipërfaqja 8,793 m2; Terrene sportive sipërfaqe 8,793 m2 zona kadastrale 1347, Klubi Sportiv Valbona 41.5 m2 ndërtesë 41 m2 zona kadastrale 1347, Fushë futbollit, 8,753 m2 zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/17, zënë nga private; Zyrat e klubit Valbona 20 m2 zona kadastrale 1347, nr. pasurie 5/15 prona sipas VKM-së nr. 397 datë 01.06.2011, i kanë kaluar në administrim të Bashkisë Tropojë.

Mos veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime.

11.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin Juridik të marrin të gjitha masat dhe të ndjekin procedurat ligjore për të administruar dhe verifikuar asetet publike të zëna në kundërshtim me ligjin nga qytetarët dhe të bashkëpunojë me të gjitha institucionet ligj zbatuese deri në regjistrimin me certifikatë pronësie, për vënien e tyre në shërbim të publikut.

Përgjigja e institucionit, Sektori Juridik: Me urdhër nr. 16, dt. 28. 01. 2025, protokolluar me nr. 580 Prot, dt. 28. 01. 2025, të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe certifikimin e pronave të Bashkisë Tropojë dhe po punohet, për realizimin e detyrës së ngarkuar.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të dhënies me qira të pasurive të paluajtshme të Bashkisë Tropojë, u konstatua se kontratat e lidhura kanë mungesë dokumentacioni, si certifikatat e pronësisë si dhe nuk janë të bashkëngjitura hartat treguese të sipërfaqes së dhënë me qira, nuk ka vërtetim që janë shlyer detyrimet tatimore etj. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me VKM nr. 54, datë 05.02.2014, Kreu II, germa “ë” me ndryshime.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë të gjitha masat për të plotësuar dokumentacionin përkatës të munguar në dosjet e kontratave të dhënies me qira të pasurive të paluajtshme.

Përgjigje e Subjektit, Sektori Juridik:

Në të gjitha dosjet janë të administruara hartat treguese të sipërfaqes së dhënë me qira. Për çdo arkëtim të qirasë, kërkohet kopje të dokumentit nga Sektori i Tatim Taksave dhe i administrojmë në dosjen e subjektit.

Bashkia Tropoje nuk disponon certifikata të pronësisë për të gjitha pasuritë. Me urdhër Nr. 16, dt. 28. 01. 2025, protokolluar me nr. 580 Prot, dt. 28. 01. 2025, të Kryetarit të Bashkisë, është ngritur grupi i punës për ndjekjen dhe certifikimin e pronave të Bashkisë Tropojë dhe po punohet për realizimin e detyrës së ngarkuar.

Nga Sektori Juridik po vijon puna për inventarizimin e të gjitha dosjeve të kontratave. Deri më sot janë ri inventarizuar 20 dosje, duke bërë inventarizim të hollësishëm duke pasqyruar çdo dokument që ndodhet në dosje, duke shënuar numrin dhe datën e tij, sasinë e fletëve për çdo dokument, etj. Po vijojmë me ri inventarizimin e dosjeve të mbetura.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se nuk është bërë mjaftueshëm në lidhje me:

-Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë Komisioneve e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij. Me krijimin e Drejtorisë së Pyjeve dhe përfshirjes së saj në Strukturën e vitit 2023, nuk është përditësuar Rregullorja e institucionit, duke mos përfshirë në të objektivat, detyrat dhe kompetencat e kësaj Drejtorie në funksionimin e aparatit administrativ të Bashkisë Tropojë. Rregullorja e brendshme nuk është përditësuar, duke mos caktuar detyrat dhe përgjegjësitë e çdo sektori. Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut. Bashkia Tropojë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Në Bashkinë Tropojë nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij. Titullari nuk ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit. Nuk ka urdhër të titullarit për njohjen dhe trajnimin e stafit me ndryshimet në rregullore. Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj. Nuk është hartuar dhe miratuar në dokument të veçantë deklarata e misionit, si dhe nuk është përfshirë në rregulloren e

brendshme. Nuk ka dokumentacion provues ku të jetë dokumentuar takimet e GMS të realizuar gjatë vitit 2023.

Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me *Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 9; Ligji nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8, 12 dhe 27, neni 21, pika 2, neni 16, pika 2; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, paragrafi 3., Kreu II paragrafi. 2.2.6; kap 5; Udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 121 e 122; Udhëzimi i MFE nr. 16 datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut në njësitë publike”, pika 3.2.2.*

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të analizojë situatën dhe të nxjerrë përgjegjësitë përkatëse si dhe të marrë masa të menjëhershme për:

-Hartimin dhe miratimin e Rregullores së brendshme të përditësuar sipas strukturës organizative të miratuar për të rritur performancën e punonjësve, si dhe përgjegjshmërinë dhe përgjegjësinë e tyre në shërbim të qytetarëve.

-Të organizohen trajnime të vazhdueshme të personelit

-Të dokumentohet zhvillimi i mbledhjeve të GMS-së, për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Të hartohet e miratohet “Strategjinë e Menaxhimit të Riskut”, si dhe të funksionojë sistemi i raportimit për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisive të varësisë të saj.

-Të hartohet dhe miratohet gjurma e auditimit.

Përgjigjja e institucionit, Sektori i Burimeve Njerëzore:

Rregullorja e Brendshme: Procesi për hartimin e Rregullores së Brendshme të përditësuar, në përputhje me strukturën organizative të miratuar, është në zhvillim. Është ngritur grupi i punës me urdhër të Kryetarit të Bashkisë për përgatitjen e saj dhe aktualisht ndodhemi në fazën e hartimit të draftit.

Programi i Trajnimeve për Personelin: Është hartuar një program i strukturuar trajnimesh për punonjësit e bashkisë dhe njësisive të varësisë. Në bashkëpunim me ASPA-n (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike), janë dërguar kërkesat për mundësimin e trajnimeve, në përputhje me nevojat e identifikuar në program.

Për çështjet e tjera të ngritura (mbledhjet e GMS-së, strategjia e menaxhimit të riskut, gjurma e auditimit, sistemi i raportimit të progresit), proceset janë në vëmendjen e institucionit dhe do të ndërmerren hapat përkatës në vijim, në përputhje me planin e veprimit të brendshëm.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është ***në proces***.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përbërjes dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se;

Bashkia Tropojë e ka përfshirë në Strukturën Organike Njësinë e Auditit të Brendshëm, por nga verifikimi i dosjeve të personelit dhe struktura organizative, u konstatua se kjo strukturë është jo funksionale dhe nuk ka punonjës që ushtrojnë funksionin e audituesit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga informacioni i marrë nga pyetësorët drejtuar subjektit u konstatua se nuk është lidhur kontratë me institucion tjetër për realizimin e këtij shërbimi. Mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar neni 10 dhe Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 49. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisive të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pika 1;

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin dhe funksionimin e strukturës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm si pjesë e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë, duke pasur në konsideratë rekrutimin e punonjësve të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”

Përgjigja e institucionit, Sektori i Burimeve Njerëzore: Janë marrë masat përkatëse në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe me Strukturën Organike ngritur me urdhrin nr.59 datë 13.02.2024. Është krijuar Struktura e Auditimit të brendshëm. Në vijim, do të ndërmerren të gjitha procedurat e nevojshme për rekrutimin e punonjësve të certifikuar si “Auditues të Brendshëm”, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi. Sqarojmë së është përfshirë edhe në planin vjetor 2025, të rekrutimit të Bashkisë.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është ***në proces***.

15. Gjetje nga auditimi: Nga trajtimi i ankesës së z. R.I, me shkresën nr. 1133 prot., datë 19.09.2024 ku pretendohet se Urdhri i Kryetarit të Bashkisë, nr. 290, datë 09.09.2024, “Për transferimin e Përkohshëm të z. R.I”, vjen në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil” (i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017), VKM nr. 125, datë 17.12.2016 “Për Transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësit civil” si dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, u konstatua:

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Tropojë (kopje e procesverbalit të ekzekutimit të vendimit penal të Gjykatës), u konstatua se veprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, për ekzekutimin e Vendimin nr. 112 datë 06.09.2024 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë kryer më datë 09.09.2024, në orën 16:30, pas përfundimit të orarit zyrtar të punës në Bashkinë Tropojë. Duke qenë se ekzekutimi i masës është bërë në mbarim të orarit zyrtar të punës, Urdhri për Transferim nga ana e Kryetarit të Bashkisë Tropojë, z. R.B, arsyetohet të jetë kryer në çdo moment përgjatë orarit zyrtar të punës në Bashkinë Tropojë.

Me Urdhrin me nr. 290, datë 09.09.2024, Kryetari i Bashkisë Tropojë ka urdhëruar transferimin e z. I nga pozicioni i punës si Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Shërbimeve Publike dhe Transportit”, në mbulimin e detyrës së Punonjësit të Ndihmës Ekonomike, Paaftësisë dhe Invaliditetit, duke mos i ndryshuar pagën dhe marrëdhënien financiare. Në këtë rast, arrihet në konkluzionin e delegimit në një detyrë për interesin dhe nevojat e institucionit, në kushtet kur punonjësi mban të njëjtën kategori page.

-Për sa më sipër, Urdhri për Transferim i Kryetarit të Bashkisë Tropojë nuk bie në kundërshtim me Ligjin për Nëpunësin Civil.

-Nga shqyrtimi i akteve të përmendura më sipër u konstatua se në Urdhrin për Transferim nuk është përcaktuar afati kohor i këtij transferimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 49, pika 1, shkronja “a”.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, u konstatua se Bashkia Tropojë nuk ka shlyer detyrimet financiare të ngarkuar nga Gjykata përkundrejt z. R.I, duke qenë se janë përcaktuar fondet për shlyerjen e detyrimeve për vitin 2024, por do ta përfshijë në grafikun e shlyerjes së detyrimeve për vitin 2025. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, neni 49, pika 1, shkronja “a”.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ndryshojë Urdhrin për Transferim nr. 290, datë 09.09.2024, duke përcaktuar afatin kohor të transferimit, me qëllim arritjen e performancës maksimale nga nëpunësit e bashkisë në shërbim të qytetarëve si dhe të shmangë raste të tilla në të ardhmen.

Përgjigja e institucionit Sektori i Burimeve Njerëzore:

Në vijim të rekomandimit për ndryshimin e Urdhrit për Transferim nr.290, datë 09.09.2024, ju informojmë se:

Është marrë masë e menjëhershme dhe me urdhrin nr.322 datë 24.09.2024 është bërë ndryshimi i këtij urdhri, duke përcaktuar afatin kohor të transferimit.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është ***i zbatuar***.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën e KLSH nr. 518/10 prot., datë 17.11.2023, rezulton se: Bashkia Tropojë nuk ka kthyer përgjigje brenda afatit ligjor 20 ditor për planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, shkronja “j”.

-Bashkia Tropojë, me shkresën nr. 2751/100, datë 22.07.2024 ka dërguar raportin mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve jashtë afatit 6 - mujor në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014.

-Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, rezulton si vijon:

Nga 22 Masa të rekomanduara, janë pranuar plotësisht, është zbatuar 1 masë, janë në proces zbatimi 11 masa, janë zbatuar pjesërisht 3 masa dhe nuk janë zbatuar 7 masa.

Bazuar në sa më sipër, ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi.

16.1. Rekomandimi: Për përmirësimin e gjendjes, ri kërkojmë që kjo problematikë të shqyrtohet, analizohet nga Këshilli Bashkiak duke nxjerrë përgjegjësi konkrete për moszbatimin e rekomandimeve të KLSH-së. Gjithashtu ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është në proces, pasi konstatohet përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkojnë në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

A.1 MASA ORGANIZATIVE

1.1. Rekomandimi: Nga ana e Bashkisë Tropojë, të merren masat për zbatimin e plotë të komponentëve të MFK-së, duke hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, në përputhje me strukturën organizative; organizimin e Sistemit e Kontrollit të Brendshëm; hartimin e strategjisë së riskut, regjistrin e riskut, si dhe gjurmën e auditimit.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Me Urdhër Nr. 132/5, dt. 05. 12. 2023, protokolluar me nr. 2618/5 Prot, dt. 08. 12. 2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GSM) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për vitin 2024. Janë hartuar: Regjistri i riskut nr. 378/4 Prot, dt. 29. 01. 2024, Plani i Veprimit për zhvillimin e kontrollit të brendshëm të Bashkisë Tropojë, me nr. 378/2 Prot, dt. 29. 01. 2024. Nga Drejtoria Ekonomike është hartuar Harta e Proceseve të Punës nr. 378/3 Prot, dt. 29. 01. 2024 dhe Plani Vjetor i Punës për vitin 2024, nr. 378/1 Prot, dt. 29. 01. 2024.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkojnë në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe **është i zbatuar.** (*rekomandim i trajtuar dhe i përsëritur*).

2.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për organizimin e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, dhe të merren masa për planifikimin në programet e auditimit të fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, duke i dhënë mbështetje titullarit të njesisë publike në arritjen e objektivave, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë publike.

Përgjigja e institucionit Sektori i Burimeve Njerëzore:

Janë marrë masat përkatëse në lidhje me organizimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe me Strukturën Organike ngritur me urdhrin nr. 59 datë 13.02.2024 është hapur Struktura e Auditit të brendshëm. Në vijim, do të ndërmerren të gjitha procedurat e nevojshme për rekrutimin e punonjësve të certifikuar si “Auditues të Brendshëm”, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi sqarojmë së është përfshirë edhe në planin vjetor të rekrutimit të Bashkisë.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*. (*rekomandim i trajtuar dhe i përsëritur*).

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa:

- Për të vendosur një raport të drejtë midis numrit të punësuarve me ngarkesën e punës, sipas drejtorive, sektorëve përkatës, me qëllim arritjen e objektivave dhe kryerjen e shërbimeve ndaj qytetarëve.

- Krijimin e kushteve për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale me qëllim zbutjen e papunësinë.

- Të rishikojë emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile, të cilët nuk janë emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore. emëruar dhe paguar si “përgjegjës”, sipas përcaktimeve ligjore.

Përgjigjja e institucionit Sektori i Burimeve Njerëzore:

Mbi raportin midis numrit të punonjësve dhe ngarkesës së punës: Institucioni ynë vlerëson se aktualisht është rivendosur një raport i drejtë dhe i balancuar midis numrit të punonjësve dhe ngarkesës së punës në çdo njësi përkatëse. Kjo është bërë me synimin për të rritur eficiencën dhe cilësinë e shërbimeve që ofrojmë ndaj komunitetit. Struktura organizative është rishikuar dhe përditësuar në funksion të objektivave tona dhe nevojave të qytetarëve.

Mbi politikat për nxitjen e punësimit dhe përmirësimin e politikave sociale: Institucioni është i angazhuar të bashkëpunojë me aktorët përkatës për të mbështetur iniciativat që synojnë uljen e papunësisë dhe përmirësimin e kushteve sociale, duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e politikave zhvillimore në nivel vendor.

Mbi rishikimin e marrëdhënies financiare për punonjësit e gjendjes civile: Për sa i përket çështjes së ngritur për 9 specialistët e gjendjes civile, ju informojmë së institucioni ka marrë masa të menjëhershme. Në muajin pasardhës të konstatimit, është bërë rregullimi i marrëdhënies financiare në përputhje me emërtimin dhe përgjegjësitë e tyre, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Në lidhje me emërtesën dhe pagesën për 9 specialistë të gjendjes civile është bërë rregullimi i listë pagesës dhe fondi i mbetur në fund të vitit është përdorur për një pjesë të detyrimit. Do të vijohet me kthimin e diferencave të mbetura.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa për kontrollin e gjendjes teknike të disa mjeteve të rënda nëse janë rentabël ose jo, pasi paraqesin jetëgjatësi mbi 30 vjet dhe kanë mbushur kuotën e plotë të amortizimit referuar normave ligjore të përcaktuara, për të bërë mundur uljen e shpenzimeve të karburantit dhe pjesëve të këmbimit, për mjetet:

1. Autobot benz 47 - vjeçar viti i prodhimit 1976.
2. Kamioni benz 40 - vjeçar, viti i prodhimit 1983.
3. Kamion benz 37 - vjeçar, viti i prodhimit 1986.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Për mungesë fondesh jemi në pamundësi për të blere mjete të reja dhe jemi të detyruar të përdorim këto mjete megjithëse janë shumë të amortizuara.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Tropojë të marrë masa, për mbajtjen e partitarëve analitik, centralizatorit dhe librit veprimeve të ndryshme, sipas kërkesave ligjore, si dhe të marrë masa për uljen e vlerës së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila rezulton e rritur gjatë vitit 2022.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Mbahen në vijimësi partitarët analitik si dhe do merren masa për uljen e vlerës së llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

8.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të marrë masa që në vijimësi, për çdo rast për ndihma të menjëhershme për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, përpara se të procedojë me dhënien e tyre, të verifikojë plotësimin e dokumentacionit përkatës, duke siguruar gjendjen e dokumentacionit justifikues, në përputhje me kërkesat ligjore.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Me Urdhër nr. 72, dt. 28.04.2025, protokolluar me nr. 1993 Prot, dt. 28.04.2025 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur komisioni i verifikimit të kërkesave të qytetarëve për trajtimin me ndihmë të menjëhershme nga fondi rezervë.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, të marrë masa që në të ardhmen, në rastet e delegimit të kompetencave tek vartësit e tij, të përcaktojë të gjitha të drejtat dhe detyrimet e të deleguarit konform ligjeve dhe rregullave në fuqi, duke kryer dhe njoftimet e duhura në transparencë për publikun por dhe duke monitoruar njëkohësisht vendimet e marra nga i deleguari.

Përgjigje e Subjektit, Sektori Juridik: Do zbatohet me korrektësi për çdo rast.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

15.2. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, Drejtori i Kabinetit, Sektori Juridik, të marrin masa që në të ardhmen, përpara konceptimit të shkresave për delegimin e kompetencave të Kryetarit të Bashkisë tek cilido nga vartësit e tij, të argumentohet dhe dokumentohet arsyeja e delegimit të kompetencave duke respektuar njëkohësisht ligjin për formën dhe përmbajtjen e dokumentit të delegimit të kompetencave por dhe për afatin e delegimit.

Përgjigje e Subjektit, Sektori Juridik: Do zbatohet me korrektësi për çdo rast.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe në proces*.

16.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të marrë masat që në të ardhmen, të miratohen gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të Bashkisë, me qëllim dokumentimin e të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

19.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju

ri kërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshejtimin e atyre në proces si më poshtë:

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, Nëpunësit Autorizues, si dhe Kryetarit të GMS-së, duhet të marrë masa të menjëhershme për:

- Hartimin e një kuadri të plotë rregullash të shkruara, për secilin sektor dhe drejtori, për përcaktimin në përputhje me strukturën organizative, të ndarjes së detyrave, përshejtimin të tyre detyrave funksionale, si dhe përcaktimit të përgjegjësive dhe të drejtave të punonjësve të njësisë.

- Grupi i Menaxhimit Strategjik, të hartojë strategjinë e riskut, regjistrin e riskut, si dhe për aktivitetet dhe proceset kryesore të punës që zhvillohen në institucion, të hartohet gjurma e auditimit dhe harta e proceseve të punës.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Me Urdhër Nr. 132/5, dt. 05. 12. 2023, protokolluar me nr. 2618/5 Prot, dt. 08. 12. 2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GSM) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) për vitin 2024. Janë hartuar: Regjistri i riskut nr. 378/4 Prot, dt. 29. 01. 2024, Plani i Veprimit për zhvillimin e kontrollit të brendshëm të Bashkisë Tropojë, me nr. 378/2 Prot, dt. 29. 01. 2024. Nga Drejtoria Ekonomike është hartuar Harta e Proceseve të Punës nr. 378/3 Prot, dt. 29. 01. 2024 dhe Plani Vjetor i Punës për vitin 2024, nr. 378/1 Prot, dt. 29. 01. 2024.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkojnë në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces. (rekomandim i trajtuar dhe i përsëritur).*

1.2. Rekomandimi: Sektori i Burimeve Njerëzore të marrë masa për përditësimin e rregullores së brendshme, rregullimin e pozicioneve të punës për punonjës të cilët janë trajtuar si punonjës me “Kodin e Punës”, ku në fakt pozicioni i punës trajtohet sipas ligjit të “Nëpunësit Civil”.

Përgjigja e institucionit, Sektori i Burimeve Njerëzore:

Sektori i Burimeve Njerëzore ka hartuar tashmë një draft të rregullores së re të brendshme, në bashkëpunim me komisionin përkatës. Aktualisht, drafti është në fazën e rishikimit dhe përmirësimit, përpara miratimit përfundimtar. Qëllimi është që rregullorja e re të reflektojë të gjitha ndryshimet organizative dhe të sigurojë përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.

Mbi rregullimin e pozicioneve të punës në përputhje me ligjin për Nëpunësin Civil: Institucioni ka hartuar planin e rekrutimit, i cili parashikon hapjen e konkurseve për pozicionet e shërbimit civil që aktualisht janë të mbuluara nga punonjës të trajtuar sipas Kodit të Punës. Ky proces do të zhvillohet në përputhje me procedurat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar. Objektivi është që pozicionet përkatëse të mbulohen me nëpunës civilë, përmes një procesi transparent dhe të bazuar në meritë.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkojnë në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *pjesërisht i zbatuar. (rekomandim i trajtuar dhe i përsëritur).*

2.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në bashki, duke krijuar Njësinë e Auditimit të Brendshëm brenda strukturës organizative të Bashkisë Tropojë. Në përzgjedhjen e punonjësve të kihet në

konsideratë fakti se audituesi i brendshëm duhet të jetë i pajisur me certifikatën e “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Përgjigjja e institucionit Sektori i Burimeve Njerëzore:

Në zbatim të kërkesës për organizimin e shërbimit të auditimit të brendshëm në Bashkinë Tropojë, ju informojmë se:

Njësia e Auditimit të Brendshëm është krijuar tashmë në strukturën organizative të Bashkisë, me urdhrin nr. 59, datë 13.02.2024. Pozicioni përkatës është i përfshirë në planin vjetor të rekrutimit dhe është parashikuar të shpallet në përputhje me procedurat ligjore të rekrutimit sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil.

Gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatit do të respektohen të gjitha kërkesat ligjore, përfshirë kriterin që audituesi i brendshëm të jetë i pajisur me certifikatën përkatëse të “Audituesit të Brendshëm në Sektorin Publik”.

Komenti i grupit të auditimit:

Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces. (rekomandim i trajtuar dhe i përsëritur).*

5.1. Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Inspektoratin Vendore Mbrojtjes Territorit (IVMT), të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, për arkëtimin e detyrimeve debitorë në vlerën 42,876,907 lekë, të paraqitura në fund të periudhës 31.12.2021, kjo për të ulur nivelin e borxhit dhe rritur nivelin e të ardhurave të Bashkisë Tropojë.

Përgjigjja e institucionit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar.*

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të ngrejë grup pune me specialistë të fushës për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (AQT) të cilat janë pasuri e bashkisë, duke evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në teren.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Nga grupi i punës po vijon puna për evidentimin e të gjitha aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të cilat janë pronë e bashkisë, për të evidentuar statusin dhe gjendjen e tyre faktike në terren.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *në proces.*

6.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me strukturat e tjera të bashkisë të plotësojë regjistrin e të gjitha aktiveve sipas llogarive përkatëse, i cili të jetë elektronik dhe shkresor dhe të marrë masa për regjistrimin e pronave në ASHK dhe kontabilitet. Për çdo vit, të kryhet inventarizimi i këtyre aktiveve.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Ekziston Regjistri i të gjitha aktiveve përkatëse dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i këtyre aseteve. Grupi i punës i ngritur me urdher të Kryetarit të Bashkisë po vijon punën për regjistrimin e pronave në ASHK. Për çdo rast certifikimi do bëjmë regjistrimin e tyre në regjistrat përkatës.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *në proces. (rekomandim i trajtuar dhe i përsëritur).*

7.1. Rekomandimi: Nëpunësit zbatues të marrin masa për sistemimin në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin e aksioneve tek “Ujësjetës Kanalizime Tropojë ShA me vlerë 764,579,800 lekë, në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarisë financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Është bërë regjistrimi në llogarinë 26 (pjesëmarrje në kapitalet e veta), në bazë të kuotave që kemi tek “Ujësjetllës kanalizime sh. a” Kukës si dhe te “K.V”.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për plotësimin e listës së kreditorëve me të gjithë elementët e duhur, si objektin e prokurimit, numrin e faturës, datën e faturës, etj. elementë të cilët identifikojnë plotësisht llojin, kohën e lindjes së detyrimit, arsyen e detyrimit që Bashkia Tropojë ka ndaj të tretëve.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Po punohet në vazhdimësi.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *në proces*.

10.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të marrë masa të përshpejtuara për zbatimin e rekomandimeve që janë ende të pa zbatuara dhe në proces zbatimi si vijon;

Për 14 masa organizative të cilat janë konsideruar në proces zbatimi si dhe për 13 masa organizative të pa zbatuara.

Për 3 masa shpërbllim dëmi me vlerë 9,587,836 lekë.

Për 9 persona masa administrative me gjobë në vlerën 1,020,000 lekë sipas vendimit të APP.

Përgjigjja e institucionit: Në lidhje me këtë rekomandim janë përgjigjet respektive të dhëna pas çdo rekomandimi.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rezultati i përgjithshëm i zbatimit të rekomandimeve do të jepet në fund të këtij akt verifikimi.

B.1 MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën 43,951,182 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim për vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të merren masa për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPPP), kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet neni 93 i ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 “Mospagimi i taksave dhe tatimeve”.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për rekomandimin 2.1, duke qenë që është një rekomandim i ri përsëritur nga grupi i auditimit, do të trajtohet në përgjigjen e rekomandimit 1.1/ në Seksionin C.

2.1. Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Tropojë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 4,600,000 lekë nga 5 subjektet debitorë për taksën e lëshimit të licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, sipas listës në aneksin nr. 6 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti

Për rekomandimin 2.1, duke qenë që është një rekomandim i ri përsëritur nga grupi i auditimit, do të trajtohet në përgjigjen e rekomandimit 1.1/ në Seksionin C.

3.1. Rekomandimi: Zyra Juridike në hartimin e kontratave dhe shtesave të tyre me operatorë të ndryshëm në bashkëpunim dhe me Sektorin Pyjor i cili përpilon raportin teknik dhe me Drejtorin e Financës, të arkëtojnë detyrimin e kontraktuar në vlerën 2,201,048 lekë, aneksit nr. 10 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Përgjigje e Subjektit, Sektori Juridik:

Në lidhje me këtë Sektori Juridik sqaron se: Të gjitha kontratat janë lidhur me një afat të caktuar, ku është përcaktuar data e fillimit dhe mbarimit, për një kohëzgjatje nga 1 deri në 10 vite. Duke qenë se afati është përcaktuar qartë, marrëdhënia e qirasë është e vlefshme pa ndërprerje për gjithë kohëzgjatjen e caktuar, përveç nëse ka shkelje të kushteve të përcaktuara në kontratë dhe që na çojnë në zgjidhje të kontratës. Fakti që në kontratë është shënuar me të drejtë rinovimi çdo vit, nuk e hedh poshtë afatin e caktuar, pasi në një kontratë nuk mund të përcaktohen dy afate.

Në asnjë pikë të kontratës nuk është përcaktuar se çfarë do të rishikohet për rivlerësim në rinovimin që do të bëhet çdo vit.

Fakti që është shënuar në kontratë me të drejtë rinovimi çdo vit është quajtur e gabuar edhe nga KLSH në vitet e mëparshme dhe në vijim nuk janë rinovuar.

Në pikën 3.2 të kontratave është përcaktuar: Tre (3) muaj përpara përfundimit të afatit të mësipërm, secila palë duhet të njoftojë palën tjetër, për të negociuar shtyrjen e afatit të kontratës, për të njëjtën periudhë, ose për përfundimin e saj.

Pra siç konstatohet, kontratat janë me afat të caktuar dhe vlera e qirasë është përcaktuar sipas kohëzgjatjes së kontratës, bazuar në VKM nr. 391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", i ndryshuar me VKM nr. 1064, dt. 22. 12. 2010".

Përgjigje e Subjektit, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Bujqësisë: Ne si strukturë përgjegjëse për pyjet dhe kullotat kemi hartuar raportet teknike sipas udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat dhe procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik", ku përcaktimi i afatit të dhënies në përdorim të sipërfaqes pyjore/kullosore nga ku rrjedh dhe vlera përkatëse, është bërë mbështetur në kërkesat dhe dokumentacionin të sjella nga subjektet bashkëngjitur tyre. Për sa i përket pjesës ku keni shprehur se nga ana e zyrës juridike dhe inxhinierëve të pyjores është vepruar me dy standarde në vlerësimin e tarifave me operator të ndryshëm, theksojmë se pjesë me të drejtë rinovimi është parashikuar nëse ndryshon

legjislacioni në fuqi (tarifë, sipërfaqe) dhe nuk ndikon në vlerën e qirasë pavarësisht rinovimit apo ju sepse kontrata e qirasë dhe vlera e saj për tu paguar çdo vit është sipas përcaktimit të bërë në kontratë e raport.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i zbatuar*.

3.2. Rekomandimi: Bashkia Tropojë të përdorë të gjitha mekanizmat ligjorë, për lidhjen e 22 kontratave me operatorët për nxjerrje dhe shfrytëzim të mineralit të kromit, të cilët ushtrojnë aktivitet prej disa vitesh në asetet e Bashkisë Tropojë.

Përgjigjja e institucionit, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Bujqësisë: Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në zbatim të detyrave të tij ka ushtruar kontrole për menaxhimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve pyjore e kullosore bashkiake ku nga 26 subjektet minerare aktive sipas listës së vënë në dispozicion nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore me shkresën nr.3914/1, datë 27.06.2024 vetëm 11 subjekte minerare kanë kontratë me bashkinë për përdorim rruge sipërfaqe. Kemi evidentuar dhe njoftuar subjektet vazhdimisht për detyrimet dhe paraqitjen pranë bashkisë për lidhjen e kontratave sipas legjislacionit në fuqi.

Është kërkuar nga Sektori Juridik tek Sektori i Pyjeve e Kullotave informacion për subjektet që ushtrojnë aktivitet dhe nuk kanë lidhur kontratë, në mënyrë që të vijojmë me lidhjen e kontratave. Jemi në pritje të informacionit. Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 1938 Prot, dt. 23. 04. 2025. Pas plotësimit të praktikave përkatëse për secilin subjekt nga Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Bujqësisë, Sektori Juridik do vijojë me lidhjen e kontratave.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 4,059,163 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara në Bashkinë Tropojë për subjektet që kanë lidhur kontrata qiraje sipas aneksit nr. 4 pika 2.6 bashkëlidhur raportit të auditimit.

Përgjigje e Subjektit, Sektori Juridik.

Sektori Juridik me shkresë nr. 2815/3 Prot, dt. 04. 09. 2024 “Kërkesë për informacion, mbi qiratë e pa likuiduara nga subjektet private” ka kërkuar nga Sektori i Tatim Taksave, informacion mbi detyrimet e subjekteve që kanë marrë më qira sipërfaqe nga fondi pyjor kullosor, etj.

Sektori i Tatim Taksave me shkresë nr. 2815/5 Prot, dt. 10. 09. 2024, ka dërguar Regjistrin e qirasë të pa likuiduar sipas gjendjes datë 31. 08. 2024.

Për të gjitha subjektet që rezultonin debitor sektori juridik ka kërkuar në rrugë zyrtare, shlyerjen vullnetarisht të detyrimeve (shkresat nr.3708, 3708/1, 3708/2, 3708/3, 3708/4, 3708/5, 3708/6, 3708/7, 3708/8, 3708/9, 3708/10, 3708/11, 3708/12, 3708/13, 3708/14, 3708/15, 3708/16, 3708/17 Prot, dt. 16. 09. 2024).

Nga këto subjekte:

a. Subjekti “V” me kontratë nr.1573, dt. 16. 05. 2019, me kohëzgjatje 15. 11. 2019 – 14. 11. 2024 (me këtë subjekt nuk kemi rinovuar kontratën pas përfundimit të afatit).

Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3708/2 Prot, dt. 16. 09. 2024; Shkresë e Sektorit Juridik nr. 4257/1 Prot, dt. 21. 10. 2024; Kthim përgjigje e Sek. Tatim Taksave nr. 4257/3 Prot, dt. 22. 10. 2024 bashkë me nxjerrje llogarie dt. 11. 03. 2020, dt. 19. 11. 2021, dt. 29. 06. 2023; Shkresë e Sek. Juridik nr. 4257/5 Prot, dt. 25. 10. 2024 bashkë me foto e pagesës qirasë dt. 09. 11. 2023; Kthim përgjigje e Sek. Tatim Taksave nr. 4257/6 Prot, dt. 28. 10. 2024 bashkëngjitur me nxjerrje llogarie dt. 09. 11. 2023; Shkresë nr. 4257/9 Prot, dt. 30. 04. 2025.

Subjekti “B” për kontratën 2693/5 prot, dt. 18. 07. 2018, ka shlyer detyrimin për periudhën 18. 07. 2020 – 17. 07. 2021, që me dt. 16. 09. 2020, dokumenti nxjerrje llogarie dt. 16. 09. 2020. Praktika e ndjekur: Shkresë nr.3708/17, dt. 16. 09. 2024; Shkresë e subjektit b. “B ” nr. 1466 Prot, dt. 11. 10. 2024, protokolluar me tonën nr. 4149 Prot, dt. 15. 10. 2024; Kërkesa për informacion e Sek. Juridik nr. 4149/2 Prot, dt. 16. 10. 2024; Kthim përgjigje e Sek. Tatim

Taksave nr. 4149/3 Prot, dt. 17. 10. 2024 bashkë me nxjerrje llogarie dt. 29. 08. 2018, dt. 18. 07. 2019, dt. 16. 09. 2020, dt. 21. 06. 2023, dt. 13. 12. 2023; Faturë për arkëtim nr. 753, dt. 06. 11. 2024, pagesa e kryer pranë Bankës I.S. Me këtë subjekt kemi zgjidhur kontratën me kërkesë të tyre.

Për Subjektin SH, për kontratën 3359/7 , dt. 05. 12. 2020, Subjektin “H.V 1”. me Kontratë nr. 3708/8 Prot, dt. 16. 09. 2024, Subjekti Valmira Hoxha, është kthyer përgjigje tek rekomandimi 1.1. /Seksioni D/Masa për arkëtimin.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe është *në proces*.

5.1. Rekomandimi: Inspektorati Vendor i Mbrojtës Territorit (IVMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Tropojë, të kërkohet në Gjykatë, shndërrimi i 14 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 “Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv” dhe neni 30 “Arkëtimi i shumave të detyrimeve” të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe arkëtimi i vlerës 1,650,000 lekë, që kanë kryer ndërtim pa leje në territorin e Bashkisë Tropojë.

Përgjigje e Subjektit, Sektorit Juridik, Juristi B.H:

Nga ana e Sektorit Juridik është bërë kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesë nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi për gjoba të vendosura gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Në zbatim të Ligjit 127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake”, nuk i jemi drejtuar gjykatës, për gjoba të cilat janë shfuqizuar në zbatim të këtij ligji.

Nuk janë zbatuar akoma procedurat për shfuqizimin e tyre, pasi në dijeninë tonë akoma nuk ka dalë vendimi nga Këshilli i Ministrave për miratimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të pa ekzekutuara, sipas këtij ligji.

(Bashkëngjitur kërkesa nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

C.1. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tropojë të merren masa, të ndiqen të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 186,810 lekë pa t.v.sh nga BOE “N” & “R” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 866/2 Prot., datë 03.03.2022, me objekt “Rikualifikim urban “Lagja P” Blloku 1 & 2, Bajram Curri”, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. Gjithashtu të kryhet verifikimi në objekt me grup pune, në prezencë të mbikëqyrësit dhe subjektit kontraktues, lidhur me numrin e pusetave të shiut të vendosura në objekt, dhe në varësi të diferencave me ato të situacionuara, të procedohet me likuidimin financiar të tyre.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pa zbatuar*.

2.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë për shkeljet me veprimet e bankës të vitit 2022, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës totale 2,131,555 lekë, konkretisht:

*Të arkëtohet vlera 519,722 lekë nga 5 ish-punonjësit e larguar në 2015, për pagesa të paligjshme të pushimeve vjetore të pakryera dhe vjetërsi në punë, të paguar pas 7 viteve pa

bazë ligjore, sipas urdhër shpenzimit nr. 352 datë 01.04.2022, konkretisht: M.S, 105,400 lekë, K.R 117,300 lekë, J.T, 61,478 lekë, A.H, 56,657 lekë, A.G,178,888 lekë.

*Të arkëtohet vlera 65,233 lekë kamatë vonesa për energjinë elektrike nga financa e bashkisë, për periudhën janar- mars 2022, sipas urdhër shpenzimeve nr. 104, 104, 105 datë 15.04.2022.

*Të arkëtohet vlera 960,000 lekë shpenzime të paligjshme, për pritje-përcjellje dreka, nga pjesëmarrësit, sipas urdhër shpenzimit nr. 234 datë 16.08.2022 dhe nr. 315 datë 10.11.2022,

*Të arkëtohet ose ti zbritet vlera 26,000 lekë Albtelekomit sha, për periudhën Janar- Qershor 2022, pasi janë likuiduar tepër qira banesë.

*Të arkëtohet vlera 560,600 lekë, për likuidim 2 herë t.v.sh, në 4 raste, konkretisht:

- vlera 77,200 lekë, nga OE "SH" sh.p.k, sipas urdhër shpenzimeve nr. 408 datë 30.12.2022 dhe nr. 281 datë 13.10.2022

- vlera 131,400 lekë, nga BOE "K, V", sipas urdhër shpenzimit nr. 203 dhe datë 21.07.2022 dhe nr. 258 datë 21.09.2022.

- vlera 120,000 lekë, nga OE "A" sh.p.k, sipas urdhër shpenzimit nr. 205, datë 01.08.2022,

- vlera 130,000 lekë, nga OE "N", sipas urdhër shpenzimit nr. 228, datë 12.08.2022.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pa zbatuar*.

3.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të marrë masat për të kryer verifikimet e duhura lidhur me vonesat e konstatuara nga grupi i auditimit gjatë zbatimit të punimeve sipas kontratës me objekt "Rikonstruksion i 5(pesë) segmenteve rrugore, fshati Gri, Buljan, Cernikë, Tropojë", si rezultat i amendimeve të cilësuar nga grupi i auditimit, me mangësi ligjore, dhe nëse rezultojnë të pa bazuara në ligjet dhe rregullat në fuqi, atëherë të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 4,904,021 lekë, nga BOE "F" sh.p.k & "4A-M" sh.p.k & "V" sh.p.k, si vlerë që i përket penaltetit që duhej mbajtur për arsye të ekzekutimit të punimeve jashtë afateve të përcaktuara në kontratë.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pa zbatuar*.

4.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 60,000 lekë, nga BOE "F" sh.p.k & "A" sh.p.k, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pa zbatuar*.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 384,000 lekë, nga BOE "F" sh.p.k & "4A-M" sh.p.k & "V" sh.p.k, si vlerë që i përket zërave të punimeve të situacionuar, faturuar dhe likuiduar por të pa kryer.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pa zbatuar*.

D.1 MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë për qiratë e pa likuiduara që lidhen me përdorimin e aseteve të saj, të marrë masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë dhe administrativë, për arkëtimin e vlerës totale 3,835,358 lekë, nga 15 subjektet, si më sipër, për detyrime kontraktore të pa likuiduara, nga përdorimi i aseteve të Bashkisë Tropojë. Gjithashtu të kryhet inventarizimi i të gjitha dosjeve të kontratave të qirave, si dhe të plotësohen me dokumentacionin e konstatuar në mungesë.

Përgjigje e Subjektit, Sektorit Juridik: Dhënë përgjigje në rekomandimin 1.1, faqe 26, germa “D”. Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash”.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi është i përsëritur dhe do të jepet komenti në zbatimin e rekomandimeve të fundit, lënë nga grupi i auditimit të KLSH-së, sipas Vendimit të Kryetarit nr. 52, datë 05.03.2025.

2.1. Rekomandimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) dhe Drejtoria Juridike, të marrin masat, të ndjekin të gjitha hapat ligjorë dhe administrativë, me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtime të pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën 1,550,000 lekë.

Përgjigje e Subjektit, Sektorit Juridik, Juristi B.H:

Nga ana e Sektorit Juridik është bërë kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesë nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi për gjoba të vendosura gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Në zbatim të Ligjit 127/2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake”, nuk i jemi drejtuar gjykatës, për gjoba të cilat janë shfuqizuar në zbatim të këtij ligji.

Nuk janë zbatuar akoma procedurat për shfuqizimin e tyre, pasi në dijeninë tonë akoma nuk ka dalë vendimi nga Këshilli i Ministrave për miratimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të pa ekzekutuara, sipas këtij ligji.

(Bashkëngjitur kërkesa nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë).

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të ri kërkojnë në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces. (rekomandim i ri përsëritur dhe i trajtuar).*

3.1. Rekomandimi: Bashkia Tropojë, të marrë masat për hedhjen e Shtresës së asfalto betonit, sa më shpejt, me qëllim, shmangien e kthimit të investimit me vlerë 129,181,200 lekë, në një investim me pasoja negative financiare në të ardhmen, në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit të përdorimit të fondeve publike.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pa zbatuar.*

E.1 MASA DISIPLINORE.

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në komisionin disiplinor në

shërbimin civil”, dhe në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, i ndryshuar, si dhe në kontratën e punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse:

E. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil,

Marrjen e masave disiplinore përkatëse nga “Vërejtje” deri në “Paralajmërim për largim nga shërbimi civil”, si më poshtë:

1. Z. K.B, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimit Pyjor,

-Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Blerje kamioni”; me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”;

2. Z. K.S, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me realizimin e ulët të të ardhurave në buxhetin e bashkisë

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2” dhe procedura me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit: me objekt “Blerje kamioni”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”;

4. Z. M.K, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë

-Në cilësinë e antarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë + Ndërtim i tregut të bagëtime”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se nuk është dhënë masë disiplinore

5. Znj. F.D me detyrë specialiste në Sektorin e Tatim Taksave,

-Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

6. Znj. E.D, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Buxhetit e Financës,

- Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:

- Mos shlyerjen në kohën e duhur të faturave të pa likuiduara prej 86 milion leke, si dhe detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura, detyrime të cilat i kanë krijuar Bashkisë Tropojë vështirësi financiare. Për shkelje me veprimet e bankës për vitin 2022 në vlerën totale 2,131,555 lekë, duke kryer likuidime të pa argumentuara, si dhe për 2 raste, lejimin e shkeljeve teknike në inventarizimin dhe në nxjerrjet jashtë përdorimit

- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kamioni”;

7. Znj. SH.GJ, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ndihmës Ekonomike,

- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

8. Znj. S.M, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,
- Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në disa procedura prokurimi: me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, “Rikonstruksion i Shkollës “Oso Dauti”, Njësia Administrative Llugaj” dhe procedura me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”;
9. Znj. E.H, me detyrë specialiste në Sektorin e Pyjeve,
- Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje dru zjarri”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
10. Znj. A.M me detyrë specialiste e Sektorit të Buxhetit dhe Financës,
- Për problemet e konstatuara në lidhje me aktivitetin ekonomik financiar:
-Për mungesë dokumentacioni justifikues për dhënien e ndihmave të menjëhershme nga fondi rezervë, për vështirësi ekonomike dhe arsye shëndetësore, si dhe emërtim dhe për shkelje në procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit dhe asgjësimit materialeve.
-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion thertorja Shudenicë + Ndërtim i tregut të bagëtime”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
11. Znj. M.GJ me detyrë specialiste e Sektorit të Pronave dhe Kadastrës
-Në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës, në procedurën e prokurimi me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë - Lekurtaj”;
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
12. Znj. J.G, me detyrë specialist e Sektorit të Buxhetit dhe Financës
-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
13. Znj. A.S, specialiste kontabiliteti (Hartuese bilancit 2022), për shkeljet e mëposhtme:
-Për disa mangësi në mbajtjen e dokumentacionit të kontabilitetit, përkatësisht: mungesa e partitarëve analitik, ditari i veprimeve të ndryshme dhe libri i madh ose centralizatori.
-Për mos ndjekjen e të gjitha hapave ligjore për arkëtimin e vlerës 44,710,681 lekë të llogarisë 468 “detyrime të ndryshme”, debitorë taksave dhe qirave asetëve si dhe detyrimet e lëna nga KLSH dhe detyrime tjera prapambetura,
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
14. Znj. A.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik dhe Prokurimeve Publike dhe Apelimit Tatimor,
-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.
15. Znj. J.Q, me detyrë specialist jurist Sektori Juridik dhe Apelimit Tatimor,
-Për mos ndjekjen e të gjithë hapave ligjore dhe për mos ndërprerjen e kontratave, ndaj subjekteve që nuk kanë respektuar detyrimet dhe kushtet e kontratave për asetet e bashkisë të marra me qira, për pasojë krijimin e vlerës totale debitore 3,835,358 lekë nga 15 subjekte, Për mangësi dokumentare në dosjet e qirave të asetëve dhe mos inventarizimin e tyre,
-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.
16. Znj. E.K (M), me detyrë specialiste në Zyrën e Integritimit Evropian,
-Në cilësinë e anëtarit të Specifikimeve Teknike, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara.

E. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës, si dhe kontratën e punës respektive, marrjen e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

I.-Ulje në detyrë dhe kalimin në një pozicion pune të përshtatshëm me kualifikimin dhe nivelin arsimor, për:

1. Z. A.K, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor (I Autorizuar),

-Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në 6 procedura prokurimi, pasi janë vendosur kritere jo në përputhje me natyrën e kontratës, si dhe janë shpallur fitues OE që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

2. Znj. Z.I, me detyrë Zv/Kryetar Bashkie dhe ish Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, si dhe në cilësinë e personit përgjegjës në fushën e prokurimeve,

-Për shkelje dhe parregullsi të konstatuara në procedurat e prokurimit, copëzimi i fondeve (ndarja e vlerës së kontratës) dhe për pasojë devijimi nga aplikimi i LPP-së për shkak të mos aplikimit të rregullt të llojit të procedurës, që përbën një risk eventual për prokurimin e objektit me një vlerë më të lartë.

-Për të meta e mangësi në hartimin e projekt buxhetit në drejtim të numrit të lartë prej 361 veta të organikës së Bashkisë Tropojë, për efekt të mos justifikimit të ngarkesës dhe punës së tyre me dokumente e programe pune, çka ka ndikuar negativisht në buxhetin 2022.

-Për mos përmirësimin e politikave sociale-ekonomike, për të zbutur papunësinë dhe varfërinë, pasi ndihma sociale për 2022 zënë peshën kryesore prej 386 milion lekë ndaj shpenzimeve gjithsej ose 47 %, dhe ka tendencë në rritje, në vend që të ndodhte e kundërta si rezultat i shpërnguljes banorëve brenda dhe jashtë vendit.

-Për lejimin e krijimit të vështirësisë financiare, sipas nenit 56 të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, që do të rëndojë në fondet e viteve në vazhdim. Për mos shlyerjen e detyrimeve të planifikuara të vitit 2022 për detyrimet prapambetura në masën 30% ose në vlerë absolute 23 milion lekë, pasi janë likuiduar vetëm 6,2 milion lekë nga 23 milion lekë që duhej.

Përgjigjja e Institucionit, Sektori i Burimeve Njerëzore:

Titullari i institucionit, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ka urdhëruar eprorin direkt të nëpunësit për të bërë vlerësimin e rastit dhe për të përcaktuar nëse ekzistojnë kushtet për aplikimin e një mase disiplinore.

Pas analizimit të situatës dhe dokumentacionit përkatës, eprori direkt ka konstatuar se nuk plotësohen kriteret ligjore për vendosjen e një mase disiplinore dhe për këtë arsye ka vendosur pezullimin e procedurës.

Në këtë kontekst, institucioni ndodhet përballë një situatë ku në mungesë të një vlerësimi pozitiv për masë nga ana e eprorit të drejtpërdrejtë siç kërkohet nga legjislacioni në fuqi nuk mund të ndërmarrë hapa të mëtejshëm disiplinorë.

Për këtë arsye, kërkohet një qartësim shtesë nga ana juaj mbi mënyrën e procedimit në një situatë të tillë, ku kërkesa për masë disiplinore përsëritet, ndërkohë që procesi i brendshëm ligjor ka përfunduar me pezullimin e saj për mungesë të elementëve të shkeljes disiplinore.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i zbatuar*.

II.–Masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për këta punonjës:

1. Z. P.R, me detyrë përgjegjës tek Bordi i Kullimit

-Në cilësinë e anëtarit të Specifikimeve Teknike-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Kamioni”, pasi specifikimet teknike nuk janë të plota dhe të argumentuara. Gjithashtu në cilësinë e anëtarit të NJP-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me vendosjen e kriterëve jo në përputhje me natyrën e kontratës. Pjesëmarrja në këto dy komisione për të njëjtën procedurë prokurimi, ka shkaktuar konflikt interesi.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

2. Z. B.B, me detyrë Teknik ndërtimi në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

-Në cilësinë e anëtarit të KVO-së, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e prokurimit me objekt “Rikonstruksion Rruga Blini i Grisë -Lekurtaj” dhe procedura me objekt “Rikualifikimi urban i Lagjes “Partizani” blloku 1 & 2”, pasi ka shpallur fitues një OE që nuk plotëson kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DT.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se ky rekomandim është i pazbatuar.

Përgjigja e Institucionit, Sektori i Burimeve Njerëzore:

Për punonjës Z. B.B ju bëjmë me dije se ky punonjës nuk jeton më, dhe si rrjedhojë nuk ka vend për ndjekjen e mëtejshme të procedurës disiplinore.

Për punonjës Z. P.R, institucioni ka vendosur të rishqyrtojë rastin dhe të nisë ecurinë disiplinore në përputhje me procedurat e përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2023 janë në vlerën 33,090,778 lekë ose rreth 68 % e totalit të detyrimeve të raportuara. Përgjatë vitit 2023 Bashkia Tropojë ka kryer likuidime në vlerën 16,973,027 lekë, të detyrimeve të mbartura nga vitet e mëparshme.

Nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura, rezulton se Bashkia Tropojë për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2023 ka shpenzuar vlerën 4,373,027 lekë, për 9 raste, të cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomikitet, pasi praktikisht për një pozicion pune paguhen dy persona. Në urdhrin e Titullarit të institucionit për likuidimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme, nuk është nxjerrë përgjegjësia administrative ndaj personit që nëpërmjet veprimeve/mosveprimeve të tij (largimit nga puna) ka krijuar detyrime ndaj Bashkisë Tropojë. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësive administrative, do të ndikonte pozitivisht në korigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësi vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore dhe si rezultat shmangien e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 2 në Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të analizojë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohet (argumentimin dhe propozimin nga sektori i burimeve njerëzore për largimet nga puna, si dhe mbrojtjen juridike nga sektori juridik të çështjeve përkatëse pranë gjykatës), me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjeve gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjigja e subjektit: Janë kryer likuidime të vendimeve të gjykatave për punonjësit e larguar nga puna, gjatë vitit 2024, në vlerën 3,139,719 lekë.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti

Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***në proces***.

C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se deri në datën 31.12.2023 gjendja e debitorëve progresive për taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 33,117,410 lekë, e cila përbëhet nga:

- vlera prej 28,770,766 lekë për 268 subjekte debitorë të kategorisë biznes dhe 4 institucione.
- vlera prej 2,600,000 lekë për 3 subjekte debitorë që ushtrojnë aktivitetet në fushën e hidrokarbureve.
- vlera prej 773,644 lekë për 21 subjekte debitor nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet.
- vlera prej 973,000 lekë nga tarifa e kantierit për 14 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë, të cilat janë të kontabilizuara.

Për vitin 2023 vlera e detyrimeve të pa arkëtuara nga taksat dhe tarifatat vendore janë në vlerën 6,016,405 lekë ose 18 % e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga: -detyrimi prej 5,247,405 lekë për 128 subjekte debitorë të kategorisë biznes dhe 2 institucione, -detyrimi prej 769,000 lekë për 11 subjekte për tarifën e kantierit.

Sipas dokumentacionit të venë në dispozicion rezulton se nga sektori i tatim taksave janë marrë masa shtrënguese bllokim llogarish por jo në mënyrë shteruese deri në kallëzim penal. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, të ndryshuar.

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e mësipërme dhe të nxjerrë përgjegjësitë për gjendjen e debitorëve.

-Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tropojë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 33,117,410 lekë.

Përgjigja e subjektit: Sektori i Tatim Taksave: Masat e marra për arkëtimin e debitorëve:

Llogaritja e kamatëvonesave për periudhën 2020-2023 për subjektet debitorë dërguar Sektorit Financës për kontabilizim me shkresën nr 765 Prot. dt 07.02.2025.

Njoftim dhe kërkesë për të paguar, dërguar subjekteve debitorë me shkresat nr. 4992 - 4992/194 Prot. datë 04.12.2024.

Urdhër bllokimit e llogarive bankare, dërguar bankave të nivelit të dytë me shkresat nr. 5455 - 5455/188 Prot. datë 27.12.2024.

Njoftim për vendosjen e Barrës hipotekare dhe Barrës siguroese, dërguar subjekteve debitorë me shkresat nr.5456 5456/188 Prot. datë 30.12.2024.

Njoftim për vendosjen e Barrës hipotekare dhe Barrës siguroese, dërguar ASHK Kukës, D.R.SH. T. RR, Kukës dhe për dijeni Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK Tiranë me shkresat nr. 1729 - 1729/127, datë 07.04.2025

Bashkëlidhur keni provat shkresore:

-Pasqyra e lëvizjes së debitorëve, gjendje me 31.12.2023, (arkëtimet në vitin 2024, arkëtimet në 3 mujin e parë 2025, gjendja 31.12.2024, gjendja 31.03.2025).

Në lekë

PËRSHKRIM	Gjendja Debitorë më 31.12.2023	Arkëtimet në vitin 2024	Gjendja Debitorë me 31.12.2024	Arkëtimet ne 3 mujin e pare 2025	Gjendja Debitorë me 31.03.2025
260 subjekte debitorë kategoria biznes plus 4 institucione	28,770,766	3,419,771	25,350,994	846,334	24,504,660

3 subjekte debitorë që ushtrojnë aktivitet në fushën hidrokarbure	2,600,000	320,000	2,280,000	160,000	2,120,000
21 subjekte debitorë nga taksa e ndikimit në infrastrukture	773,644	0	773,644	111,077	662,567
14 subjekte që kanë kryer punime ndërtimi në territorin e Bashkisë Tropojë	973,000	769,000	204,000	0	204,000
T O T A L I:	33,117,409	4,508,771	28,608,638	1,117,411	27,491,227

Bashkëlidhur:

-shkresa e Sektorit Tatim Taksave nr.766 prot., date 07.02.2025 listat analitike te arkëtimit në vitin 2024 të debitorëve gjendje me 31.12.2024 dërguar Sektorit të Financës Bashkia Tropoje për pakësim debitorësh në bilancin e vitit 2024.

-Listat analitike te arkëtimit në vitin 3 mujorin e parë të vitit 2025 të debitorëve të periudhës 2012-2023.

Komenti i grupit të auditimit: Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara. Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese, rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.

Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***në proces***.

D. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për kontratat e qiradhënies së aseteve, lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë me palë të treta konstatohet që:

Bashkia Tropojë në procesin e ligjshëm të administrimit të aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre, për vitin 2023 ka gjithsej 34 kontrata qiraje aktive, kryesisht për biznese, për matjet e intensitetit të erës për qëllime studimi, mbjellje peme frutore dhe strehim social në vitin 2023 me afat qiraje 1 (një vjeçar) deri 9 vjeçare. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion të kontratave për dhënien me qira të tokës bujqësore, konstatohet se deri më datë 31.12.2023, për 14 kontrata nuk janë shlyer detyrimet në vlerën 11,021,770 lekë. të cilat janë të pa kontabilizuara dhe janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Ndaj këtyre subjekteve nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e detyrimit të krijuar si dhe zgjidhjen e kontratës. Referuar kushteve të kontratës nenit 4, pika 4.2, pagesa e qirasë do të jetë vjetore dhe do të bëhet brenda 5 ditëve nga nënshkrimi i kontratës për llogari të institucionit.

Gjithashtu, nëse nga subjektet refuzohet pagesa, po në zbatim të nenit 10, nga Bashkia zgjidhet kontrata për mos përmbushje të kushteve të saj.

1.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me sektorin e Bujqësisë dhe Drejtorinë Juridike të marrin masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 11,021,770 lekë, të cilat janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë nga 14 qiramarrësit e tokës bujqësore, pasqyruar në Kapitullin Anekse, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitorë.

Përgjigje e Subjektit: Sektori Juridik.

Sektori Juridik me shkresë nr. 2815/3 Prot, dt. 04. 09. 2024 “Kërkesë për informacion, mbi qiratë e pa likuiduara nga subjektet private” ka kërkuar nga Sektori i Tatim Taksave,

informacion mbi detyrimet e subjekteve që kanë marrë më qira sipërfaqe nga fondi pyjor kullor, etj.

Spektori i Tatim Taksave me shkresë nr. 2815/5 Prot, dt. 10. 09. 2024, ka dërguar Regjistrin e qirasë të pa likuiduar sipas gjendjes datë 31. 08. 2024.

Për të gjitha subjektet që rezultonin debitorë sektori juridik ka kërkuar në rrugë zyrtare, shlyerjen vullnetarisht të detyrimeve (shkresat nr.3708, 3708/1, 3708/2, 3708/3, 3708/4, 3708/5, 3708/6, 3708/7, 3708/8, 3708/9, 3708/10, 3708/11, 3708/12, 3708/13, 3708/14, 3708/15, 3708/16, 3708/17 Prot, dt. 16. 09. 2024).

Subjekti T.A sh. a, me kontratë nr. 1191, dt. 06. 03. 2017 ka shlyer të gjitha detyrimet dhe ka kërkuar zgjidhjen e kontratës, duke bërë njoftimin 6 muaj para. Siç është përcaktuar në kontratë. Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3708/13 Prot, dt. 16. 09. 2024; Shkresë e O, Nr. 2005/10 Prot, dt. 30. 10. 2024, protokolluar me tonën nr. 4482/2 Prot, dt. 04. 11. 2024 bashkë me fatura Bankare për kryerjen e pagesës pranë O bank, dt. 10. 10. 2024 (tre) copë; Nxjerrje llogarie dt. 24. 09. 2024; Shkresë e Sektorit Juridik nr. 4195/2 Prot, dt. 23. 10. 2024; Kthim përgjigje e Sektorit të Tatim Taksave nr. 4195/3 Prot, dt. 25. 10. 2024; Shkresë e Sektorit Juridik nr. 4195/5 Prot, dt. 01. 11. 2024; Kthim përgjigje e Sektorit Tatim Taksave nr. 4561 Prot, dt. 07. 11. 2024 bashkë me nxjerrje llogarie dt. 17. 10. 2024; Shkresë e Sek. Tatim Taksa nr. 1415 Prot, dt. 18. 03. 2025 bashkë me nxjerrje llogarie dt. 03. 02. 2025. Shkresë e Sek. Juridik nr. 4699/3 Prot, dt. 12. 05. 2025; kthim përgjigje e Sektorit të Tatim Taksave nr. 4699/4 Prot, dt. 13. 05. 2025.

Subjekti T.A, për kontratën 3623/2, dt. 03. 12. 2019, ka shlyer detyrimin me dt. 17. 10. 2024, në shumën 25,000.00 lekë: Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3708/3 Prot, dt. 16. 09. 2024, nxjerrje llogarie dt. 17. 10. 2024, Kthim përgjigje e Sektorit Tatim Taksave nr.4561 Prot, 07. 11. 2024.

Subjekti Sh., për kontratën 3359/7, dt. 05. 12. 2020, megjithëse i kemi njoftuar për shlyerjen e detyrimit, nuk janë dakordësuar. Nga Bashkia Tropojë është bërë zgjidhja e kontratës (shkresa nr.2861 dt. 24. 06. 2024). Sapo të pajisemi me certifikatën e pronësisë, do kërkojmë detyrimin në rrugë gjyqësore, është hartuar draft kërkesë-padia për pagim detyrimi. Praktika e ndjekur: Shkresë e "Sh" shpk nr. 04/2024 prot, dt. 22. 04. 2024, protokolluar me tonën nr. 2004 Prot, dt. 25. 04. 2024 bashkëngjitur me Vendim I AMBU nr. 68, dt. 17. 03. 2022 I protokolluar me nr. 636 Prot, dt. 17. 03. 2022; Shkresë e Sek. Juridik nr. 2004/1 Prot, dt. 29. 04. 2024; Kthim përgjigje e Sek. Tatim Taksave nr. 2004/2 Prot, dt. 02. 05. 2024, me aktet bashkëngjitur; Kthim përgjigje për subjektin "SH" shpk nr. 2004/3 Prot, dt. 07. 05. 2024; Shkresë e "SH" shpk nr. 05/2024 prot, dt. 26. 05. 2024, protokolluar me tonën nr. 2430 Prot, dt. 29. 05. 2024; Shkresa të Sek. Juridik nr. 2430/1 Prot, dt. 30. 05. 2024; nr. 2430/2 Prot dhe 2430/3, dt. 31. 05. 2024; kthim përgjigje e Sek. Tatim Taksave nr. 2430/4 Prot, dt. 03. 06. 2024 bashkëngjitur saje praktika; Kthim përgjigje e Sek. Pyjeve e Kullotave nr. 2430/5 Prot, dt. 05. 06. 2024; Kthim përgjigje e Nj. Adm. Bujan nr. 95/1 Prot, dt. 06. 06. 2024; Kthim përgjigje për subjektin "SH" shpk nr. 2430/7 Prot, dt. 07. 06. 2024; Shkresë nr. 2861 Prot, dt. 24. 06. 2024 "Njoftim zgjidhje kontrate"; Shkresë e Sek. Juridik nr. 2861/1 Prot, dt.20. 09. 2024; Shkresë e Sek. Pyjeve e Kullotave bashkë me praktikën; Shkresë nr. 3708/12 Prot, dt. 16. 09. 2024" Njoftim për shlyerje të detyrimit kontraktor.

Subjekti "V" për kontratën nr. 1574, dt. 16. 05. 2019, ka shlyer detyrimin dhe nuk është debitor ndaj Bashkisë Tropojë (Shkresë nr. 1451/3 Prot, dt. 22. 04. 2024, shkresë nr. 1451/4 Prot, dt. 23. 04. 2024, Nxjerrje llogarie dt. 11. 11. 2020, dt. 19. 11. 2021, dt. 09. 09. 2022 dhe dt. 09. 11. 2023)

Për subjektin "A.E.E", janë njoftuar për detyrimin që kanë. Janë paraqitur pranë Bashkisë dhe kemi diskutuar në lidhje me detyrimin dhe ju ofruam mundësinë për shlyerjen e detyrimit me këste. Deklaruan se janë në procedurë për të caktuar administratorin, pasi Administratorit E.X, i ka përfunduar afati me 29. 03. 2023. Duke qenë se nuk u paraqitën kërkesë për shlyerjen e detyrimit me këste ne dërguam njoftim për fillimin e procedurës për zgjidhje kontrate. Të gjitha njoftimet që kemi dërguar janë kthyer me shënimin e postës nuk gjendet, larguar, etj. Po vijojmë me procedurën për zgjidhje kontrate. Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3708/11 Prot,

dt. 16. 09. 2024; Shkresë nr. 1517 Prot, dt. 21. 03. 2025 e dërguar në dy adresa; Shkresë nr. 1517/1 Prot, dt. 14. 04. 2025; Fotokopje e tre zarfeve postare; lajmërim marrje.

Subjekti “M” shpk, me kontratë 1673, dt. 20. 04. 2017, sot figuron debitor në vlerën 575,000.00 lekë. Ky subjekt është njoftuar nga ana jonë për shlyerjen e detyrimit dhe më pas me shkresë nr. 518 Prot, dt. 24. 01. 2025 është njoftuar për fillimin e procedurës për zgjidhje kontrate. Ky subjekt është dakordësuar për zgjidhjen e kontratës, por pretendon se nuk ka detyrime pasi me shkresë nr. 04, dt. 08. 03. 2020 ka njoftuar për të bërë dorëzimin e sipërfaqes me proces-verbal, pasi nuk ushtron aktivitet. (Praktika e ndjekur: Shkresa të Sektorit Juridik nr. 518 Prot, 24. 01. 2025; nr. 518/1 Prot, dt. 27. 01. 2025; Kthim përgjigje e Sek. Pyjor nr. 518/2 Prot, dt. 30. 01. 2025; Shkresë nr. 04 Prot, dt. 04. 02. 2025, e Subjektit “M” shpk, protokolluar pranë Bashkisë Tropojë me nr. 518/3 Prot, dt. 05. 02. 2025 bashkëngjitur saje ka dërguar shkresat nr. 04 Prot, dt. 09. 03. 2020, shkresë nr. 02 Prot, dt. 02. 02. 2024, shkresë nr. 314/3 Prot, dt. 18. 02. 2021 MIE; Shkresa të Sek. Juridik nr. 518/4 dt. 06. 02. 2025; Kthim përgjigje nga Sek. Arkiv Protokoll nr. 518/5 Prot, dt. 07. 02. 2025 ku bashkëngjitur ka dërguar shkresat nr. 04 Prot, dt. 09. 03. 2020, shkresë nr. 02 Prot, dt. 02. 02. 2024 dhe nr. 1247 prot, dt. 04. 03. 2020 të njësuara me origjinalin; Shkresa të Sek. Juridik Nr. 518/6 dhe nr. 518/7 Prot, dt. 21. 02. 2025; kthim përgjigje e Sek. Tatim Taksave nr. 518/8 Prot, dt. 11. 03. 2025 bashkëngjitur kanë dërguar shkresë nr. 845 prot, dt. 13. 02. 2025 e Tatim Taksave; kthim përgjigje nga MIE, nr. 965/1 Prot, dt. 26. 02. 2025; Shkresë e Sek. Juridik nr. 518/9 Prot, dt. 28. 03. 2025. Me këtë subjekt është zgjidhur kontrata me urdhër nr. 59, dt. 28. 03. 2024, protokolluar me nr. 1618 prot, dt. 28. 03. 2025

Subjekti “L” shpk, me kontratë nr. 1672, dt. 11. 04. 2017, është njoftuar nga ana jonë për detyrimin që ka. Kemi kontaktuar dhe takuar në vazhdimësi. Ka pranuar detyrimin. I kemi ofruar mundësinë e shlyerjes së detyrimit me këste. Duke qenë se nuk paraqiti kërkesë zyrtare për shlyerjen e detyrimit nga ana jonë u bë njoftimi për fillimin e procedurës për zgjidhje kontrate. Subjekti me kërkesë zyrtare pranoi se do paguajë gjithë vlerën e detyrimit. Praktika e ndjekur: Shkresë nr.3708/16 Prot, dt. 16. 09. 2024; shkresë nr. 1442 Prot, dt. 19. 03. 2025; Kërkesë e subjektit nr. 05 Prot, dt. 03. 04. 2025, protokolluar pranë Bashkisë me nr. 1442/1 Prot, dt. 04. 04. 2025.; Shkresa të Sektorit Juridik nr. 1076 Prot, dt. 25. 02. 2025 dhe nr. 1076/1 Prot, dt. 11. 03. 2025; Kthim përgjigje e Sek. Tatim Taksave nr. 1076/2 Prot, dt. 13. 03. 2025 bashkë me faturë tatimore nr. 226, dt. 12. 03. 2025. Më pas na ka kontaktuar administrator I subjektit z. A.L dhe për disa arsye personale ka kërkuar ti jepet mundësia deri nga fundi i muajit Maj 2025, për të bërë shlyerjen e detyrimit. Nëse brenda këtij muaji nuk bëhet shlyerja e detyrimit do të zgjidhet kontrata.

Subjekti “V.A” me kontratë nr. 4943/2, DT. 18. 01. 2019, është njoftuar nga ana jonë për detyrimin që ka. Kemi kontaktuar dhe takuar në vazhdimësi. Ka pranuar detyrimin. I kemi ofruar mundësinë e shlyerjes së detyrimit me këste. Duke qenë se nuk paraqiti kërkesë zyrtare për shlyerjen e detyrimit, nga ana jonë u bë njoftimi për fillimin e procedurës për zgjidhje kontrate, kontratë e cila është zgjidhur. Praktika e ndjekur: Shkresë nr.3708/10 Prot, dt. 16. 09. 2024; shkresë nr. 416 Prot, dt. 21. 01. 2025; Shkresë e Sek. Juridik nr. 416/1 Prot, dt. 27. 01. 2025; kthim përgjigje nga Sek. Pyjor nr. 416/2 Prot, dt. 30. 01. 2025; shkresa të Sek. Juridik nr. 416/3 Prot, dt. 21. 02. 2025 dhe nr. 416/4 Prot, dt. 20. 03. 2025; kthim përgjigje nga Sektori I Tatim Taksave nr. 416/5 Prot, dt. 21. 03. 2025, me Faturë për arkëtim nr. 280, dt. 21. 03. 2025; Urdhër nr. 56, dt. 28. 03. 2025, protokolluar me nr. 416/6 Prot, dt. 28. 03. 2025; shkresat nr. 416/7, dt. 01. 04. 2025, dërgim urdhri Sektorit Pyjor dhe Sektorit të Tatim Taksave.

Subjekti “S.A” shpk, me kontratë nr. 2965/1, dt. 28. 07. 2017, rinovuar me kontrate 2965/2, dt. 27. 08. 2019, është njoftuar nga ana jonë për detyrimin që ka. Ka marrë njoftimin dhe është njohur me detyrimin. Duke qenë se nuk bëri pagesën nga ana jonë u bë njoftimi për fillimin e procedurës për zgjidhje kontrate, kontratë e cila është zgjidhur. Praktika e ndjekur: Shkresë nr.3708 Prot, dt. 16. 09. 2024; e-mail i shoqërisë” S.A” shpk dt. 20. 09. 2024, protokolluar pranë bashkisë me nr. 3830 Prot, dt. 23. 09. 2024 që vërteton faktin se janë njohur me detyrimin që kanë ndaj Bashkisë Tropojë; Shkresë e Bashkisë Tropojë nr. 3708/18 Prot, dt. 02.

10. 2024; shkresë nr. 517 Prot, dt. 24. 01. 2025; Shkresë e Sek. Juridik nr. 517/1 Prot, dt. 27. 01. 2025; Kthim përgjigje nga Sek. Pyjor nr. 517/2, dt. 30. 01. 2025; e-mail dt. 31. 01. 2025, protokolluar dërgim shkresë njoftim për fillim procedure për zgjidhje kontrate shoqërisë” S. A.” shpk; Shkresa të Sektorit Juridik nr. 517/4 Prot, dt. 21. 02. 2025 dhe nr. 517/5 Prot, dt. 27. 03. 2025; Kthim përgjigje nga sektori I Tatim Taksave nr. 517/6 Prot, dt. 28. 03. 2025 bashkë me faturë për arkëtim; Urdhër nr. 60, dt. 28. 03. 2025, protokolluar me nr. 517/7 Prot, dt. 28. 03. 2025; Shkresa nr. 517/8 Prot, dt. 01. 04. 2025 dërgim urdhër zgjidhje kontrate Sek. Pyjeve dhe Tatim Taksave.

Subjekti P.GJ, me kontratë qiraje nr. 1794/4 Prot, dt. 25. 06. 2018. Është njoftuar nga ana jonë për shlyerjen e detyrimit. Subjekti pretendoi se ka pronësinë për një sipërfaqe toke e cila duhet ti zbritet nga sipërfaqja e marrë me qira. Iu kërkua të sjellë dokumentacionin dhe po vijojmë me verifikimin nëse sipërfaqja që pretendon është në sipërfaqen e dhënë me qira dhe nëse akti i pronësisë është i rregullt. Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3708/9 Prot, dt. 16. 09. 2024; Shkresë e Sek. Juridik nr. 4667 Prot, dt. 14. 11. 2024, Kërkesë e Subjektit “P.GJ” dt. 18. 11. 2024, protokolluar me tonën nr. 4756 Prot, dt. 18. 11. 2024; Kthim përgjigje e Sek. Pyjor nr. 4667/1 Prot, dt. 21. 11. 2024; Shkresë nr. 4667/2 Prot, dt. 25. 11. 2024; Certificate regjistrim pronësie, kartelë pasurie, fragmenti I hartës kadastrale; Shkresë nr. 602 Prot, dt. 29. 01. 2025; Kthim përgjigje nr.464/1 Prot, dt. 13. 02. 2025, protokolluar me tonën nr. 602/1 Prot, dt. 20. 02. 2025; Shkresë e Sek. Juridik nr. 602/2 Prot, dt. 24. 02. 2025 dhe nr. 602/3, dt. 13. 05. 2025

Subjekti “H.V 1 & 2”. me Kontratë nr. 3708/8 Prot, dt. 16. 09. 2024. Është njoftuar nga ana jonë për shlyerjen e detyrimeve. Është paraqitur pranë Bashkisë ku kemi diskutuar në bashkëpunim me Sektorin Pyjor, në lidhje me detyrimin që ka, qira të pa likuiduar. Subjekti pretendon se përderisa nuk është pajisur me leje ndërtimi nuk ka ushtruar aktivitetet dhe për rrjedhojë nuk ka detyrim për pagesën e qirasë. Kemi realizuar disa takime me këtë subjekt ku i kemi ofruar edhe shlyerjen e detyrimit me këste. Subjekti nëpërmjet një studioje ligjore ka paraqitur kërkesë ankimore dt. 06. 02. 2025. Me shkresë nr. 804/2 Prot, dt. 25. 02. 2025 i kemi kthyer përgjigje Studios Ligjore dhe për dijeni subjektit në lidhje me ankimin e paraqitur nga ana e tyre. Duke qenë se nuk arritëm një marrëveshje për shlyerjen e detyrimit me këste subjekti është njoftuar nga ana jonë për fillimin e procedurës për zgjidhje kontrate. Me shkresë nr.270 Prot, dt. 30. 04. 2025 subjekti ka kërkuar amendim kontrate dhe heqjen e pagesave të padrejta. Jemi duke përpiluar kthim përgjigjen për subjektin “H.V 1”. Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3708/8 Prot, dt. 16. 09. 2024; Kërkesë ankimore e subjektit nr. s’ka, dt. 06. 02. 2025, protokolluar me tonën nr. 804 Prot, dt. 11. 02. 2025; shkresë e Sektorit Juridik nr. 804/1 prot, dt. 17. 02. 2025; Kthim përgjigje e Bashkisë Tropojë nr. 804/2 Prot, dt. 25. 02. 2025; Kthim përgjigje e Sektorit të Tatim Taksave nr. 804/3 Prot, dt. 10. 03. 2025 bashkë me 6 fatura për arkëtim; Njoftim fillim procedure për zgjidhje kontrate nr. 1640/1 Prot, dt. 01. 04. 2025; Shkresë nr. 270 Prot, dt. 30. 04. 2025, protokolluar me tonën nr. 1640/1 Prot, dt. 02. 05. 2025. Subjekti B, shpk me kontratë nr. 3360/2 Prot, dt. 01. 08. 2022, është njoftuar nga ana jonë për shlyerjen e detyrimit kontraktor. Kemi zhvilluar një takim me administratorin e subjektit ku deklaroi se nuk është lejuar të ushtrojë aktivitetet dhe kjo është arsyeja që nuk ka paguar qiranë. Për shkak të mos pagesës kemi bërë edhe njoftimin për fillim procedure për zgjidhje kontrate, por duke qenë se është regjistruar një procedim penal nuk kemi vijuar më tej për zgjidhjen e kontratës. Subjekti është paraqitur dhe ka deklaruar se do kërkojë pezullimin e kontratës deri në përfundim të procedimit penal për këtë çështje, por akoma nuk ka paraqitur kërkesën në rrugë zyrtare.

Për subjektin “M.I”, me kontratë nr.2894, dt. 12. 07. 2017, po vijojmë procedurat për vjeljen e detyrimit. Praktika e ndjekur: Shkresë e Sek. Juridik nr.2144 Prot, dt. 09. 05. 2025, Shkresë nr. 2144/1 Prot, dt. 09. 05. 2025 e Tatim Taksave; Shkresë e Sektorit Juridik nr. 2144/2 Prot, dt. 14. 05. 2025.

Subjekti V.H, ka shlyer detyrimin në shumën 120,000.00 lekë me mandate arkëtim dt. 21. 10. 2024. Praktika e ndjekur: Shkresë nr. 3709/6 Prot, dt. 16. 09. 2024, mandate arkëtim me nr. Reference 710566515, dt. 21. 10. 2024.

Përgjigja e institucionit, Drejtoria Ekonomike: Është bërë kontabilizimi i debitorëve gjendje me dt. 31. 12. 2024, të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë nga qiramarrësit e tokës bujqësore, pyje kullota etj.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër dhe nga verifikimi i dokumentacionit të sjellë, rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***pjesërisht i zbatuar***.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë në sektorin e tatim taksave për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar” rezultoi se në Bashkinë Tropojë dhe NJA për vitin 2023 janë taksuar 1421 familje. Me qëllim vlerësimin nëse është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë “familjar”, u kryqëzua informacioni i administruar nga struktura e mësipërme me informacionin e gjendjes civile. Nga përllogaritjet e kryera, rezultoi se për vitin 2023 janë taksuar 8029 familje më pak sesa duhej të taksoheshin për kategorinë familjar.

-Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojë Bashkia Tropojë nga kategoria “Familjar”. Konkretisht, nëse do të bënim përllogaritjet vetëm për tarifën e Shërbimit (pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit) për qytetin Tropojë për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim mesatarisht 1,875 lekë * 2301 familje taksuar më pak = 4,314,375 lekë planifikuar më pak, dhe në Njësitë Administrative për numrin e familjeve të pataksuara, do të kishim 937,5 lekë * 5728 familje taksuar më pak = 5,370,000 lekë planifikuar më pak.

-Gjithashtu situata e mësipërme tregon se Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë nuk ka një regjistër të përditësuar të kategorisë “Familjar”, duke pasur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 07.03.20186, e ndryshuar, detyrim për t’u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë “Familjar”.

-Në lidhje me administrimin e taksave/tarifave nga familjarët, rezultoi se për arkëtimin e taksave të familjeve të qytetit Tropojë dhe Njësi Administrative, taksimi dhe tarifimi i familjeve bëhet fizikisht, pra lëshohet faturë kur familjari paraqitet pranë zyrave të bashkisë për të përfutur shërbim, duke mos marrë masat e duhura për të njoftuar tatimpaguesit familjarë nëpërmjet dërgimit të “Njoftim Vlerësimi”, apo shkresës zyrtare nëpërmjet Zyrës Postare, për detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

Bashkia Tropojë nuk ka një akt marrëveshjeje me Ujësjetllës sh.a. Tropojë, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të rolit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 7 në nenin 4, nenin 20, nenet 20-24 në Kreun IV të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar; Pikën 1 të nenit 12 në Ligjin nr.68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Pika II.1 Tabela 11 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë për vitin 2023.

2.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Administratorët e Njësi Administrative, të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve të pataksuara me taksa/tarifa vendore, përditësimin e regjistrit të familjeve, me qëllim reduktimin e të ardhurave të munguara, si rrjedhojë e mos taksimit të plotë të kategorisë “Familje”, ku vetëm në përllogaritjen e tarifës së pastrimit dhe shërbimit për vitin 2023, rezultojnë 9,684,375 lekë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe ***i pazbatuar***.

2.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Sektori i Tatim Taksave, të marrë masat e nevojshme, për të analizuar situatën e krijuar me efekt mos arkëtimin e të ardhurave nga

6 Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

taksat dhe tarifate vendore nga abonentët familjarë, si dhe vlerësimin e mundësisë për lidhjen e marrëveshjes me agjentin tatimor UK sh.a Tropojë me qëllim që taksat dhe tarifate vendore për kategorinë “Familjar” të mblidhen nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i veprimtarisë së Sektorit të tatim Taksave Bashkia Tropojë për taksimin dhe tarifimin e subjekteve me aktivitet “Hoteleri” rezulton se për vitin 2023 taksa e fjetjes në hotel paraqitet me realizim në vlerën 1,552 mijë lekë, ose 152 % e planifikimit. Nga auditimi u konstatua se, aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar asnjë kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel. Pra nuk evidentohet, sa dhoma ka hoteli disponibël për aktivitet, sa shtretër janë për dhomë dhe gjithsej, sa dhoma janë aktive dhe sa jo. Të gjitha këto mangësi bëjnë që kjo taksë të mos jetë arkëtuar saktë për numrin e personave që akomodohen në strukturat akomoduese të Bashkisë Tropojë, kryesisht kjo në sezonin veror ku numri i personave që akomodohen në hotele është më i lartë, veprime të cilat çojnë në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Tropojë.

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele u konstatua se vlera debitore për këtë taksë në mënyrë progresive deri në 31.12.2023 është 360,320 lekë për 13 subjekte. Përgjatë vitit 2024 janë kryer likuidime për taksën e fjetjes në hotele në vlerën 179,865 lekë nga detyrimi i mbetur deri në 31.12.2023.

Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e fjetjes në hotele, konstatohet se nga Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë, nuk janë marrë masa shtrënguese për arkëtimin e taksës së fjetjes në hotele. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme kanë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë në vlerë 360,320 lekë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kreun I.3, tabela nr.6 në Paketën Fiskale të Bashkisë Tropojë për vitin 2023.

3.1. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për të evidentuar numrin e hoteleve që operojnë në territorin e Bashkisë Tropojë, duke evidentuar numrin e dhomave dhe shtretërve, si dhe të shikohet mënyra e taksimit të fjetjes në hotel të personave (lekë/shtretër/nata), duke ruajtur nivelet ligjore +/- 30%.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

3.2. Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave Bashkia Tropojë të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës prej 360,320 lekë, me qëllim eliminimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e bashkisë, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV Bashkia Tropojë, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive, si rrjedhojë e mos likuidimit të gjobave të vendosura, janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë gjithsej 1,600,000 lekë, vlerë e cila është e pa kontabilizuar. Gjobat e mësipërme janë të formës së prerë, për të cilat nga Kryeinspektori i Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit nuk është bërë kërkesë në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Tropojë, për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit të tyre nëpërmjet përmbarimit gjyqësor. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 30 në

Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet 164 dhe 165 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative në RSH”, neni 14 në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

4.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me Sektorin e Tatim Taksave, Drejtorinë Juridike dhe Kryeinspektorin e IMTV-së të ndjekin me përpikëri të gjitha rrugët administrative dhe ligjore kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për arkëtimin e vlerës 1,600,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

-IMTV të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk paguajnë gjobën brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatëvonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *i pazbatuar*.

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2023 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tropojë 2 gjoba në vlerën 20,000 lekë; Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat shtrënguese si dhe nuk janë aplikuar kamat vonesa sipas ligjit në fuqi. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në nenin 13 në Ligjin nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”, i ndryshuar, si dhe pikën 4 të nenit 30 në Ligjin nr.10279, datë 20.05.2010.

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me sektorin e Policisë Bashkiake, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 20,000 lekë, si rrjedhojë e gjobave të vendosura, si dhe të bëhet kontabilizimi i vlerës debitore.

Përgjigja e subjektit: Nuk ka përgjigje.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti *dhe i pazbatuar*.

F. MASA DISIPLINORE.

F.1 Për punonjësit në marrëdhënie pune

F.1.1 Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në V.K.M-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmartjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Vërejtje” në zbatim të germës “a” të nenit 58, për 4 punonjës;

1. Z. K.S, me detyrë Përgjegjës i Tatim Taksave në periudhën (aktualisht në sektor tjetër pranë Bashkisë Tropojë), për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mos aplikimin e penaliteteve, etj.

2. Z. K.B, Specialist i menaxhimit të borxhit, për mangësitë e konstatuara për zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, mos aplikimin e penaliteteve, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.2, faqe 18-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3. Z. H.I, me detyrë Drejtor i Drejtorisë Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit përgjegjës për mangësitë e konstatuara për mos administrimin e pronave dhe aseteve si dhe në drejtim të

menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të strukturave mbi regjistrimin dhe administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet Kullotave).

4. Z. M.K me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pronave dhe Hartografisë, për mangësitë e konstatuara për mos administrimin e pronave dhe asetëve si dhe në drejtim të menaxhimit, organizimit dhe funksionimit të strukturave mbi regjistrimin dhe administrimin e pronës Publike (Asetet dhe Pyjet Kullotave).

Përgjigja e subjektit, Sektori i Burimeve Njerëzore:

Në lidhje me rekomandimin për vendosjen e masës disiplinore “Vërejtje”, në zbatim të gurmës “a” të nenit 58 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ju informojmë se:

Institucioni ka nisur menjëherë ecurinë disiplinore për katër punonjësit në fjalë. Procedura do të ndiqet në përputhje të plotë me afatet dhe hapat e përcaktuara nga legjislacioni përkatës. Pas përfundimit të procesit disiplinor dhe shqyrtimit të çdo rasti individual, do të ndërmerren masat përkatëse dhe do të informoheni zyrtarisht për vendimmarrjen përfundimtare.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

F.2. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësen e mëposhtme nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personi nuk është në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje” për:

1. Znj. E.D, Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit dhe Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planifikimin dhe zbatimin e buxhetit si dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2023. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 12-17, pikën III.2.2 faqe 18-45 dhe pikën III.2.3 faqe 45-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

F.3. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Përgjigja e subjektit, Sektori i Burimeve Njerëzore:

Për punonjësit që janë rekomanduar për të marrë masë disiplinore, pas shqyrtimit nga eprori direkt. Pas përfundimit të procesit disiplinor dhe shqyrtimit të çdo rasti individual, do të ndërmerren masat përkatëse dhe do të informoheni zyrtarisht për vendimmarrjen përfundimtare.

Komenti i grupit të auditimit: Për sa trajtuar më sipër rekomandimi konsiderohet i pranuar nga subjekti dhe *në proces*.

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm (për pasqyrat dhe transaksionet e vitit 2023) paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Pjesërisht të zbatuara	Në proces
Masa Organizative	17	5	1	2	9

Masa për eliminimin e 3 E – ve.	1				1
Masa për arkëtimin e të ardhurave tatimore	1				1
Masa për Të ardhura të munguara	7		6	1	
Masa Disiplinore	4				4
Total	30	5	7	3	15

Punoi grupi i auditimit

Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme (2021-2022) paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa zbatuar	Pjesërisht të zbatuara	Në proces
Masa Organizative	16	1	1	1	13
Masa 3 E dhe Ulje e Borxhit (D1)	3		1		2
Masa 3 E dhe Ulje e Borxhit (B1)	6	1		1	4
Masa për shpërblim dëmi	5		5		
Masa disiplinore	18	18			
Total	48	20	7	2	19

Punoi grupi i auditimit

Pretendimi i subjektit (Sektori Juridik dhe Apelimt Tatimor), znj. F.V, sipas observacionit sjellë me nr. 3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr. 467/3.prot., datë 27.08.2025.

.....Unë si punonjëse kam filluar marrëdhëniet e punës me Bashkinë Tropojë, nga fundi i vitit 2023, në pozicionin Specialiste Juriste.

Nga Qershori 2024 deri me dt. 02. 07. 2025 unë kam mbuluar kontratat e qirave, konceptim të akteve të ndryshme, verifikim ligjshmërie të projekt-vendimeve, etj.

Nga Qershori 2024 e në vazhdim kam bashkëpunuar me Sektorin e Tatim Taksave në lidhje me detyrimet e subjekteve të cilat kanë kontratë qiraje me Bashkinë Tropojë.

Nga Sektori i Tatim Taksave më është dërguar lista me subjektet që kanë detyrime, vlerën e detyrimeve, të rrjedhura këto nga mos shlyerja e qirasë.

Të gjitha ato subjekte që nuk kishin respektuar kushtet e kontratës dhe rezultoni debitor ju jam drejtuar me shkresa zyrtare (shkresa këto të cilat jua kam vënë në dispozicion) ku i kam vënë në dijeni për detyrimet që kanë, duke ju lënë edhe afat për shlyerjen e detyrimeve si dhe për hapat që do ndiqen nga ana jonë në rast se nuk do të shlyejnë detyrimet.

Kam zhvilluar edhe takime me përfaqësues të këtyre subjekteve.

Disa nga këto subjekte janë dakordësuar dhe kanë pranuar detyrimet që kanë dhe kanë bërë shlyerjen e detyrimit.

Këto subjekte janë:

1. T sha, ka shlyer detyrimin në shumën 95,000 lekë me dt. 24. 09. 2024 dhe 17. 10. 2024.
2. T sha, ka shlyer detyrimin në shumën 25,000 lekë me dt. 17. 10. 2024.
3. S&XH ka shlyer detyrimin në shumën 52,920 lekë me dt. 23. 10. 2024.
4. A shpk ka likuiduar vlerën e detyrimit në shumën prej 12,592 lekë që është diferenca e qirasë vjetore deri në datën e zgjidhjes së kontratës, pasi me këtë subjekt kemi zgjidhur kontratën e qirasë.
5. B. shpk, ka shlyer detyrimin në vlerën 89,690 lekë, me dt. 12. 11. 2024, që është diferenca e qirasë vjetore deri në datën e zgjidhjes së kontratës, pasi me këtë subjekt kemi zgjidhur kontratën e qirasë.
6. B. shpk, ka shlyer detyrimin në vlerën 129,600 lekë me dt. 22. 10. 2024.
7. IH N shpk, ka shlyer detyrimin në shumën 58,100 lekë me dt. 20. 09. 2024.
8. V.H, me dt. 21. 10. 2024 ka shlyer detyrimin në shumën 120,600 lekë.

9. B.T, p.fizik, ka shlyer detyrimin në shumën 47,423 lekë me dt. 21. 10. 2024.

10. Me subjektin “A”, me dt. 31. 07. 2025 kemi lidhur akt-marrëveshje për lehtësimin e shlyerjes së detyrimit të prapambetur dhe me dt. 31. 07. 2025 ka likuiduar këstin e parë në vlerën 186,020 lekë dhe do e ndjek në vijimësi shlyerjen e kësteve sipas përcaktimit në akt-marrëveshje.

Me ato subjekte të cilët nuk janë dakordësuar për të shlyer detyrimet që kanë ndaj bashkisë, me gjithë njoftimet e dërguara disa herë, si dhe takimeve të zhvilluara me përfaqësues të disa prej tyre, pasi ia kam relatuar titullarit të Bashkisë, kam bërë zgjidhjen e kontratave.

Janë bërë këto zgjidhje kontrate, për shkak të mos pagesës së qirasë.

1. Zgjidhur kontrata me “SH” shpk.

2. Me Vodafone Al nuk kemi bërë rinovimin e kontratës. i kemi njoftuar për detyrimin dhe kemi kërkuar nga ana e tyre që të shlyejnë detyrimin dhe kanë pretenduar se nuk kanë asnjë detyrim dhe ju kemi kërkuar të na dërgojnë dokumentacionin me anën e të cilit vërtetojnë pretendimin e tyre.

3. Zgjidhur kontrata me “S” shpk.

4. Zgjidhur kontrata me “M” shpk.

5. Zgjidhur kontrata me “V” shpk.

Kemi në proces edhe katër kontrata dhe jemi në pritje të konfirmimit të tyre nëse do të dakordësohen për shlyerjen e detyrimit ose do bëjmë zgjidhjen e kontratës dhe konkretisht:

1. P.GJ

2. L

3. H

4. B, shpk

Kam bërë verifikimin e të gjitha dosjeve të kontratave në lidhje me inventarizimin dhe hartat dhe në ato dosje që ka pasur mungesë të hartave I kam depozituar në dosje.

Dosjet të cilat kanë qenë pa inventar janë inventarizuar. Edhe për ato dosje të cilat kanë qenë të inventarizuara, por që nuk ishte inventar i plotë, kam bërë ri inventarizim të tyre dhe jemi pothuajse në përfundim të të gjitha inventarëve.

Në lidhje me rekomandimet e lëna nga ana Juaj për ndjekjen e hapave ligjorë në të gjitha shkallët e gjykimit, kjo nuk është përgjegjësi e imja. Hapat ligjorë në të gjitha shkallët e gjykimit, evidentimi dhe monitorimi i proceseve gjyqësore ndiqen nga *Specialisti Jurist B.H.* Për rekomandime të lëna në vijimësi nga auditimet e mëparshme dhe që nuk janë zbatuar nga ana e tyre, nuk është përgjegjësi e imja, pasi nuk kam qenë punonjëse e Bashkisë Tropojë.

Do t’ ju lutesha të rishikoni konkluzionin Tuaj në lidhje me përgjegjësinë time për moszbatimin e rekomandimeve në vijimësi, pasi siç jua pasqyrova më sipër, unë që nga muaji Qershor 2024 e deri më sot për të gjitha rekomandimet që janë lënë nga ana Juaj i kam ndjekur, disa janë zbatuar dhe të tjerat janë në proces zbatimi, ku nga ana Juaj u vlerësua puna ime dhe u evidentua në Projekt-Raport çfarë është zbatuar dhe çfarë është në proces zbatimi. Do vijoj të ndjek dhe të zbatoj me korrektësi çdo rekomandim të lënë nga ana Juaj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket observacionit tuaj, ju keni ri sjellë fakte dhe punën e kryer gjatë vitit 2024, të cilën grupi i auditimit e ka konstatuar me kujdes dhe përgjegjësi gjatë fazës së terrenit, përsa i përket zbatimit të rekomandimeve të lëna në vite nga KLSH dhe të pa zbatuara nga administrata e Bashkisë Tropojë. Pra observacioni juaj ka të bëjë me lënien e përgjegjësisë dhe jo të konstatimeve. Për sa më sipër, observacioni pranohet pjesërisht pasi auditimi ka qenë për vitin 2024, ku ju jeni pjesë e sektorit juridik.

Pretendimi i subjektit (Sektori Juridik dhe Apeliimit Tatimor), z. B.H, sipas observacionit sjellë me nr. 3336/4.prot., datë 22.08.2025 protokolluar në KLSH me nr. 467/3.prot., datë 27.08.2025.

Në referencë të Projekt Raportit të Auditimit, dërguar me Tuajën nr. 467/2 Prot, dt. 22. 07. 2025 dhe protokolluar pranë Bashkisë me nr. 3336 Prot, dt. 25. 07. 2025, “Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Tropojë”, në bazë të Programit të Auditimit Financiar me nr. prot. 467/1, dt. 25. 04. 2025 “Program auditimin financiar”, pasi u njoha me Projekt Raportin e

Auditimit, ku referohen edhe problematika dhe rekomandime, po ju pasqyroj komentet, për atë çka unë si Jurist, përgjegjës për ndjekjen e procedurave ligjore ne te gjithë shkallet e gjykimit, mendoj se nuk mbaj përgjegjësi, në lidhje me moszbatimin e disa rekomandimeve.

- *Ne lidhje me rekomandimin 5.1, faqe 72, masa organizative, për vlerën 42,876,907 leke, sqarojmë se:*

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkrese nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore ne te gjitha shkallet e gjykimit.

- *Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 76, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 1.1 për vlerën 186, 810 leke, sqarojmë se:*

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkrese nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore ne te gjitha shkallet e gjykimit.

- *Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 77, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 3.1 për vlerën 4,904,021 leke, sqarojmë se:*

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkrese nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore në të gjitha shkallet e gjykimit.

- *Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 77, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 4.1 për vlerën 60,000 leke, sqarojmë se:*

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkrese nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore ne te gjitha shkallet e gjykimit.

- *Ne lidhje me rekomandimin C1, faqe 77, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 5.1 për vlerën 384, 000 leke, sqarojmë se:*

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkrese nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore ne te gjitha shkallet e gjykimit.

- *Ne lidhje me rekomandimin D1, faqe 78, masa për eliminimin e efekteve negative te konstatuara ne administrimin e fondeve, rekomandimi 21 për vlerën 1,550, 000 leke, sqarojmë se:*

Nga ana e Sektorit Juridik është bërë kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesë nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë Është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi për gjoba të vendosura gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Në lidhje me rekomandimin D, faqe 89, masa për eliminimin e efekteve në menaxhimin e të ardhurave, rekomandimi 3.2 për vlerën 360, 320, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkresë nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore ne te gjitha shkallet e gjykimit.

- *Ne lidhje me rekomandimin D, faqe 89, masa për eliminimin e efekteve ne menaxhimin e te ardhurave, rekomandimi 4.1 për vlerën 1,600,000, sqarojmë se:*

Nga ana e Sektorit Juridik është bërë kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesë nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi për gjoba të vendosura gjatë vitit 2023 dhe 2024.

Në lidhje me rekomandimin D, faqe 90, masa për eliminimin e efekteve ne menaxhimin e të ardhurave, rekomandimi 5.1 për vlerën 20,000, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkrese nga sektorët përkatës ne mënyrë qe nga ana Jone te fillohet procedura ligjore ne te gjitha shkallet e gjykimit.

- *Ne lidhje me rekomandimin D1, faqe 101, masa për eliminimin e efekteve negative te konstatuara ne administrimin e fondeve, rekomandimi 2.1 për vlerën 1,550,000, sqarojmë se:*

Nga ana e Sektorit Juridik është bërë kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesë nr. 1739/8 Prot, datë 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi për gjoba të vendosura gjatë vitit 2023 dhe 2024.

- Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 101, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 2.1 për vlerën 2,131,555 leke, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkresë nga sektorët përkatës në mënyrë që nga ana Jone të fillohet procedura ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit.

- Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 102, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 3.1 për vlerën 4,904,021 leke, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkresë nga sektorët përkatës në mënyrë që nga ana Jone të fillohet procedura ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit.

- Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 102, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 4.1 për vlerën 60,000 leke, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkresë nga sektorët përkatës në mënyrë që nga ana Jone të fillohet procedura ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit.

- Në lidhje me rekomandimin C1, faqe 102, masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 5.1 për vlerën 384,000 leke, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkresë nga sektorët përkatës në mënyrë që nga ana Jone të fillohet procedura ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit.

- Në lidhje me rekomandimin D, faqe 103, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e, rekomandimi 4.1 për vlerën 1,600,000, sqarojmë se:

Nga ana e Sektorit Juridik është bërë kërkesë për lëshim urdhër ekzekutimi, kërkesë nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025, drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi për gjoba të vendosura gjatë vitit 2023 dhe 2024. Në zbatim të Ligjit 127/2024 "Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoriati Vendore të Mbrojtjes së Territorit, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, si dhe Policia e Shtetit e Policia Bashkiake", nuk jemi drejtuar gjykatës, për gjoba të cilat janë shfuqizuar në zbatim të këtij ligji. Nuk janë zbatuar akoma procedurat për shfuqizimin e tyre, pasi në dijeninë tonë akoma nuk ka dalë vendimi nga Këshilli Ministrave për miratimin CD procedurave ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të pa ekzekutuara, sipas këtij ligji (Bashkëngjitur kërkesa nr. 1739/8 Prot, dt. 06. 05. 2025 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

- Në lidhje me rekomandimin B, faqe 103, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e, rekomandimi 1 për vlerën 46,040,560 leke, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik nuk ka ardhur asnjë informacion apo shkresë nga sektorët përkatës në mënyrë që nga ana Jone të fillohet procedura ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit.

- Në lidhje me rekomandimin B.1, faqe 104, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve, rekomandimi 1, në lidhje me njoftimin shkresërisht në kohe reale DBF për të shmangur shpenzimet përmbareme të cilat rendojnë buxhetin e shtetit, sqarojmë se:

Pranë sektorit Juridik të Bashkisë Tropojë jam emëruar në muajin Shkurt 2023 dhe në të gjitha rastet kur pranë Institucionit tone është paraqitur vendim që përbën titull ekzekutiv, i formës së prere ose me ekzekutim të përkohshëm, në kohe reale është njoftuar Drejtoria e Financës shkresërisht për ekzekutimin e vendimit.

Sa lidhet me shmangien e shpenzimeve përmbareme sqarojmë se palët paditëse, duke qenë se vendimet kanë qenë me objekt lirim nga detyra, me gjithë përpjekjeve tona dhe komunikimeve me ta, nuk na kanë dhe mundësinë e arritjes së një marrëveshjeje për ekzekutimin vullnetar të vendimit por kanë paraqitur në mënyrë direkt kërkesë pranë Zyrave Përmbareme.

- Në lidhje me rekomandimin B.1, faqe 105, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e, rekomandimi 1.1 për vlerën 38,496,734 lekë, sqarojmë se:

Nga sektori ligjor është ndjekur dhe do të ndiqet me korrektësi maksimale e në mënyrën me dinjitoze, përfaqësimi i institucionit në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe do mbajmë parasysh çdo rekomandim të lënë nga ana Juaj.

Në lidhje me ndjekjen e proceseve gjyqësore për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga subjektet me të cilat kemi zgjidhur kontrata e qirasë, kjo për shkak të mos pagimit të detyrimit ndaj Bashkisë Tropoje, kemi hartuar draft kërkesa padie por jemi në proces të pajisjes me certifikate pronësie, të cilën duhet ta paraqesim si provë në Gjykatë për të vërtetuar pronësinë mbi truallin e dhënë me qira.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Përsa i përket observacionit tuaj, qëndrimi ynë mbetet i pandryshueshëm pasi ju nuk sillni objeksione për konstatimet tona por për mos rakordime shkresash ndërmjet drejtorive të Bashkisë Tropojë çka është përgjegjësia juaj dhe e Titullarit Tuaj.

Konkluzion:

- Bashkia Tropojë, prej dërgimit të së raportit përfundimtar të Auditimit sipas shkresës 1087/9 Prot, datë 27.03.2025 nga KLSH, ka respektuar afatin 20 ditor në dërgimin e planit të veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve si dhe **kanë kaluar rreth 2,5 muaj nga dërgimi i RPA e rrjedhimisht mbetet në vijim për t'u verifikuar kthimi i përgjigjes për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve, sipas afatit 6-mujor.** Nisur nga afati shumë i shkurtër i verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, edhe zbatimi i tyre është në fillim të proceseve përkatëse.

-Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 16,7 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 23,3%, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 60%.

-Në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e viteve të kaluara paraqitet; Niveli i pranimit të rekomandimeve është 100% dhe realizimi në masën 41,6 % zbatuar, pa zbatuar në nivelin 14,6 %, në proces apo zbatuar pjesërisht në nivelin 43,8 %.

Referuar Ligjit nr. 154/2014 si dhe Rregullores së Procedurave të Auditimit, për t'u shprehur mbi statusin e zbatimit të një rekomandimi duhet të ketë kaluar një periudhë minimale prej 6 muajsh nga data kur subjekti auditues është vënë në dijeni përmes raportit përfundimtar të auditimit.

Duke qenë se nga data e dërgimit të shkresës përcjellëse të rekomandimeve dhe mbylljes së auditimit në terren kanë kaluar vetëm 2.5 muaj, grupi i auditimit nuk është në pozicion të dalë me rekomandime në këtë Vendim.

Gjithashtu, duke qenë se Bashkia ndodhet aktualisht në proces auditimi dhe afati 6-mujor tashmë ka kaluar, çështja i përcillet grupit të auditimit që po zhvillon auditimin aktual, për të marrë në shqyrtim dhe vlerësuar këtë pikë.

Pika 4. Të tjera të dala gjatë auditimit.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave në bazë të informacionit të dërguar nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, konstatohet që janë planifikuar të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore në vlerën 92,708,052 lekë dhe janë realizuar të ardhura në vlerën 68,557,802 lekë , pra 74% e planifikimit, për vitin 2024. Bashkia Tropojë paraqitet me mosrealizim të të ardhurave në vlerën 24,150,250 lekë.

Tabela 4.1 Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat viti 2024/lekë

Te ardhurat e veta	Fakt
Plan	
92,708,052	68,557,802

Burimi: Drejtoria e financës dhe buxhetit bashkia Tropojë

Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, sjellin mungesa në realizimin e shpenzimeve buxhetore dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve. Mosrealizimi i të ardhurave vjen për faktin se parashikimi i shpenzimeve nuk është bërë mbi bazën e të ardhurave faktike të një viti më parë,

por është planifikuar mbi planin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, i cili për asnjë vit nuk realizohet.

Gjithashtu mos realizimi i të ardhurave ka sjellë mosrealizim të investimeve dhe shpenzimeve operative, çka pasqyrohet në tabelën 4.2, ku planifikimi i investimeve rezulton në vlerën 212,157 mijë lekë dhe realizimi në vlerën 185,036 mijë lekë ose masën 87 % të planifikimit dhe realizimi i shpenzimeve operative është në masën 84 %.

Tabela 4.2 Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve, për investime dhe shërbime

Nr.	Subjekti	Plan/Fakt/investime		Plan-fakt/Shpenzime operative	
		Plan/investime	Fakt/ investime	Plan	Fakt
	Bashkia Tropoje	212,156,259	185,035,548	109,864,810	92,508,822

Burimi: Drejtoria e financës dhe buxhetit bashkia Tropojë

Veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 6, neni 9 dhe nenin 10, Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.3 germa a dhe germa c, Udhëzimin e MFE nr. 9, datë 20.03.2018, “Procedurat standarde për menaxhimin e të ardhurave” Kreu IV, pika 198, “Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për mbledhjen në kohë të të ardhurave dhe menaxhimin e tyre”.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tropojë vazhdon të funksionojë sipas Rregullores së Brendshme, miratuar me urdhrin nr.41 datë 06.03.2018 “Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Administratës së Bashkisë Tropojë” ndërkohë që organika e këtij Institucioni ka pësuar ndryshime, si në drejtori ashtu edhe në sektorë sipas Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë me nr. 59 datë 13.02.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë” për vitin 2024, duke sjellë mos përcaktim dhe delegim të detyrave sipas drejtorive dhe sektorëve përkatës për një kohë relativisht të gjatë, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar neni 8.

-Bashkia Tropojë nuk disponon një regjistër të detajuar për trajnimet e realizuara nga nëpunësit dhe nuk janë parashikuar fonde specifike në buxhet për zhvillimin e tyre në fusha të ndryshme. Gjithashtu, mungojnë procedura të përcaktuara për sigurimin dhe shpërndarjen e pajisjeve IT në sektorët përkatës, ndërsa nuk ekziston një plan investimesh në fushën e teknologjisë së informacionit. Po ashtu, institucioni nuk ka të miratuar një procedurë funksionale për krijimin dhe ruajtjen e kopjeve rezervë (back-up), duke riskuar sigurinë e të dhënave.

Sektori i Burimeve Njerëzore nuk ka hartuar plane vjetore trajnimesh të detyrueshme për punonjësit e saj.

Deklarata e misionit nuk është përgatitur si dokument i veçantë dhe nuk është integruar në rregulloren e brendshme të institucionit. Gjithashtu, mungon dokumentacioni që vërteton zhvillimin e takimeve të GMS gjatë vitit 2024.

-Bashkia Tropojë nuk ka dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë MF pyetësorin e vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM-në nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”; Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manualin e MFK-së, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar.

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me Sektori i Burimeve Njerëzore e Sektorin Juridik të marrin masa për:

-Hartimin dhe miratimin e Rregullores së brendshme të përditësuar sipas strukturës organizative të miratuar për të rritur performancën e punonjësve, dhe për mirë përcaktimin e detyrave sipas çdo drejtorie apo sektori.

-Për hartimin e një plani dhe regjistri të detajuar të trajnimeve për punonjësit, si dhe parashikimin e fondeve në PBA-të respektive për kryerjen e tyre.

-Dokumentimin gjatë zhvillimit të mbledhjeve të GMS-së, për çështje që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Menjëherë dhe në vijimësi

1.2 Rekomandimi: Nga Kryetari i Bashkisë Tropojë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik të merren masa për:

-Ngritjen dhe përmirësimin e sistemeve e teknologjisë së informacionit, duke zbatuar procedurat e brendshme në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe rikuperimin e të dhënave.

-Monitorim të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, nëpërmjet aktiviteteve të përcaktuara në planet e veprimit për MFK-në.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i përbërjes dhe veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, u konstatua se;

Bashkia Tropojë, në zbatim të Urdhrit nr. 59, datë 13.02.2024 “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Tropojë”, ka përfshirë në strukturën organike, Njësinë e Auditit të Brendshëm, me tre pozicione: një përgjegjës dhe dy specialistë, por nga verifikimi i dosjeve të personelit dhe struktura organizative, u konstatua se kjo strukturë është jo funksionale dhe nuk ka punonjës që të ushtrojnë funksionin e audituesit. Kjo njësi vazhdon të jetë jo efektive për Bashkinë Tropojë, duke sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm dhe rritje të riskut ndaj keq përdorimit të fondeve publike, mungesë transparence, si dhe mos identifikimin në kohë të dobësive apo rreziqeve financiare dhe administrative. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar neni 10 dhe Ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 49. VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, pika 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1.2, faqe 12-22, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për plotësimin e vendeve vakant në strukturën e Njësisë së Auditit të Brendshëm, me qëllim bërjen funksionale të kësaj njësie auditimi për përmbushjen e misionit të saj, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i formatit të raportimit dhe siglimit në mënyrë digjitale të pasqyrave financiare, u konstatua se pasqyrat janë përgatitur dhe sigluar në mënyrë digjitale nga përgjegjësja e sektorit të financës, nëpunësja zbatuese dhe autorizuesi më datë 16.04.2025, ndërsa janë konfirmuar nga Thesari më datë 17.04.2025. Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe dorëzuar jashtë afateve të parashikuara, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar pika 118. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Tropojë të marrë masa për forcimin e planifikimit dhe ndjekjes së afateve të raportimit financiar, në mënyrë që pasqyrat financiare të përgatiten, siglohen dhe dorëzohen në kohën e duhur. Gjithashtu, të përmirësohet koordinimi ndërmjet sektorit të financës dhe Thesarit për të shmangur vonesat në procesin e raportimit.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Gjatë verifikimit të ditarit të shpenzimeve për vitin 2024 u konstatuan mospërputhje ndërmjet të dhënave të njësisë dhe Thesarit, për shkak të klasifikimit të gabuar të shpenzimeve ndërmjet llogarive buxhetore.

Në llogaritë 604 “Transferime korrente të brendshme” dhe 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët” u konstatua një diferencë prej 263,457 lekë, si rezultat i klasifikimit të pasaktë të një shpenzimi, që duhej të ishte regjistruar në llogarinë 604.

Këto mospërputhje reflektojnë probleme në klasifikimin buxhetor të shpenzimeve, të cilat ndikojnë në saktësinë e raportimit financiar dhe në rakordimin me të dhënat e sistemit të Thesarit, veprime në kundërshtim me kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 5/a, me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1.3/ germa a, b, ç, me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar nenet 6 dhe 9. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Tropojë, të marrë masa që të kryejë sistemimet kontabël të shpenzimeve në mënyrë që të sigurojë përputhshmëri ndërmjet regjistrimeve të njësisë dhe të dhënave të Thesarit.

-Të kryejë verifikime dhe rakordime të rregullta mujore për të parandaluar dhe korrigjuar në kohë klasifikimet e pasakta në kontot buxhetore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua që llogaria 215 “Mjete transporti”, ka mospërputhje midis vlerës së pasqyruar në pasqyrat financiare dhe vlerës së komisionit të inventarizimit.

Llogaria 215 “Mjete transporti”, në pasqyrën F7 “Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimit të aktiveve afat gjata”, për vitin 2024 ka vlerën 70,536,391 lekë (kosto historike), ndërkohë sipas inventarit fizik rezulton vlera 67,083,998 lekë, ose 3,452,393 lekë më pak. Kjo diferencë ka ekzistuar edhe në pasqyrat financiare të vitit 2023. Llogaria 215 “Mjete transporti”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2024, veprime në kundërshtim me Kreun 3, pika 3.1, paragrafi 30, të Udhëzimit nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Tropojë, të marrë masa për kontabilizimin e saktë të llogarisë 215 “Mjete transporti”, duke sistemuar diferencat e evidentuara në vitin 2023 dhe 2024.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Sektori i Tatim Taksave, nuk janë dërguar për kontabilizim pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit vlera prej 1,811,430 lekë, e cila përbëhet nga vlera prej 191,430 lekë për detyrimet e hoteleve, vlerat prej 1,600,000 lekë për gjobat e IMTV për 7 subjekte, dhe vlera prej 20,000 lekë e gjobave të policisë bashkiake për dy subjekte.

Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka ruajtur gjurmën e auditimit për regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024, për familjarët si dhe nuk ka dërguar për kontabilizim detyrimet për taksat dhe tarifave vendore për familjarët. Mungesa e regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për familjarët, i ruajtur si gjurmë auditimi në protokoll, si dhe mosdërgimi i detyrimeve përkatëse për kontabilizim pranë Drejtorisë së Financës, krijon pasiguri në auditimin e procesit të faturimit të taksave dhe tarifave vendore. Kjo situatë ndikon negativisht në verifikimin e ngjarjeve ekonomike të ndodhura gjatë vitit 2024, si dhe në konfirmimin e saktësisë së vlerave debitorë për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2024, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar.

Sektori Taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masat e nevojshme për përpunimin në kohë reale të regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore në fund të vitit 2024, në mënyre që të ketë të dhënat për situatën e faturimit të taksave dhe tarifave vendore si dhe gjoha-kamatëvonesa për vitin 2024, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1 Rekomandimi: Sektori i Tatim-Taksave i Bashkisë Tropojë të marrë masa për:

- Dërgimin në kohë të të gjitha detyrimeve për kontabilizim pranë Drejtorisë së Financës;
- Përpunimin dhe ruajtjen e regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore si gjurmë auditimi;
- Rakordimin e të dhënave për faturimet dhe detyrimet tatimore për vitin 2024.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare të njësisë për vitin 2024, u konstatua se:

-Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” nuk pasqyron vlerën e saj të drejtë, si rezultat i mos kontabilizimit të vlerës së trojeve të pajisura me certifikata pronësie. Vlera e pa pasqyruar në regjistrat kontabël është në shumën 34,332,096 lekë, duke nën-vlerësuar pasurinë e njësisë dhe duke sjellë pasaktësi në pasqyrat financiare.

-Llogaria 211 “Pyje, Plantacione” nuk pasqyron vlerën reale të pasurisë, pasi nuk janë përfshirë në regjistrat kontabël vlerat e pyjeve dhe kullotave që janë kaluar sipas VKM-ve⁷ në vite, në pronësi të ish-komunave, tashmë pjesë e bashkisë. Mos regjistrimi i tyre është në kundërshtim Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30, si dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Tropojë në bashkëpunim me Sektorin e pronave dhe hartografisë të marrin veprimet e mëposhtme për të siguruar pasqyrimin e saktë dhe të drejtë të pasurive të paluajtshme në fund të vitit financiar:

-Të evidentojnë dhe të kontabilizojnë në mënyrë të plotë vlerat e trojeve të pajisura me certifikata pronësie, në llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene”, në vlerën prej 34,332,096 lekë, si dhe pronat të tjera troje sipas dokumentacionit ligjor ekzistues, duke reflektuar kështu gjendjen reale të aseteve në pronësi të bashkisë.

-Të përfshijnë në regjistrat kontabël dhe në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” pasuritë e llojit pyje dhe kullota që, me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave (VKM), që i janë kaluar në pronësi njësisive vendore (ish-komunave), tashmë pjesë e bashkisë.

- Të bashkëpunojnë me institucionet përkatëse si Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria e Pasurive Publike dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive, për të siguruar verifikimin e titujve të pronësisë dhe për të përfituar informacion të saktë mbi sipërfaqet dhe vlerat përkatëse.

- Të marrin vlerësimin financiar të aseteve, në rastet kur mungon vlera kontabël, duke u mbështetur në ekspertizën e licencuar për vlerësime pasurish, në përputhje me kërkesat e standardeve kontabël dhe legjisllacionit në fuqi.

⁷ VKM nr. 610, datë 14.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Llugaj të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 649, datë 21.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Bujan të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 521, datë 23.4.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Bytyç, të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 199, datë 21.2.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Fierzë të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 555, datë 7.5.2008 Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Lekbibaj të Qarkut të Kukësit;

VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive”, e ndryshuar, pika 43, shtojca me nr. 4

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pakësimit të llogarisë 231 “*Punime në proces*” me shtesat e llogarive 212 “*Ndërtesa e konstruksione*”+213 “*Rrugë, rrjete e vepra ujore*” +214 “*Instalime teknike makineri e pajisje*” + 218 “*Inventar ekonomik*” blerje me pagesë, ka mospërputhje të tyre për vlerën 8,574,174 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Tropojë të verifikojë dhe saktësojë regjistrimet kontabël midis pakësimit të llogarisë 231 “*Punime në proces*” dhe shtesave në llogaritë 212, 213, 214 dhe 218 për të korrigjuar mospërputhjen prej 8,574,174 lekë. Të sigurohet që çdo pasuri e përfunduar të shoqërohet me dokumentacion përkatës dhe të regjistrohet saktë si shtesë në aktivet fikse dhe pakësim i punimeve në proces.

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nuk janë kontabilizuar saktë veprimet për shtesat e llogarisë 213 për vitin 2024. Nga të dhënat e pasqyruara për pakësimin e llogarisë 231 “*Investime në proces*” në të cilën përfshihen dhe vlerat e supervizionit dhe mbikëqyrjes dhe shtesës në llogarinë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, rezultoi se nuk plotësojnë kushtet kontabël sipas vlerave të regjistruara për kapitalizimin e investimeve për 8 objektet e marra në dorëzim në shumën prej 263,726,682 lekë (667,611,126-403,884,444 lekë), Shtesa e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, për vitin 2024 rezulton të jetë 502,135,740 lekë, vlerë e cila nuk përputhet me shumën totale të situacioneve përfundimtare, sipas certifikatave të përkohshme të marrjes në dorëzim, e cila është 760,271,915 lekë.

Mos paraqitja e saktë e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*” ka sjellë dhe mospasqyrim/pasaktësi të llogarisë 401-408 Detyrimeve ndaj furnitorëve”

Veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 8 datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit e Bashkisë Tropojë të verifikojë vlerat e likuiduara ndër vite për 8 objektet e marra në dorëzim, që i përkasin llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete dhe vepra ujore*”, si dhe rakordimin e tyre me vlerat e situacioneve përfundimtare sipas certifikatave të përkohshme. Pas kryerjes së verifikimeve përkatëse të marrë masa të korrigjojë regjistrimet kontabël për shtesat në llogarinë 213 dhe pakësimin e llogarisë 231, duke pasqyruar saktë detyrimet ndaj të tretëve dhe duke shmangur kalimin e parakohshëm të vlerave pa dokumentacion përfundimtar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave, për vitin 2024, u konstatua se për vlerën 4,941,909 lekë të llogarisë 218 “*Inventar ekonomik*” mungonte dokumentacioni mbështetës i asgjësimit dhe nuk është njoftuar Këshilli Bashkiak, në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për të kryer procedurën e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve jashtë përdorimit në llogarinë 218 “*Inventar ekonomik*”, duke ngritur komision të posaçëm të vlerësimit dhe asgjësimit, si dhe duke përfshirë kontrollin fizik e financiar të aktiveve si dhe të informojë Këshillin Bashkiak për efektet ekonomike dhe vendimet për nxjerrje jashtë përdorimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

11. Gjetje nga auditimi: Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2024. Konstatohet se Bashkia Tropojë ende vazhdon të zotërojë aksione të klubit sportiv “Valbona” në vlerën 3,500,000 lekë, të cilat duhet të ishin nxjerrë në shitje nga Bashkia brenda vitit 2021, veprime në kundërshtim me nenin 22, të ligjit nr. 105/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 79/2017 “Për Sportin”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Bashkia Tropojë të marrë masat e nevojshme për nxjerrjen në shitje të aksioneve të klubit sportiv “Valbona”, me qëllim paraqitjen e saktë të Llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën kreditore në fund të vitit 2024 është në vlerën 3,440,153 lekë, duke mos paraqitur gjendjen reale të saj, pasi nuk janë kontabilizuar detyrimet për vendimet gjyqësore për vlerën 26,037,782 lekë. Për sa më sipër llogaria 467 në fund të vitit 2024 është nënvlerësuar për vlerën prej 26,037,782 lekë, si pasojë e mos pasqyrimin të detyrimeve të vendimeve gjyqësore që kanë arritur pranë financës deri në vitin 2024. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 52, si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 15. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

12.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Bashkisë Tropojë të kontabilizojë dhe pasqyrojë saktë detyrimet për vendimet gjyqësore në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, për vlerën 26,037,782 lekë, për të siguruar paraqitjen e drejtë të pozicionit financiar në fund të vitit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare 2025

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i urdhër-shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2024, u konstatua se Drejtoria e Financës pranë Bashkisë Tropojë nuk ka respektuar radhën kronologjike të likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve. Konkretisht, janë kryer pagesa për detyrime të krijuara gjatë vitit 2024, ndërkohë që ekzistonin ende detyrime të papaguara të mbartura nga vitet e mëparshme, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemitbuxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 52, me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018, pikat 153-200. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1 Rekomandimi: Drejtoria e Financës së Bashkisë Tropojë të marrë masa për të respektuar radhën e kryerjes së pagesave për detyrimet ndaj të tretëve me qëllim sigurimin e transparencës, barazisë në trajtimin e kreditorëve dhe përmirësimin e menaxhimit financiar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi që Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masa për saktësimin e taksave dhe tarifave vendore sipas kodit të të ardhurave sipas thesarit rrjedhimisht ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave sipas llojit të tyre, e cila vjen si pasojë e mos administrimit të saktë të detyrimeve tatimore sipas llojit të tyre.

Drejtoria e financës dhe Buxhetit nga ana e saj ka pasqyruar të dhënat në lidhje me taksat dhe tarifavat vendore dhe të ardhurat jo tatimore sipas klasave të tyre që nuk përputhen me të dhënat e thesarit sipas kodeve përkatëse të të ardhurave, veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar neni 4 pika 7 dhe Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, pika 1. (Më hollësisht

trajtuar në pikën 2.1, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Sektori i taksave dhe tarifave vendore të marrë masa për administrimin dhe raportimin e saktë të taksave dhe tarifave vendore, sipas kodeve të të ardhurave të Thesarit, duke siguruar përputhshmëri dhe saktësi të të dhënave midis sektorit të taksave dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të vëna në dispozicion në lidhje me planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, u konstatua se ato janë realizuar në masën 74%, ku nga vlera e parashikuar në 92,708 mijë lekë është realizuar vlera 68,558 mijë lekë. Bashkia Tropojë paraqitet me mosrealizim të të ardhurave në vlerën 24,150,250 lekë.

Mosrealizimi i të ardhurave ka sjellë mosrealizim të investimeve dhe shpenzimeve operative dhe ulje të performancës së njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve dhe konkretisht investimet paraqiten me realizim në masën 87%, ku nga vlera e parashikuar në planifikimin e investimeve prej 212,157 mijë lekë është realizuar në vlerën 185,036 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me nenin 5, të Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” i ndryshuar, pika 24 dhe 25 e nenit 3, Me nenin 47 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, i ndryshuar, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” si dhe pikat 8 dhe pika 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 94-95, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1 Rekomandimi: Sektori i Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Sektorin e Tatimit Taksave, të marrë masa për një planifikim të studiuar të të ardhurave të veta, duke u mbështetur mbi parashikime reale. Mbi bazën e këtyre të ardhurave të parashikohet edhe plani i investimeve publike, me qëllim që investimet e planifikuara në buxhet të kenë burime financimi të sigurta për t’u realizuar. Për mosrealizimin gjatë vitit buxhetor të të ardhurave të planifikuara, të korrigjohet planifikimi i shpenzimeve, brenda afateve që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Përgjatë vitit buxhetor 2025 dhe në vijim

B. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE. (TË ARDHURA TË MUNGUARA)

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se deri në datën 31.12.2024, gjendja e debitorëve progresive për taksat dhe tarifave vendore është në vlerën 61,390,362 lekë, ku shtesa për vitin 2024 të debitorëve është në vlerën 19,784,125 lekë dhe vlera e mbartur debitorë në 31.12.2023 është 46,040,560 lekë. Niveli i lartë i debitorëve tregon për mungesë të arkëtimeve të qëndrueshme ndër vite, si pasojë e mosmarrjes së masave të plota dhe efektive nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me Sektorin Juridik, për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve. Pavarësisht rekomandimeve të përsëritura nga KLSH, Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Tropojë nuk ka ndërmarrë masa të plota, deri në nivelin e kallëzimit penal ndaj subjekteve debitorë. Gjithashtu, mungon një regjistër i posaçëm dhe një sistem monitorimi për ndjekjen e zbatimit të akt-marrëveshjeve të lidhura me këto subjekte.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 si dhe Kreun XI, si dhe me Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, neni 88-104.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune me qëllim analizimin e situatës së debitorëve progresivë dhe atyre të krijuar rishtaz, si dhe të nxjerrë

përgjegjësitë e punonjësve për mos arkëtim të të ardhurave të planifikuara, në mospërmbushjen e detyrave në përputhje me funksionet e tyre përkatëse.

-Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tropojë të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimeve tatimore për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 19,784,125 lekë, debi të krijuara në vitin 2024.

-Sektori i Tatim Taksave në bashkëpunim me Sektorin juridik, të ri analizojë të gjithë debitorët e Bashkisë Tropojë deri në 31.12.2023, në vlerën 46,040,560 lekë, duke verifikuar dërgimin e masave shtrënguese ndaj subjekteve, monitorimin e akt- marrëveshjeve dhe respektimin e detyrimeve nga subjekti debitorë dhe në rast të shkeljeve të vazhdojnë me konfiskimin e pasurive siç parashikon ligji tatimor.

Menjëherë dhe në vijimësi

B.1 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2024, vlera e pa likuiduar sipas vendimeve të formës së prerë është 26,037,782 lekë. Përgjatë vitit 2024 Bashkia Tropojë ka kryer likuidime në vlerën 12,458,952 lekë, dhe shpenzime përmbartimore në vlerën e 2,115,941 lekë, duke sjellë kosto shtesë në buxhetin e shtetit dhe shpenzime pa economicitet, veprime në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile, neni 510, germa “a” dhe 511, germa “a”.

Gjithashtu nga auditimi rezultoi se: Sektori i financës nuk ruan të dhënat të ndara sipas shpenzimeve gjyqësore, përmbartimore dhe detyrimet ndaj gjyq fituesve, por i regjistron ato në total, çka sjellë riskun e mos evidentimit të detyrimeve që janë për gjyq fituesit dhe ato që janë për shpenzime përmbartimore.

Sektori Juridik i bashkisë Tropojë pas evidentimit dhe monitorimit të proceseve gjyqësore, nuk ka njoftuar shkresërisht në kohë reale DBF për të shmangur shpenzimet përmbartimore, të cilat rëndojnë buxhetin e shtetit.

Efekti financiar për vitin 2024, sipas vendimeve të gjykatës për vitin 2024, është 40,612,675 lekë, i detajuar:

- 12,458,952 lekë, të paguara për vitin 2024,
- 2,115,941, lekë shpenzime përmbartimore
- 26,037,782 lekë, të pa likuiduara ende, të cilat përbëjnë risk për shtimin e efektivitetit negativ në buxhetin e shtetit për kosto të shpenzimeve përmbartimore, veprime në kundërshtim me nenin 2, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe pikën 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tropojë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për të evidentuar shkaqet dhe personat përgjegjës, që kanë sjellë përdorimin pa eficiencë të Buxhetit të Bashkisë në vlerën 2,115,941 lekë, shpenzime përmbartimore mbi pagesat e kryera për vendimet gjyqësore për gjyq fituesit.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1 PËR PUNONJËSIT NË MARRËDHËNIE PUNE

C.1.1 Për punonjës të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Mbështetur në nenin 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë,

që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. “Vërejtje” në zbatim të germës “a” të nenit 58, për 3 punonjës;

1. Znj. A.B (M.), në cilësinë e përgjegjës së sektorit të Buxhetit dhe Financës, për mangësitë e konstatuara në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2024. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Z. K.B, me detyrë Përgjegjës i Tatim Taksave për vitin 2024, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, si dhe për mos aplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3. Z.H.S, me detyrë specialist i sektorit të Taksave dhe Tatimeve për realizimin e të ardhurave, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, si dhe për mos aplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

C.1.2 Për punonjësit, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen me Kod Pune.

Mbështetur në nenin 37, të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, për parregullsitë e konstatuara, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tropojë**, që të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për **5 punonjës**:

1. Znj. F.H, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë Ekonomike dhe Nëpunësit zbatues, për mangësitë e konstatuara në implementimin dhe zbatimin e parimeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2024. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2. Znj. E.B, me detyrë specialist i sektorit të Taksave dhe Tatimeve, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, si dhe për mos aplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3. Znj. E.GJ, me detyrë specialist i menaxhimit të borxhit, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, si dhe për mos aplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

4. Znj. R.V, me detyrë specialist i menaxhimit të taksave familjare, për mangësitë e konstatuara në realizimin e planit të të ardhurave, zbatimin e masave shtrënguese në mënyrë shteruese për subjektet debitorë, si dhe për mos aplikimin e penaliteteve, etj. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 22-61, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

D. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTOLLI I LARTË I SHTETIT